

Procesverbal

*Nga Mbledhja II (e dytë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:
29.02.2024*

Rend Dite

1. Dhënia e betimit të anëtarit të zëvendësuar nga KQZ, z.Gazmend Ramadani;
2. Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar;
3. Propozim – vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajjtshme të Komunës P-70604038-00244-4 ZK Shajne;
4. Propozim – vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajjtshme të Komunës P-70604038-00244-4 ZK Shajne;
5. Raporti Financiar tetor – dhjetor 2023 (tremujori i katërt i vitit 2023);
6. Raporti Vjetor Financiar për vitin 2023;
7. Raporti i KKSB-së për periudhën korrik – dhjetor 2023;
8. Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2023 dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024; dhe
9. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, anëtarë të Kuvendit dhe të gjithë të pranishmit në sallë! Mirë se erdhët në seancën e dytë të rregullt për vitin 2024! Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë. Para se ta qesim në votim rendin e ditës, nëse ka dikush ta marrë fjalën rreth këtyre pikave? Nëse jo, atëherë, dje në KPF kemi marrë qëndrim që t'i rekomandojmë Kuvendit një pikë të rendit të ditës. Fjala është për anulimin e Vendimit për ndryshimin e emrit të rrugës ‘Hajdet’ në ‘Haxhi Rrahmani’. Vendimi 01Nr. 060/01-2095-15/24 i datës 31.01.2024. Ju lutem, pasi që e kemi obligim ligjor, që ta anulojmë këtë Vendim. Është mirë që të hyjë në rend të ditës dhe kur të vjen radha e diskutimit për anulimin e këtij Vendimi, atëherë dikush nga ekzekutivi të na japë sqarime më të hollësishme rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Shpetim Hajredini: Faleminderit, e nderuar kryesuese! Përshëndetje të nderuar pjesëmarrës! U bënë shumë seanca, s'po due më me e diskutue këtë çështjen e kthimit të vendimeve. Kjo është për të ardhur keq, por ju e dini mirë që edhe në seancat e kalume, kur ka ndodhë një gjë e tillë, kam kërkuar që të na vijë edhe neve materiali i Ministrisë, se për çka është kthyer prapë ai vendim. Ne sot nuk e kemi një gjë të tillë, atëherë unë kërkoj që – besoj që ekzekutivi e ka atë material – të na sjellë këtu, ta shohim na se për çka është kthyer prapë dhe pastaj vendosim nëse do ta mbështesim apo jo. Në të kundërtën, kjo për mu është si urdhër, po na urdhëroni neve dhe nuk besoj që marrim urdhëra prej ekzekutivit. Ne do të jemi kundër dhe nuk do ta mbështesim pa na ardhë materiali dhe ta shohim argumentin, pse është kthyer prapë ky vendim. Ju falemnderit!

Nexhat Selaj: Përshëndetje për kryetarin, kolegë asambleistë! Pavarësisht se nuk është pikë që duhet të diskutohet, por i isha lutur një herë ekzekutivit: nuk është hera e parë që këso vendime, një herë në radhë të parë i votoni, tani i ktheni mbrapsht për anulim. Një fjalë popullore thotë se mosdija s'ka skaj. Unë nuk pajtohem me atë. Nëse pyesim, skaj ka, derë ka, nuk është derë e hapur. Apo po paraqiteni kaq të padijshëm – më falni që po e përdori këtë term – apo po doni përçarje tash të shtini. Një herë e bini në legjislativ këtu të ekzekutohet tek ne, te Kuvendi, na bëni një përçarje, kush është pro këtij ndryshimi të emrit të rrugës, tani dalim ne në popullatë se një pjesë jemi pro e një pjesë jemi kundër, në seancën e radhës, tash – që nuk zgjati një muaj – vetë e bini atë vendim, vetë e anuloni. Nëse nuk dini, pyetni bre, nuk është marre me pyet. Vetëm ne po dalim shumë qesharakë, edhe para popullatës, edhe para Kuvendit, edhe para dëgjuesve. Ma mirë se me pyet nuk ka. Përfundimisht unë, në mënyrë demonstrative e kundërshtoj këtë vendim edhe jam pro që ai emërtim i rrugës të është ashtu si është emërtue nga ju në seancën e kaluar. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Para se me jua dhënë fjalën, lus kryetarin e Komunës për sqarim, që të jenë në dijeni anëtarët për Vendimin e kësaj rrugës.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, të nderuar asambleistë, të nderuar qytetarë, përfaqësues të OSBE-së, media! Ju përshëndes të gjithëve, ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë seancë! Lidhur me kërkesën që ma bëri kryesuesja, Kuvendi Komunal ka të drejtë me pru vendime. Edhe ju keni pru kur keni qenë edhe keni bërë shumë më shumë vendime të jashtëligjshme. Po normal, është e drejtë e Asamblesë pastaj, në mbledhjen e radhës ta rishqyrtojë ose ta anulojë vendimin. Pse është pru një vendim i tillë, nuk është bërë gabim, kërkesa është që të rishtyrtohet ky vendim. Arsyej pse do të rishqyrtohet është se MAPL-ja ka kërkuar që zëvendësimi i emrit të bëhet nga Lista rezervë. Listë rezervë ju të pushtetit të kaluar nuk keni bërë, ne kemi menduar se ka, kemi hulumtue nëpër Komunë, nuk ka. Kështu që, masi nuk ka Listë rezervë, deri të bëhet kjo, ne do ta anulojmë këtë vendim dhe pastaj, ne sot do të marrim edhe një qëndrim tjetër, t'i lusim këshillat e fshatrave që të takohen, secili fshat të na bjer nga disa emra, në mënyrë që ne ta formojmë Listën rezervë si Kuvend Komunal, siç e kishin të gjitha komunat e Kosovës, vetëm ne nuk kishim. Dhe, pasi të bëhet Lista rezervë, atëherë ne mund t'i hyjmë procedurës. Gjithashtu, është bërë edhe një keqkuptim. Nuk është pru vendimi që t'i ndërrohet emri krejt rrugës, por që të bëhet një segment i rrugës, të shndërrohet nga "Hajdet" në "Haxhi Rrahmani". Kështu që, për këtë qëllim, i lus asambleistët që ta fusin në rend dite këtë çështje, sepse jemi të obliguar që vendimet që i kthen Ministria me i rishqyrtue. Ju pastaj, kur të vjen puna e rishqyrtimit, ju mundeni me votue qysh të doni. Por edhe tash e keni të drejtën me votue pro ose kundër, ajo është çështje e juaja, mirëpo nuk jemi të padijshëm, por ne kërkesat e qytetarëve, petitionin e qytetarëve kemi dashtë ta çojmë në vend, Ministria ka kërkuar që këta emra të ndërrohen në bazë të Listës rezervë. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryesuese! Të nderuar të pranishëm! Kur folëm për pikën e rendit të ditës e cila i përkiste ndërrimit të emrit të rrugës, ne si LVV abstenuam edhe nuk u përziem, se aty vërejtëm edhe besuam që nuk ka pas të plotësuar kritere. Mirëpo, përpara se të vijë një pikë e rendit të ditës, është mirë me hulumtue a kemi të drejtë me marrë na një vendim. Patjetër që duhet me votue për me e shfuqizue këtë Vendim, se na ka urdhërue Ministria. Mirëpo ju, të nderuar ekzekutiv, e keni pas shumë të lehtë me i kqyr rregullat, me lexue ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e emërimit të rrugëve. E keni shumë të thjeshtë, e keni online secilin ligj për secilin vendim që mendoni me e marrë. Për këto është mirë me shfletue edhe me lexue paraprakisht, mos me na pru edhe vu në lajthitje edhe neve si delegatë, se mandej po diferencohemi, kush po e mbështet e kush jo, se ne kemi votues të të gjitha subjekteve, edhe në atë rrugën ku është bërë kërkesa për me e ndërrue emrin. Kryetari tha që ekzistojnë këshillat e fshatrave, ka me i lut ata për me pru emra. Këshillat e fshatrave, edhe pse i kemi vendos na, shumica janë jashtë funksionit edhe jofunksional, për arsye se peshën të cilën ata e bartin ua keni zbehë ju si qeverisje. Thjesht, ata nuk dojnë me marrë pjesë në shumicën e vendimeve të cilat juve ju konvenojnë, sepse në ato vendimet që s’ju konvenojnë ju as që i pyetni, as që ju intereson bile çka mendon këshilli i fshatit për atë çështje. Kështu që, është mirë me shfletue përpara se me e fut në rend të ditës një pikë të re, me hulumtue se a kemi të drejtë apo jo, ose të paktën me i dijtë procedurat të cilat duhet t’i ndjekim për me e marrë një vendim për një pikë të rendit të ditës. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Faleminderit, kryesuese! Nuk desha të të replikoj, kryetar. Unë paraprakisht kërkova falje, thashë fillimisht po kërkoj falje për fjalën ‘të padijshëm’. Po ju vetë e vërtetuat tash, nuk ka një minutë, thaje nuk e kemi ditë se duhet të ketë emërtime rezervë. Do të thotë, fjala ‘nuk e kemi ditë’ a nuk i bjer se jeni të padijshëm? Vetë deklarove tash. Përderisa bëhen këto emërtime nga njerëz të cilët nuk i përkasin fushës për emërtime, ne do të kemi gjithmonë këso gabime. Përderisa nuk konsultohemi ne si Kuvend, pavarësisht se çfarë dokumentacioni e çojmë në qendër, në Prishtinë, gjithmonë kanë me na u kthye prapë. Për emërtimin e vendbanimeve ke ekspertë, kryetar, mos e lodh kokën. Nëse e përcjellish ekipin planer për emërtimet e vendbanimeve, kurrë s’ke me dështue. Nëse ju, por edhe qeveria paraprake – nuk po arsyetoj – ka bo emërtime ashtu siç ka desht qëllimet e veta t’i realizojë, gjithmonë kemi me pas dhe do të kemi edhe në të ardhmen kthime nga MAPL-ja. Kështu që, vetë deklarove se nuk e keni ditë se duhet të ketë emërtime rezervë. Fjala ‘nuk e kemi ditë’, unë nuk e di si i bjer. Të padijshëm!

Shpetim Hajredini: I nderuar kryetar, tash besoj që je i ngarkuar edhe s’e di sa mun i mban në mend, po a e din që ndoshta çdo vendim që e kena marrë këtu në Asamble Komunale për herë të parë, na u kthye prapë prej MAPL-së. Ju e dini që në fjalimet e mia, besoj që mundohem maksimalisht mos ta prek askënd, mos ta ofendoj. Edhe nuk është ofendim nëse e them unë që gati çdo vendim na është kthyer prapë, se ky është realitet. Nuk duhet me u ofendue askush për një realitet. Edhe në qoftë se

është i hidhur, ne s'kemi çka bëjmë. Edhe nuk përdora fjalë fyese, nuk thashë të padijshëm e as asgjë, por ajo që është realitet është realitet. Prandaj, çdo herë, pas çdo vendimi e kam thënë dhe e kam specifikue: Kryetar, ekzekutiv, në sillni bre vendimin apo arsyetimin e ministrive përkatëse për një vendim të juajin që e keni marrë dhe ju është kthye prapë. Çfarë aryetimi kanë, na bjer bre dokumentin. Edhe asgjë tjetër nuk kërkova, vetëm na sillni këtë arsyetim, që ne ta lexojmë, e lexojmë, pastaj është çështje tjetër ne nëse vendosim ta votojmë, ta mbështesim ose jo. Por arsyetimin na sillni! Edhe u krye! Nuk besoj që keni farë ngarkesë aq të madhe me na e sjellë arsyetimin. Bon vaki është një fletë A4, e printojsh, na sjellish edhe u krye puna, atëherë ne jemi të qartë në këtë drejtim, edhe nuk kisha dalë fare bile të diskutojë për këtë çështje. Jeni apo s'jeni të aftë, ju e dini, juve ju ka votue populli, edhe për këto katër vite vazhdoni e menaxhoni Komunën ashtu si dini ju. Vijnë zgjedhjet e ardhshme, atëherë ata vendosin prapë nëse keni qenë mirë apo jo. Sa i përket çështjes që e përmende, që ne nuk e kena bo, kjo çështja e rezervës që thajë të emërtimit, ka të bëjë shumë vite, ndoshta ka qenë në atë kohë Salimi, se sa i përket Shabanit e di që nuk kena marrë vendime të tilla edhe nuk kena bo emërtime të rrugëve, me sa e mbaj në mend. Nëse nuk e kanë boa ta, bëne ju. Bëne ju, ne nuk e kemi bo, ju bëne. Po mos të na kthehen prapë, se vallahe besoj që po dalim keq shumë. Se çdo herë po na kthehen prapë. Megjithatë, ju prapë vazhdone se – po e shoh që po do me më replikue – s'është problem, del këtu me repliko, ta Samidin. Mujsh me marrë fjalën edhe me m'replikue. Unë asnjëherë katër vitet e kaluara nuk të kam replikue dhe asnjëherë nuk të kam thënë që keq e ke. Po edhe unë jam argumentues, çka po dësh me të argumentue ma shumë, a po dësh me t'i pru krejt vendimet që të janë kthye mbrapsht? Nuk jam t'u folë jashtë ligjit, jam t'u folë vetëm brenda kuadrit të rrethanave dhe kësaj çështje që po e diskutojmë na. Kur të kam akuzue ty, hajt më trego? Ose ekzekutivin? Unë gjithmonë e them realitetin.

Nedžmidin Sejdilar: Nuk e di nëse jeni njohur kryesuese me LVL-, ju e bëni agjendën me Kryetarin. Për këtë Vendim që na e ktheu Ministria, kur ju keni të drejtën ekskluzive të hartoni rendin e ditës, kur jeni qeveri, është logjike që ne nga opozita të propozojmë ndryshim të rendit të ditës, ju jeni nga qeveria, duhet të bashkëpunoni me drejtuesin e shkëlqyer dhe të përfshini në rendin e ditës tuaj çdo vendim që Ministria e ktheu dhe ta dërgoni në material brenda afatit ligjor. Më intereson nëse ai vendim është marrë para dërgimit të materialit apo më pas. Dhe pse duhet ta ndryshojmë axhendën tani? Pse po nxitoni dhe po nxjerrni gjithçka nga errësira? Ne duhet të dimë çdo vendim, prandaj njerëzit na dërguan këtu. Nuk e kuptoj dot logjikën e sjelljes suaj politike. Lëri qytetarët të shohin se nuk jeni të ndërgjegjshëm dhe jo serioz.

Uran Halimi: Faleminderit, kryesuese! Më fal që po duhet me e bo punën e kryesueses, në fakt s'po due me e bo punën, po thjesht po due me e bo një sqarim. Dje në KPF ne kemi votue pro që kjo me u fut si pikë e rendit të ditës për shkak të afatit kohor. Ne arsyet i dhamë, edhe kryetari i dha arsyet, tha s'e kemi ditë, duhet me e shfuqizue. Tash na nuk po emërojmë rrugë tjera, as nuk po bëjmë listë të

veçantë, ne thjesht duhet me e shfuqizue për shkak se jemi urdhërue nga MAPL-ja. Thjesht, është një pikë e rendit të ditës që ne kemi votue joligjshëm për të. Sa i përket Rregullores së Kuvendit edhe që tha Nedžmidin Sejdlar që një kryesues e kemi, arsyet e dimë që kanë qenë të pabaza edhe të paqëndrueshme. Po e vërej një protestë të z.Samidin Xheladini, i cili – kur e kanë ngrit mocionin kanë thënë shkelje e vazhdueshme e Rregullores së Kuvendit – të vetmit janë ata që e kanë shkelë vazhdimisht Rregulloren e Kuvendit, po vazhdon me e shkelë, do me e bo kryesuesin prej ulëses atje krejt në fund, e na kallxon neve a duhet na me thënë, ose a duhet me e marrë fjalën një herë ose dy ose tre. Ne kemi zgjedhë kryesuese, e keni votue me shumicë të votave kryesuesen, Samidin, s’ke nevojë me e bo kryesuesin këtu, se s’je kryesues. E di që e ke pas ëndërr edhe dëshirë, s’ta kanë mundësue partia jote. Na kemi pas dëshirë ti me qenë kryesues, po të kishe qenë këtu, na kishe kallxue sa herë e marrim fjalën. Ti nuk je këtu, të lutem! Mos ta degradojmë Kuvendin këtu pa nevojë. Kryesuesja na jep fjalën, ne e dimë çka themi.

Arijeta Skeraj: Falemnderit, a do dikush tjetër me e marrë fjalën? Pasi jo, deshta edhe një sqarim. KPF-ja ka të gjithë anëtarët e të gjitha partive politike që janë më me shumicë në Kuvendin e Komunës së Dragashit. Vendimi ka qenë që kjo pikë të kalojë sot për seancë. Atëherë, me këtë pikë do ta qes në votim rendin e ditës. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 15 vota pro, 8 kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës bashkë me këtë pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën e parë: Dhënia e betimit të anëtarit të zëvendësuar nga KQZ-ja, z.Gazmend Ramadani. E lusim për ta dhënë betimin!

Gazmend Ramadani: Përshëndetje për të gjithë! Unë Gazmend Ramadani, betohem se do të kryej me nder, besnikëri, pa anime, me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat, dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Dragashit, në mënyrë që të sigurojmë kushte për një jetë më të mirë për të gjithë. Ju falemnderit!

Arijeta Skeraj: Falemnderit, z.Gazmend! Urime dhe suksese në punën tuaj! Atëherë fillojmë te pika e dytë: Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar. Kush do me e marrë fjalën? Atëherë, e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të procesverbalit nga seanca e kaluar? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, miratojmë procesverbalin nga seanca e kaluar. Atëherë vazhdojmë me pikën e tretë: Propozim – vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës P-70604038-00244-4 ZK Shajne. A do dikush me e marrë fjalën?

Qamil Kolloni: Përshëndetje kryetar, kryesuese, delegatë dhe të gjithë ju të pranishëm! Parcela të cilën e kemi paraqit që të jepet në zhfrytëzim afatgjatë, i takon zonës së biznesit, dhe presim që të zhvillohen të gjitha procedurat. Unë mendoj se të gjithë delegatët duhet të ndihen komod, për faktin se kemi interesim që të zhvillohet ajo zonë, dhe njëkohësisht jemi duke iu përmbajtur procedurave të cilat

shkojnë përmes ankandit publik dhe kësaj sallës së Kuvendit. Ju ftoj që ta votoni këtë propozim, që të procedohet brenda kësaj séance.

Uran Halimi: Sa i përket asaj pjesës, me siguri është bë kërkesë – a po drejtor – që ajo parcelë të dalë në dhënie. Është shpreh interesim. Është mirë që na përveç asaj parcelës me i qit edhe disa parcela tjera, po besoj se munden me shfaq interesim edhe dikush tjetër. E pse me qenë veç një parcelë, kur ajo zonë qysh e di unë është e shpallur zonë ekonomike, a po? Është mirë me i qit disa parcela, meqenëse nashta janë të pashfrytëzueshme, ka mundësi që dikush tjetër i merr edhe ato tjerat. Nuk jam kundër kësaj, po jam pro asaj që me pas edhe hapësira dhe mundësi edhe për investitorë tjerë. Pse veç një parcelë me dalë aty kur ka pjesë të lira. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Faleminderit për pyetjen! Realisht, në qoftë se e ke parë Listën e përgjithshme dhe të veçantë për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, përpos kësaj parcelës janë edhe parcelat tjera rezervë që i kemi paraparë për dhënie në shfrytëzim dhe në momentin, në bazë të Rregullores ekzistuese për dhënien në shfrytëzim në zonën ekonomike, derisa nuk miratohet ligji që është në përpunim e sipër për dhënien në shfrytëzim të zonave industriale, do të thotë shkojnë përmes vendimit të Kuvendit. Kurse në qoftë se i shikon këto dy lista, kemi edhe vende tjera rezervë që brenda këtij viti, në qoftë se shprehin interes bizneset që ta aplikojnë, në bazë të Rregullores ekzistuese e cila është miratue që në vitin 2009 po nga ky Kuvend, realisht ne kemi hapësirë secilit biznes t'i ofrojmë në atë zonë. Prandaj, nuk ju paraqet kurrëfarë vështirësie, është pjesa e paraqitur për këtë zonë, do të krijohet ky komision, do ta vlerësojë komisioni, në qoftë se nuk i përmbush kriteret nuk do të thotë se operatori mund ta merr në shfrytëzim atë pronë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, drejtor! A do dikush tjetër ta marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim këtë Propozim-vendim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë pikë. Kalojmë te pika e katërt: Propozim – vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës P-70604038-00244-4 ZK Shajne. Është fjala për Komisionin për këtë parcelën. Atëherë, pasi që PDK-ja është parti me më shumë anëtarë, e ftojmë përfaqësuesin e tyre që ta japë një emër për këtë Komision.

Shpetim Hajredini: Faleminderit, e nderuar kryesuese! Në emër të PDK-së e propozojmë z. Sevim Avdullahu që të jetë në këtë Komision.

Mehmet Spahiu: Në emër të LDK-së e propozojmë Gazmend Ramadanin.

Arijeta Skeraj: Atëherë, nga OJQ-të është Sinan Qafleshi nga Klubi i Shahut “SHARRI”. Tash po e qesim në votim. Prej ekzekutivit është Isljam Redzeplar dhe Ramadan Krasniqi, nga PDK-ja është Sevim Avdullahu, nga LDK-ja Gazmend Ramadani dhe Sinan Qafleshi nga OJQ. Kush është pro këtij Komisioni? A ka kundër? Abstenim? Me 18 vota pro, zero kundër dhe 3 abstenime, miratohet

Komisioni. Kalojmë te pika e pestë: Raporti Financiar tetor – dhjetor 2023 (tremujori i katërt i vitit 2023).

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, Raporti Financiar në baza periodike është obligim ligjor i çdo subjekti të sektorit publik dhe bazohet në dispozitat e Nenit 45 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike. Neni 45.4 i këtij ligji obligon kryetarin e Komunës që të përgatisë dhe të dorëzojë në Kuvend raportet periodike të cilat mbulojnë vitin fiskal, brenda afatit prej 30 ditësh nga përfundimi i periudhës raportuese. Materialin ju e keni marrë përmes formës elektronike, unë nuk kam nevojë me ua humb kohën tuaj të çmuar, me e lexue materialin, jemi në disponimin tuaj nëse ka pyetje, paqartësi. Pasi të diskutoni ju, unë ose drejtori i Financave del ju jep sqarime, ose ndonjë drejtor tjetër. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Nëse situata në një komunë është 41.3% e komunitetit joshumicë dhe ju formoni një komision prej 5 anëtarësh, sa anëtarë nga komuniteti joshumicë duhet të jenë në atë komision. Ju formuat një komision me vetëm një anëtar. Nëse do të jetojmë vëllazërisht, duhet të ndajmë gjithçka vëllazërore. Për 64 ditë pune keni shpenzuar 83.000 euro për mëditje si keni mund.

Uran Halimi: Sa i përket pikës së rendit të ditës, te Raporti buxhetor, aty dihet edhe shihet shumë qartë se, para përfundimit të vitit investime kapitale kanë qenë diku një përqindje shumë e ulët dhe minimale, ndërsa në fund të vitit kryetari u çue dhe tha që e kemi shpenzue buxhetin diku 90 e kusur përqind, 97% ose qeshtu diçka. E di që ekzistojnë shumë projekte të pagume edhe të papërfundume, atë e di edhe kryetari. Po ndërlihem me një reagim që e ka bo LVV-ja, ku kryetari e ka shpërnda atë reagimin edhe ka thënë se kur nuk dijshtë mirë me pyet. Edhe ka dhënë si arsytim që ato para janë shpenzue duke i future në të edhe transportin e nxënësve, domethënë bartjen e nxënësve nëpër shkolla. Kryetar, bartjen e nxënësve nëpër shkolla e dinë krejt qytetarët që e ke bo me tender. Edhe, është mirë, kur ta bëjsh një reagim, së pari mos me e rrejt veten e pastaj qytetarët. Transporti i nxënësve, qytetarë të nderuar, është bo me tender enkas nga Komuna, ndërsa reagimin që e ka bo LVV-ja lidhur me shpenzimet brenda vendit, ka qenë shumë i vërtetë edhe i bazuar në argumente. Kështu që, kur mos të dini, është mirë me pyet, të paktën jo me pyet, po me lexue se keni mundësi plot. Faleminderit shumë!

Bexhet Xheladini: Të njëjtën pyetje e ka bo edhe Nedžmidin Sejdila siç po e shoh, edhe ju si LVV. Ju keni bo edhe një reagim përmes rrjeteve sociale. Unë i jam përgjigj atij reagimit dhe qëndroj mbrapa atij. Unë e kam marrë dokumentacionin nga Thesari të cilin e udhëheq LVV-ja në qendër. Shkruan kështu: Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare brenda vendit – transporti i nxënësve, transporti i nxënësve, transporti i nxënësve, transporti i nxënësve etj.etj., 95% të mjeteve është transporti i nxënësve. Unë po ia afrojmë edhe kamerës këtë dokument. Ky dokument është i Thesarit, kush nuk beson munden me ardhë me e pa. Kjo është përgjigjja për të dytë, edhe për Nedžmidin Sejdilarin edhe për LVV-në. Edhe mallrat dhe shërbimet, nëse tejkalojnë 100 eurshin, shkojnë me tender. Çdo gjë shkon me tender. Unë ta jap tash, e shohish ti, ky është dokument i Ministrisë së Financave.

Uran Halimi: Unë kam thënë edhe në këtë foltore, edhe ma herët, edhe aty kur kam qenë ulur në vend të kryesueses tash, kam thënë kur ta bëni një reagim, ju lutem argumentone. Kryetar, ti ishe lodhë shumë t'u bo tag, nja 20-30 vetë aty, t'u e përfshi edhe djalit tënd. Te ai postimi, i ke kallxue edhe djalit tënd që ka gabue LVV-ja, është mirë familjarët mos me i përfshi shumë në politikë, pot i e ke bo sidoqoftë. Kur ta bëjsh një reagim, bashkangjitja ni argument atij reagimi, ju thashë edhe ma herët. Nuk reagoget hajde shpërndaje edhe do fjalë të hoxhallarëve në to, se politika nuk funksionon ashtu. Politika do ligj edhe do argumente. Ju lutem – çdo reagim – edhe te rasti i mjaltit aty, kur kemi reague si LVV, keni marrë po bashkangjitni video aty. U kërkue certifikatë, nuk është kërkue video. Ka dokumentacion që duhet me e bashkangjit, o kryetar. Je kryetar qetash, me reague një qytetar i thjeshtë nuk ia zë shumë për të madhe, veç kryetari i vendit, drejtora, ekzekutiv, goxha keni barrë mbi vete. Ju lutem, një reagim ia ofroni qytetarit, të duhurin, të argumentum. Edhe, s'kemi nevojë me e diskutue na këtu, se na këtu po diskutojmë për një reagim në Facebook. Në Facebook duhet me reague me argumente dhe me fakte. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Vitin e kaluar i keni transportuar fëmijët tuaj në shkollë. Sipas tabelave tuaja nga viti 2022, çmimi tani është rritur në 83,000 euro, a është rritur numri i studentëve. Vitin e kaluar keni shpenzuar rreth 15.000 euro, sivjet 83.000 euro, jam i hutuar, njerëzit po shpërngulen, ka më pak studentë, dhe tani keni 527% më shumë shpenzime udhëtimi në vend dhe po justifikoheni se keni transportuar studentë. Unë jam duke kërkuar për një përgjigje.

Bexhet Xheladini: Lidhur me postimin e LVV-së në rrjete sociale, unë kam reague për arsye se është përmend emri im. Edhe i stafit, do të thotë kryetari me stafin e tij. Unë kam thënë, nëse nuk dijshe duhet me pyet, nuk është turp. Edhe argumenti është, që të gjitha këto shpenzimet (95%) janë për transportin e nxënësve. Sa i përket reagimit që e bëri zotëriu, ju e dini që transporti masiv i të gjithë nxënësve ka fillue këtë vit, jo vitin e kaluar, jo në vitin 2022. Gjithashtu, ne në vitin 2022 e kemi bërë transportin e nxënësve edhe me autobusë të Komunës. Këtë vit ne, edhe në pjesën ku jeton komuniteti joshumicë e bëjmë transportin e nxënësve me tender, me kompani private. Për atë është edhe shuma. Kurse vitin e kaluar ne transportin e nxënësve nëpër shkolla fillore nuk e kemi bërë, pastaj transportin e nxënësve për shkollë të mesme, pagesën e kanë bërë prindërit apo personat. Gjithashtu, transportin e nxënësve të cilët e kryejnë praktikën në Prizren – nga paralelja e shkollës së mjekësisë – vitin e kaluar e kemi bërë me autobus të Komunës, ne tash e bëjmë me kompani private. Për atë janë këto shpenzimet që janë paraqit aty, dhe të gjitha janë në baza ligjore, me tender. Nuk është përfituese vetëm një kompani, janë disa, thuajse të gjitha kompanitë që operojnë në Komunën e Dragashit. Kështu që, argumente më të madh se me ta qit para kamerave dokumentin e Ministrisë së Financave, të Thesarit, nuk ka argument më të madh. Për sqarime tjera janë paraqit edhe drejtorët tjerë, mund të japin edhe më shumë sqarime. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Të nderuar delegatë, unë deshta vetëm me dhënë një sqarim, se ka një moskuptim, sepse kur po thuhet me tender po mendohet se është investim kapital ose ndonjë projekt tjetër. Duhet ta keni të qartë se në listë shkruan ‘shpenzimet për mallra dhe shërbime’ dhe këto shpenzime kanë një kod të cilin e vendos Qeveria. Udhëtimet në vend është edhe emërimi të cilin e vendos Qeveris dhe faturat të cilat vihen me kontratën për shërbime që kryen, që e ka nënshkruar Komuna jonë, për bartjen massive të nxënësve, që ka qenë premtim elektorale dhe është insistue edhe prej delegatëve të këtij Kuvendi, është arrit që të kryhen të gjitha procedurat e rregullta të prokurimit dhe na ka ardhë si kontratë e cila, në bazë të kodit 13130, të gjitha këto shërbime paguhen në këtë kod dhe me këtë emërim. Dhe tash, përpos tyre kemi nxënës, kemi udhëtimin në Prizren që shkojnë nxënësit për praktikë, dhe i kemi edhe vizitat studimore, që i kemi çue me autobus, të Zyrës për Barazi Gjinore, me të njëjtin kod. Këto kanë ndikue në rritjen e kësaj shume dhe janë të gjitha këto shpenzime. Pra, është një shërbim që e kryen Komuna përmes kontratës publike e cila është e nënshkruar në Zyrën e Prokurimit. Kaq, nuk keni nevojë me dramatizue këtë çështje. Ka mundësi mos me qenë të qarta, por është kod që nuk mund ta ndryshojë zyrtari në momentin kur bën pagesën e kësaj kontrate.

Vetim Ramadani: E nderuar kryesuese, faleminderit për fjalën! I nderum kryetar, të nderuar asambleistë, media dhe qytetarë që po na përcillni! Po e shoh të arsyeshme më shumë me diskutue, sa i përket shpenzimeve se si është bërë në kodin 13130, sa i përket shpenzimeve brenda vendit për transport. Duhet theksuar se, përveç transportit të nxënësve, në këtë kategori – kryetari i kaloi në shpejtësi të gjitha pagesat, mirëpo janë diku 12 faqe pagesa, që janë të evidentuara, ku përveç transportit që është kategoria më e madhe shpenzuese, kemi të bëjmë edhe me praktikën që zhvillohet në Spitalin e Prizrenit; kemi të bëjmë me aktivitete siç janë të kërkuara nga Qeveria, për shembull me rastin e 17 Shkurtit, organizimi i transportit për nxënësit në mënyrë simbolike t’i dhezin qirinjtë në sheshin ‘Skënderbeu’ në Prishtinë. Kemi gjithashtu festat e 8 Marsit, vizita në Drenas, që është organizuar me Zyrën për Barazi Gjinore në kuadër të Kuvendit Komunal. Pra, janë një sërë aktivitetesh që janë paguar në këtë kod buxhetor, gjë për të cilat cilido nga asambleistët mund të vijë në zyrat e Departamentit të Financave, t’i shohin nga afër dhe të sigurohen se të gjitha këto janë në rregull. Sa i përket faktit që u ndërlidh me videot që poston drejtori i Administratës, unë me sa e di Facebook-u është oborr i jemi. Unë e di që i përcjellish storiet e mia. Unë s’të kam shok, po shpeshhehrë më dalish, i kam me screenshot, t’i qes këtu. E di, po mos harri një send, unë veç të shoh përmas. Personi kur nuk është friends me dikënd, s’ka nevojë me hi me e pa. Unë e di që për ty ngjall atraksion kjo punë, po akuza që ma keni bërë ka qenë e ulët. Nëse më zëni me një keqpërdorim, unë publikisht ju sfidoj, më çoni në prokurori. Vëlla me më pas, mos ma falni! Më çoni në prokurori, ku të mundeni, deri në Gjyaktë Speciale e në Gjykatë të Strasburgit. Veç, me qit për 70 euro përfitim, kur Qeveria jote në qendër m’i ka dhënë mu 700 euro. Unë para së gjithash jam qytetar i lirë i këtij vendi, që e gëzoj të drejtën legjitime

si çdokush me konkurrue, se ajo qeveri, qoftë e VV-së, qoftë e LDK-së, qoftë e PDK-së, është qeveri e jemja. Albin Kurti është kryeministër i jemi, dashta apo nuk dashta unë me e pranue. Edhe unë kam të drejtë benefitet që i ofron ai me i përvetësue. A është e ligjshme a e paligjshme? Unë jam pikërisht ai fermer që jam regjistruar, i kam ndjek procedurat, e kam NIF-in tim, Numrin Identifikues të Fermerit, edhe biznesi im familjar është, nuk është i djeshit. Prej '87-tës kemi bletë, edhe nuk është çudi që nashta një filxhan mjaltë e ke provue edhe ti gjatë jetës tënde. Edhe nuk është korrekte kjo punë. Tjetra, unë si drejtor i Administratës e bëj edhe deklarin vjetor të pasurisë. Deri sot, ende as edhe paralajmërimi më i vogël, sepse AKK-ja – të kisha lut ta përfundoj, nuk është telashe, unë e di që të pengon biografia jeme, po njerëzit e pasur është vështirë me i kap. Unë në deklarin të pasurisë asnjëherë nuk kam pas vërejtje edhe më të vogël për ndonjë sinjalizim të korrupsionit ose diçka të ngjashme. Nëse do të kisha pas, unë jam në gjendje qysh sot, le ta bjer një vendim dikush, unë i kthej. Kurrë s'jam bo derë për 70 euro edhe s'bëhem. 700 s'jam bo derë që m'i ka dhënë Albin Kurti, e për 70 euro të Komunës. A, sa për që i qes videot e mjaltit, i kam qit me kallxue edhe një send, Uran. Të çojmë te shpia edhe të lëmë omël. Faleminderit!

Uran Halimi: Tash, hiç rastësisht thonë që ku dhemb dhëmbi shkon gjuha. Unë kurrë nuk thashë ma shumë, veç kërkova me e argumentue para qytetarëve. Kur ta bëjsh reagimin në Facebook, edhe kryetari edhe ti, është mirë me e qit edhe një argument. Qeto s'po jau rrok juve. Qetash, te kryetari, e pat argumentin – sipas tij – që jau qiti kamerave, se kamerave jau kthej edhe unë një fletë këtu, po s'kanë mundësi ata me foksue edhe me pa. Kurse Facebook-u është shumë i pastër aty, dokument zyrtar. Sidoqoftë, te mjalti yt, i nderum – po de, i biznesit të juaj – te reagimi në Facebook që na e kemi bo, njëra prej kriterëve kur ju e keni shpallë aplikacionet për me i dorëzue fermerët, e keni shpallë konkursin ose çkadoqoftë ai, shkruan që aty duhet me u dorëzue certifikata e Ministrisë. Domethënë, me atë certifikatë ti kallxon numrin e bletëve që i posedojsh. Ti nuk më ke kallxue sa bletë i posedojsh, certifikatë nuk ke kallxue sa bletë posedojsh. Kie prej atyre që i keni subvencionue me atë mjaltin që e keni pelim. Nesje, sidoqoftë, drejtori i Administratës 70 euro i ka përvetësue, tha kemi të drejtë me përvetësue. Jo me përvetësue, me përfitue drejtor. Me përvetësue, s'bën me përvetësue diçka që s'është e jotja. Thjesht, ju keni të drejtë me përfitue subvencionimin, që edhe qysh e lavdove kryeministrin tonë. Mirëpo, jo me e përvetësue. Edhe, 70 euro qysh tha – s'fikem – s'kemi nevojë me i kthye ato kur ti i marrish me meritë qysh po thuesh. Ama, te reagimet – unë jau kam thënë edhe në Kuvend edhe më herët – te reagimet bashkangjitni fakte. Këtë e keni të metë, gabim jeni. E, sa i përket mjaltit që nashta unë e kam provue – zakonisht mjaltë s'përdori, shumë sinqerisht po e them, se jam kah e njelmëta ma shumë, se edhe në fytyrë jam kështu i njelmët. Njëfarë mjalti jam t'u ta përgatit edhe ty, i nderuar drejtor. Do ta shijosh shumë shpejt.

Vetim Ramadani: Thashë, nuk due me ju shqetësue më shumë, se Asambleja nuk është me diskutue për mjaltin tem, sinqerisht ju kërkoj falje. Por, sa i përket atij mjaltit që po ma përgatitke, unë të thashë unë mjaltë nuk bëj, po Adem Demaçi pat thënë – se ju të VV-së e keni njëfarë... pietet kur flitini për të – e ka një shprehje të famshme, thotë: teposhtë – përpjetë, teposhtë – përpjetë. Teposhtë – përpjetë, teposhtë – përpjetë je t’u folë për qet mjaltin. Jam shumë kurioz me e pa, po të sfidoj. Veç ishalla s’është qaj mjalti që jam t’u mendue unë. Që s’e ke ditë që mbikëqyrësi i punimeve nuk guxon me qenë Vetim Ramadani, ka qenë Vetim Hasani, e ke mendue që është Vetim Ramadani, e ke thënë që po due me e çue në burg. Në burg Vetim Ramadanin e çon ënshkrimi i vet. Nëse ke, publikisht të ftoj, ekziston prokuroria, tash janë çkap institucionet. Shkoni o burra, na çoni në prokurori. Nuk due me akuzue, unë po due me qenë njeri paqësor. Ju lus me më çue në prokurori, çka ka le të qesin, nuk është problem. Mu më çoni në prokurori, unë i deklaroj të gjitha. Unë nuk thashë që kam me i kthye paret, edhe nuk bën me thënë, është keqinterpretim i fjalës time. Unë certifikatën që e kam dorëzue, certifikata ekziston më saktësisht te zyrtari Flamur Sylejmani. Zyrtari Flamur Sylejmani e ka certifikatën teme, ku unë mbaj përgjegjësi për atë deklaram që i kam 35 koshere. Komisioni ka qenë që e ka vërtetue, unë nuk e vërtetoj. Unë kam të drejtë me thënë 100 ikam. Komisioni ka qenë në terren, ka pru vendimin, edhe nga ministria kam pas komision që e ka bletishtën time. Edhe në atë komision është konstatue që e kam gjendje faktike. Unë 82 bletë i kam pas në vjeshtë, kur ka ardhë komisioni në pranverë i kam pas 35. 35 është dashtë me i deklarue. Po nuk është telashe, unë të ftoj miqësisht, rrugët e gjyqësorit janë të hapura, më dërgoni atje, japim llogari, nuk është telashe. Mu, qat ditë që më konfirmohet aktakuza, unë drejtorinë e lëshoj. Jo, pa çare s’e lëshoj, atë punë harro, po unë kam karakter asisoji, që në momentin që kam problem me ligjin, nuk e shoh të arsyeshme me qëndrue. Ju kërkoj ndjesë edhe një herë!

Munir Jonuzi: Kolegu Nedzmidin bëri një pyetje të vërtetë, ai ngriti një sërë pyetjesh, por këtu duhet të insistojmë në shpërndarjen e drejtë në gjithçka. Më e rëndësishmja është që gjatë punësimit të kemi parasysh të drejtën e fer/sheare shpërndarjen, investimet kapitale, subvencionet, mirëpo tani jemi në kuvend ku situata është ndryshe, dhe nëse llogaritet sipas shpërndarjes së drejtë, duhet të jemi. 15/12 delegatë, kjo reflektohet në mënyrë të ngjashme, në përbërje të komisionit, KPF përbëhet nga 5/2, ndërsa K.Komunitete është $\frac{3}{4}$. Kjo për shkak se KPF është formuar në bazë të numrit të mandateve të marra. Për mendimin tim, kryetarja bëri një gjë të mirë, duke i ofruar këto dy mandate partive më të mëdha dhe ato duhet të kenë përgjegjësinë më të madhe. Arsyeja e dytë është se askush nga komuniteti joshumicë nuk është interesuar dhe kjo parcelë është në një pjesë të Opoljes. Besojmë se delegatët nga Opoje janë më të njohur me situatën.

Nedzmidin Sejdilar: Faleminderit për përgjigjen tuaj. Pyetja ishte për shefin e zyrës. Të cilën po pyes tani, nëse formohet një komision prej 5 anëtarësh vetëm me një boshnjak, a është proporcional.

Arijeta Skeraj: Të kish lut që t’i përmbahesh rendit të ditës, përndryshe nuk të lë me folë!

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit në vend, shohim që shuma është rrit goxha shumë. Po arsyetoni që është në lidhje me transportin e nxënësve. Një kërkesë e kam pas si asambleist, që në fshatin Zgatar transporti i nxënësve të organizohet nga fillon fshati Zgatar, e jo prej fushës. Për të disatën herë i kam bërë kërkesë edhe personalisht drejtorit të Arsimit, drejtorit të Administratës. Nuk e di juve kryetar a ju kam bërë kërkesë për këtë pjesë. Për të disatën herë më keni premtue që ky transport do të realizohet. Ende sot nuk realizohet, ata nxënës vazhdojnë me shku në këmbë. Edhe pse këtë dimër shumica e kohës ka qenë e mirë, ata nxënës prapë nuk marrin transport. Detyrohen me ec, besoj që mbi një kilometër, edhe pse Komuna shpenzon buxhet dhe paguan nga buxheti i qytetarëve për atë transport të nxënësve. Ai transport i nxënësve ende edhe sot nuk bëhet. Ju kisha kërkuar edhe një herë publikisht, drejtorit të Arsimit, drejtorit të Administratës, kryetarit, që ta siguroni atë transport të nxënësve, për arsye se e dini qysh është rruga në Zgatar. Për arsye se buxheti shpenzohet, paguhet kompania, transporti nuk bëhet. Kisha kërkuar edhe një herë publikisht, cilido prej ekzekutivit le ta marrë si detyrim, që a do të realizohet ky transport apo nuk do të realizohet. Faleminderit shumë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë? Nëse nuk ka, atëherë e qesim në votim Raportin Financiar tetor-dhjetor 2023. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, 1 kundër edhe 3 abstenim, e miratojmë këtë pikë. Atëherë vazhdojmë te pika e gjashtë: Raporti Vjetor Financiar për vitin 2023. E hapim diskutimin.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë! Ashtu siç e thashë edhe në Raportin e katërt tremujor, që është obligim ligjor i kryetarit të Komunës ta paraqesë para Asamblesë Raportin tremujor, ashtu është e parapara edhe me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, në bazë të Statutit të Komunës edhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Lokale, që kryetari i Komunës para Asamblesë ta paraqesë Raportin detal Vjetor të Shpenzimeve Financiare për vitin 2023. Ju materialin e keni marrë, nuk due me humb kohë me e shfletue, ne do të jemi në gjendje të ju përgjigjemi në çdo pyetje të juajën dhe për çdo paqartësi të juajën. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Përshëndetje edhe një herë! Tek Raporti Financiar 2023 – kryetar – ne këtu kemi votue se për fshatin Zym, për një periudhë kohore njëvjeçare janë ndarë 25 mijë euro, të cilat 7 mijë kanë shkue në ndërtimin e urës, edhe 8 mijë në trasimin e rrugës shkollë-fushë. Në plan ka qenë edhe kubëzimi, në vlerën e mbetur rreth 10 mijë euro. Në seancën e fundit të vitit 2023, apo të paradundit, ta kam bërë një pyetje, më ke thënë se ato para i ka marrë përmbaruesi. Tash në Raportin Financiar 2023, në periudhën kohore tetor-dhjetor, shoh në atë fletushkën e juaj të cilën ju e keni arsyetue, 8280 euro shpenzime të kubëzimit në fshatin Zym. Me shifër nuk po di, ndoshta administrata është t'u përcjellë. Deshta me e ditë ku janë shpenzue për këtë periudhë kohore, meqenëse në fshatin Zym nuk ka kubëza, a në Raport shkruan kubëzimi prej 9280 euro.

Nedžmidin Sejdilar: Në raport thuhet se kemi shpenzuar gjithsej rreth 113 mijë për një vit për shpenzimet e udhëtimit brenda vendit. Dhe pak më parë thamë 83.000 euro për vetëm 3 muaj. A do të thotë kjo se ata kanë vozitur studentët vetëm për 3 muaj? Gjithashtu, kostot tuaja të pastrimit janë rritur.

Nexhat Selaj: Për arsye të korrektësisë – Qamil, masi veç më kërkove – meqenëse jemi të barabartë këtu, si kryetari ashtu edhe ne si asambleistë, derisa kryetari gëzon të drejtën që t'i afrohet kamerave dhe të shiqojë vlerën, edhe unë besoj se kam të drejtë. Lus që të fokusohet kamera! Lista e projekteve kapitale të realizuara në periudhën tetor-dhjetor 2023. Kodin – Qamil – e ke 46873. Shkruan: Kubëzimi i rrugëve në fshatin Zym – 9280 euro. Unë vij po nga ai fshat. Nëse e keni ngatërrue vitin me 2109 apo 2018, ekziston mundësia, po në 2023-tën... nëse është ndonjë shkrim i gabuar apo është i qëllimtë, nuk po e di, veç këtu po shkruan kështu. Faleminderit!

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë! Kam disa pyetje për ekzekutivin. Faqe 7, te makina fotokopjuese – 14,720 euro. Me sa unë e kuptova, 14,720 euro te shkolla – mos gabofsha – keni ble te shkolla “25 Maji” 14, 500 euro. 14,720 shkollës “15 Maji” makina fotokopjuese. Qekjo është jashtë normales, si Komunë me ia ble shkollës “25 Maji” 14 mijë euro fotokopjuese. Është për çudi! Furnizim për zyrë, nga viti paraprak 37 mijë, ju keni shkue në 77 mijë euro. Qaty afër e ke, kodi 13610. E para është 13505. Furnizim për pastrim, prej 5 mijëve keni kalue në 13 mijë euro. Unë nuk e di çfarë pastrimi jeni t’u bo. Ju ia keni ndalë buxhetin shkollave, e keni marrë ju si drejtori këtu me e menaxhue, edhe ju po e sillni qysh po doni. Po i çoni 2 shpuza, 2 xhokera, sa herë ju po doni. Se ju i keni akuzue ata ma herët që kanë marrë sa kanë dashtë, po ju sot jeni t’u i maltretue ata. Jo veç nëpër shkolla, po edhe nëpër ambulanta edhe kahmos jeni t’u e bo të njëjtin veprim. Mirëmbajtja e ndërtesave, unë s’e di çfarë ndërtesa keni mirëmbajt. Llogarite, mirëmbajtja e ndërtesave – 14020 – 48 mijë, dyfishim të buxhetit, harxhim. Kryetar, po ju pyes një send, se shumë na keni akuzue, për një vaj të 2021-tës, ku e morët këtë vajin 45 euro, ku e morët këtë vajin 45 euro, çka keni shpenzue me këtë vaj? Kush u lye me këtë vaj? Ulje, a? S’e di a kanë bo pehlivana a s’kanë bo, se me pas bo nashta ishte konë mirë, po po më vjen çudi, thashë mos kanë bo deni pehlivan. Shpenzimet e vendimeve gjyqësore, prej 13 mijë në 100 mijë euro. Kjo është një send katastrof. Unë këtu po e shoh, shpenzimet e vendimeve gjyqësore 14410, vitin e kaluar i keni paguar 13 mijë euro, domethënë në 2022-tën, në 2023-tën ju keni pague 100 mijë euro. Te shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve, normal. Diçka shumë që po më vjone interesant, nëpër shkolla, mirëmbajtje të shkollave, në shkollë të Bresanës 4800 ëuro, nuk e di as çka keni mirëmbajt. Vetë ke qenë në mbledhjen kur e kemi mbajt për buxhetin, qysh kanë qenë klasët te shkolla, edhe nuk është marrë asnjë vendim për lyerjen e tyre. Të gjitha shkollat kanë një furnizim për pastrim, mirëmbajtje të mobiljeve, nuk e ke idenë çfarë shifra ekstreme kanë shkue nga viti i kaluar në këtë vit. Edhe një çështje tjetër te ambulanta, që i keni ndarë – në mos gabofsha – 63 mijë euro. Kodi 52350 – renovim i QMF-ve në Bresanë, Llopushnik, Bellobrad, si dhe AMF-ve. Ta kam thënë dhe para dy

seancave më doket, kryetar, edhe po më vjen shumë keq, edhe e ke pa edhe në media, se qysh është QMF-ja e Bresanës në këtë gjendje. I ke ndarë veç 3 mijë euro për QMF-në e Bresanës. Turp është për këtë qeverisje që, mas spitalit që është në Dragash, më e ngarkuar është Bresana, edhe me i nda veç për me ia shtrua disa kocka banjës dhe para ambulants aty me i shtrua disa kocka, kjo është për turp. Dje unë jem konë, edhe ato lymjet e brendshme që jaë bo është për turp. Drejtori herën e kaluar u lavdue që në Kosovë ka shërbime. Po sa shërbime ka në Kosovë, o drejtor, a mundesh me më kallxue? A i bëjnë pesë veta shërbimet? Nuk jam kundër mos me intervenue, ama një send që është ma urgjente, që i merr bon vaki 100 ose 150 pacientë në ditë, me investue 3 mijë euro edhe me shkue me ia dhënë Kosovës 30 mijë euro, kjo është absurde. Veç ju mundeni me e bo këtë, nuk munden me bo tjetër kush. Ose e Llopushnikit a dikuj, nuk jam kundër për mos me investue, apat po them, ama një qendër më e madhe, është turp këtë me e bo. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Seriozisht po më vjen me qesh, se s’di pse me e përdorë fjalën turp. Po ndoshta njerëzit kur nuk kanë turp edhe e përdorin këtë si shprehje. Nuk kemi të bëjmë këtu me turp, kemi të bëjmë me punë, edhe punë shumë të ndershme. Po vetëm të më dëgjosh me vëmendje, se kam me t’i dhënë sqarimet kod për kod, sepse nganjëherë edhe kur po due me bo digression, me ik edhe me mbulue diçka që do të ishte mirë si kolektivitet ta mbulojmë, në të shumtën e rasteve, Driton, me këtë gjuhën tënde, mënyrën, shprehjen, format, po më tërheq për gjuhe me t’i thënë përkundër vullnetit disa gjëra që s’do të ishte mirë me i thënë. Po para se me mbërru diku, më ka pëlqye një thënie e mëhershme e një delegate të juaj, ka thënë po shumë politikë paqësore kemi bo. Pse? Se s’kemi punue hiç. Dhe, kur punosh, ka fjalë. Shumë normale, ka shuma të ngritura, është normale, është normale, ngrihet buxheti, kryhen punë ma shumë edhe të gjitha këto reflektohen në numra, se numrat flasin vetë. Po filloj prej kodit të parë, ju lutem përcillne secilin kod me vëmendje. E keni Raportin përfundimtar, shpenzimet për mallra dhe shërbime. Kodi 13130 – shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit: transporti i nxënësve, praktika e nxënësve të shkollës së mesme të mjekësisë në Prizren, festat e 17 Shkurtit dhe 8 Marsit, janë në vlerë 113,029.89 euro. Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit: vizitat studimore Shkodër, Turqi, Vlorë, janë 25,953.00 euro. Shpenzimet e vogla – para xhepi janë mëditjet të cilat janë pague për këto rrugëtimet të cilat keni shkue, qoftë të zyrtarëve komunalë, qoftë të delegatëve, i keni të gjitha të specifikume. Kemi vizitat në Maqedoni, Bosnjë, Japoni, Austri, Shqipëri, të gjitha këto janë bërë paradhënie. Në qoftë se keni ekonomistë në partitë e juaja, ju tregon se si shkon forma dhe procedura. Shpenzimet e internetit janë shpenzimet e internetit të cilat përfshijnë shkollat, bibliotekat, QKMF-në dhe zyrat komunale. Shpenzimet e telefonisë mobile, a ka nevojë me ju diskutue juve? Shpenzimet e shtypjes, jo marketing: kontratat me AQP-në, 3,315.24 euro, ART House. Shpenzimet kontraktuale: kontrollin teknik të automjeteve e kemi të kontraktuar, janë këtu shpenzimet, kemi kalibrimin e dozimerave në QKMF, kontratat për shërbime shëndetësore dhe ambientale, pastrimin e qytetit një herë në javë që e

bëjmë e kemi të kontraktuar. Prandaj, në këtë kod kemi krye investime në fshatin Kuk për kanalizim që na është paraqit Ad hoc, kemi në Kapre, Kosavë, Bellobrad dhe në Dragash, janë kanalizimet të cilat janë riparue dhe janë si shërbime që i kemi krye me këto kontrata. Shërbimet teknike: pajisjeve zjarrfikësve iu kemi blerë në vlerë 1930 euro, janë fshisa, shpuza për shuarjen e zjarrit dhe pompa. Shpenzimet e anëtarësimit: besoj se e dini se Komuna e Dragashit anëtare e ASK-së, gjithashtu edhe e AZHR-së. Shërbimet e varrimit: është vlera, besoj që nuk ka koment. Mobilje më pak se 1 mijë euro mobilje për shkolla dhe Administratën komunale sipas kontratës së AQP-së. Kemi kompjuterë nën 1 mijë euro, 14,670.00 euro, ku janë të përfshirë llaptopët dhe të gjithë kompjuterët për zyrët e Tatimit në Pronë, që kemi bisedue që me kërkesë të Kuvendit, për shka se nuk po i lexojnë CD-të të cilat shtypen në ministri. Kemi bërë edhe zëvendësimin e kompjuterëve për lexime dhe besoj se e mbani në mend që, gjatë vitit, pikërisht prej këtij Kuvendi kemi marrë miratimin për blerjen e këtyre kompjuterëve. Makina fotokopjuese më pak se 1 mijë euro: ju e dini se kemi probleme me printerë, kemi blerë printerë për të gjitha shkollat, për Administratën, do t'i ndajmë sepse kemi pas vështirësi me këto pajisje gjatë këtyre dy viteve. Besoj se jemi të qartë. Pajisje special mjekësore: nuk kemi pajisje tjera, realisht kemi llaptopë të asambleistëve, skanera të zyrës për printim, dhe kemi bërë ndriçimin e stadiumit e fshatit Bellobrad dhe fshatit Glloboqicë, përmes këtij kodi kemi marrë pajisje për ndriçim. Furnizimet për zyrë: kemi 77,958.00 euro të cilat, përmes kontratës i kemi prej vitit të kaluar dhe gjatë këtij viti që do t'i shfrytëzojmë si rezerva, ku hyjnë ditarë, shkumësa, letër, mbajtëse, mbështjellës, bateri etj., nëse doni po e nxjerrim specifikimin për 77 mijë euro, çka janë ble, çka janë pru ato specifikime për shkolla, materiale të ndryshme. Ose, hajdeni në zyrë, po jua lexojmë specifikacionet prej të parit deri te i mbrami, po kryesisht janë këto mjete. Furnizime me ushqim dhe pije: janë jo dreka zyrtare, koktejet e shkollave që kanë manifestime gjatë përvjetorëve, prej këtij kodit i bëjmë pagesat. Furnizimet mjekësore: besoj se e dini, për barnat emergjente. Është një shumë tepër e vogël. Furnizimi për pastrim: këtë e kemi bërë për të gjithë organizatën buxhetore. Vaj – ti djalë i mirë – në gjuhën shqipe nuk i thojnë ulje por i thojnë vaj. Vaji është për gjeneratorin e QKMF-së. Shkojmë decidivisht, kur është bërë servisimi, është dashtë që t'i ndërrohet vaji, i është ndërrue vaji, 45 euro ka kushtue. Vaj i thojnë shqip, nëse duesh ulje po t'i them, me marrë vesh ti, qe po të them ulje. Ka qenë e gjeneratorit të QKMF-së. Jo, kur keni dalë pehlivana ju, tjetër muhabet. Unë nuk të kam thënë, shko mere fjalorin, lexo shqip edhe serbisht, unë po të tregoj tash çka je t'u më thënë edhe ky është raporti im, nuk është i yti. Për raportin tënd përgjigjet dikush tjetër. Po të tregoj se nuk i thojnë ulje, i thojnë vaj. Është servisimi i gjeneratorit të QKMF-së. Le ta ketë të kjartë, le ta mbajë në mend. Nafta për ngrohjen qendrore: besoj se e dini. Për drutë janë 134,489 mijë, prej 210 mijëve kemi rënie. Nuk është çështje ajo, por e kemi bërë ndryshimin, prej djegies me dru i kemi bërë disa me naftë dhe disa me energji elektrike. Rriten shpenzimet në anën tjetër. Derivatet për gjenerator: janë 3,353 euro. Karburante për

vetura: janë 58,258 euro. Marrëveshja me KFOR-in për hapjen e rrugëve hyn në këtë kod. Gaz natyror: zero. Regjistrimi i automjeteve: besoj se e dini se çka është, 1,925 euro. Disa automjete kanë dalë prej përdorimit, për shkak se nuk janë teknikisht në gjendje të rregullt. Sigurimi i automjetve: realisht e kuptoni. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve: edhe këtë besoj se e dini. Mirëmbajtja e ndërtesave: renovimi i objektit të Komunës, mureve të bibliotekës në fshatin Bellobrad dhe Bresanë, Shtëpia e Kulturës. Këto renovime janë bërë. Mirëmbajtja e shkollave: kemi rregullimin e ujësjetës në shkollën profesionale në fshatin Shajne, korridori dhe nyjet sanitare në fshatin Bresanë dhe Brod, si dhe çerdhja në Dragash. Mirëmbajtja e autorrugëve lokale: kemi vendosjen e vazove të qytetit, riparimi dhe mbushja me zhavor e rrugës “Ndërlivadhe” në Brodosanë. Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative: 1,869 euro, riparimi pajisjeve ekzistuese të IT-së. Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve: 2,851 euro, riparimi i ngrohjes qendrore në shkollën e Llopushnikit dhe servisimi i gjeneratorit në QKMF. Mirëmbajtja rutinore: 30,714 euro, ndërtimi i rrjetit të tensionit të lartë për deponinë në Trokan, është bërë prej këtij kodit pagesa. Reklama dhe kontrata: fletushka për fushatën kundër kancerit të gjirit, njoftimet për DKA-në dhe DKRS-në. Shpenzimet për informim publik: pagesa e mediave lokale, Radio Sharrit, Radio Bambusit, përcjellja e aktiviteteve dhe manifestimeve që mbahen nën patronatin e kryetarit, pavarësia dhe të gjitha festat tjera. Drekat zyrtare: 14,236 euro, pritja e delegacioneve, presidentja, ambasadori, iftaret me KBI-në, KF “Opoja”, asambleistet, pagesa e maturanëve për darkën e maturës etj. Janë të përfshira të gjitha në këtë kod. Shpenzimet e vendimeve gjyqësore: i nderuar delegat, nuk deshta me ta thënë, të mallrat dhe shërbimet, 81,500 euro kemi pague për mësuesat shujta dhe mëditje. Edhe prej investimeve kapitale dhe prej kodeve tjera, diku gjysë milion euro na kanë bo të gjitha shujtat dhe transporti i mësuesave. Por po tregoj edhe një send, që nuk po due me ta thënë, po hajde në zyrë, hala kemi pagesa përmes përmbaruesit që vijnë para vitit 2021, që janë të qeverisë së kaluar që ka lënë borxhe të mjaftueshme. Kam me ta nxjerrë krejt listën, se qashtu po e lypish me ta thënë. Mu po më vjen marre me ju thënë juve që keni vjedhë, e unë pa vjedhë, çohesh qësish çikarma këtu, më thuesh turp. Ku është ai turp i yti? Ke me e marrë specifikacionin komplet, A deri në Zh, se sa pagesa janë bërë përmes përmbaruesit, të qeverisë së kaluar. Se ndryshe ju nuk po ndaleni.

Arijeta Skeraj: Ju kisha lut, çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë të bëjë pyetje sa herë të dojë dhe drejtori me iu përgjigj. Ju kisha lut që këto fjalë mos të përdoren gjatë Asamblesë, përndryshe do të ju ndalet fjala. Faleminderit!

Driton Ademi: Faleminderit, kryesuese! Kjo është e asambleistëve, nuk është e drejtorëve. Drejtorët thirrën na kur t'i thirrim me raportue, këta mundin me raportue. Nuk është Asambleja e drejtorëve. Shumë keq po më vjen që këta e marrin barrën, çka folin nëpër Facebook-a, çka folin nëpër zyrë, mu nuk më duhet me shkue në zyrë. Neë mu më duhet me ardhë në zyrë, është qasja në dokumente zyrtare, drejtor, mos harro, as nuk kam nevojë me të ardhë në zyrë. Veç me një kërkesë edhe e ke obligim për

më e bo atë. E para, e dyta: unë e di që ti ke lujt futboll, qashtu sikur me rahmetlinë tem, babin tem. E di që jë një dribler i fortë, po harro që mundesh me më driblue se jam djali i dikujt. Shumë mirë e di, se gjeneratë edhe shok e ka pas edhe kryetari yt. Këtë harro ti mu sot e 700 vjet që mundesh me ma bo, deri sa të jesh gjallë. Kryetar normal, kryetar në qeverisje tash, nuk jam kundër. Nuk të përmenda te shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, pop o më shtish me të përmend, pse po i përmendish autobusat, me i çue me autobusa nxënësat në Prizren. A ka autobusa kjo komunë apo nuk ka, a nuk keni mjete për me i riparue ata autobusa? Drejtori i Arsimit po ma livrit krevin. La Zeni, po më vjen shumë keq, autobusa ka, ama që s'doni me i riparue ju, e doni me lujt, nuk ka ashtu. Me ia dhënë dikujt për me i çue në Prizren, kjo është... ju mundeni me i dhënë do pare edhe me riparue atë autobusin, me i çue edhe me ia dhënë një mëditje atij shoferi. Po ju po doni me ia dhënë një kompanisë. Sa për turp, po ta shpjegoj edhe një herë, turp për mu harro që mundesh me thënë. Po unë të them ty, se ti ke sjellë këtu nepotizëm. Nepotizëm është që ke punësue familjarë, e kjo është turp për ty që je drejtor edhe ke sjellë nepotizëm. A po duesh me e ditë, me ta thënë bukfalisht, ma shqip. Mu s'mundesh me më thënë turp, a je t'u kuptue? Se ti je këtu sot, në këtë pozitë, që ti ke punësue familjarë këtu. Nëse duesh me u kap personale, mundesh me u kap personale, po unë nuk e pata asnjë qëllim, as me familjarizëm e as më kërkond. E pata qëllim çka po shoh o drejtor këtu jam t'u të folë. Nuk kam personale absolut kurgjo. Nëse vjet i ke shpenzue 20 mijë euro, sivjet i ke shpenzue 70 mijë euro, jam t'u ta bo me dije edhe t'u lyp argument pse i ke shpenzue kaq shumë pare në vitin 2023. Unë nuk e di e sata seancë është, me ty si drejtor, nashta, po më vjen që po foli edhe për disa asambleistë të tjerë, që e marrish shumë personale gjërat ty kur të kundërvihen. Jo more burrë, se s'kam personale absolut, o drejtor. Kam personale për këtë: 18 mijë, këtu po thotë furnizim për zyrë Bresanë, 18 mijë euro. Çka keni bo 18 mijë euro? Edhe një në fund: korridore të shkollës, o drejtor, korridore të shkollës ku keni lye bre në Bresanë? Kujt jeni t'u i hedhë hi syve, a bën me e ditë? Pse po e mashtroni këtë popull? Ju keni pas me ndërtimin e kulmit me i bo edhe qato, ju sot dilni edhe thoni korridore kemi lye. Po bre po, keni lye edhe korridore, hajde kqyre edhe ambulanti që ke lye korridore, qysh është ambulanta. Nuk është prej mospastërtisë, po prej punës ju të cilën jeni t'u i dhënë tenderat. Edhe EC-të haje kqyri, edhe krejt ato, nuk është pastërtia, kanë me krejt detergjentat, ama hajde kqyre punën. Po bre po, është mirë, juve bravi ju koftë, 90% keni shpenzue investime kapitale. I keni shpenzue, ama çfarë punë keni krye në terren. Unë s'di kush jau jep juve ato nënshkrime që delni sot edhe e rrehni gjyksin se na kemi bo 90%. Unë e di që keni bo 90%, po s'jeni kërkund për atë.

Qamil Kolloni: Delegatë, asnjë troh nuk ka të bëjë në personale. Ka të bëjë me fjalorin tënd, kur u drejtove turp. Në qoftë se ka lak, ka në fjali. Numrat janë shumë kokëfortë, nuk të lënë me rrejt. 18 mijë e 500 euro janë para 2021-tës, shpenzime kontigjente ose gjyqësore. Fjalën turp e përdore dhe nuk deshta me hy në atë 20 mijë eurshin e 40 mijë eurshin. Asnjë sqarim nuk të dhashë a është bë mirë, a

nuk është bënë mirë. Drejtorja e Financave ta jep gjendjen faktike. Janë inxhinierët, është komisioni i cili e bën vlerësimin dhe e pranon punën. Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave lëshon paratë. Për atë i ke procedurat tjera që mund t'i qesësh në gjyq. A është bënë në Bresanë a është bënë në Billushë a ku është bënë, është e drejtë e jotja, këtë nuk ta kufizoj kurrë, po ta kufizoj të drejtën të kontestosh edhe të fyesh. Sepse fjalën turp unë nuk e përdora. Të lutem, këtij fjalori përmbaju! Prandaj, derisa dijshe kështu me e përdor fjalën turp, edhe mu ka mundësi mos me më ardhë turp. A për sa me luajt futboll, po i dijshe xhaiqat, unë nuk e di atë punë të xhaiqllëkit, se numrat nuk kanë xhaiqllëk. Atë të jesh ti i bindur, shumë direkt është, se i ke numrat që nuk lënë me luajt asnjë troh. Në qoftë se këto raporte nuk përputhen me komisionet të cilat i kanë pranuar punimet, atëherë unë jam përgjegjës. Jo të përdorësh ty kur të teket fjalën turp, turp, qeverisje, qeverisje. Çka jemi na? Ta sqarova për secilin kod veç e veç cilat shpenzime kanë hy aty.

Artan Loshaj: Përhëndetje për të gjithë! znj.Kryesues, në mënyrë shoqërore po të lutem, na krijoni kushte për punë! Drejtorët e kryetarit nuk janë në bord të drejtorëve këtu. Janë në Asamblenë Komunale, në Kuvendin ku floën kuvendari, ku është i zgjedhur direkt prej popullit, e jo këshilltarët e kryetarit. Me ligj dhe rregull, vetëm kryetari i Komunës ka të drejtë të na japë përgjegjësi neve këtu, se ky është i zgjedhur direkt prej popullit. Gjatë gjithë seancës, edhe prej vendit, edhe rivalitetin që kanë drejtorët mes vete po dojnë me e shpreh këtu, është herët fushata. Ne i dimë shumë mirë – unë thashë edhe një herë- veç kryetari ka të drejtë me na dhënë neve përgjegjësi këtu. Na folim për Raportin Financiar, kryetari na jep përgjegjësi, çohet drejtori i Financave, qysh e ka adret me na ofendue secilin delegat, e pat me mu, u largue prej meje, po e qet me Dritonin e do t'ia nis me rend. Nuk tolerojmë – unë thashë edhe një herë – kërkoh, ose përndryshe do të lypim me u mbyllë seanca. Nuk ka kushte për punë. Prej vendit na akuzoni. Çohet drejtori i nderum i Administratës, rivalitetet me drejtorin e vet, se i dimë na ato politikat, janë afër zgjedhjet, në këtë foltore mos i lë bre. S'jemi për politika ditore të tyre. Kjo është e kuvendarëve, kjo është e popullit, kjo është e jona. Të lutem – edhe një herë thashë – nuk janë në bordin e drejtorëve, janë në Asamble. Nuk ka të drejtë drejtori pa i bënë thirrje ne delegatët, nuk ka të drejtë me dalë në foltore me bo replika. Tip o më thirrish mu më dalë në seancë, ai po ma merr të drejtën e fjalës edhe ndërhy. Kjo është... gabim e ka. Të lutem – tash si motër po lutem, mos lejo, se na në mënyrë demonstrative krejt PDK-ja do të dalim prej seancës, se nuk ka kushte. 14 vite drejtorin kqyrni lajmet, 14 vite kemi durue. Hajduta, të padijshëm, uji i vokët, uji ashtu... kqyrni more çka keni bo 14 vite. Ju kemi durue në mënyrën më të mirë të mundshme, asnjë ofendim një delegat nuk e ka pas nga ekzekutivi, 14 vite. Qaj kryetar, cilido qoftë, delegatin e opozitës e ka thirrë edhe për buxhetin me e konsultue. Bile neve n aka largue ma shumë se këta. E ka afrue, se jemi qeverisje, e jo me na ofendue qysh e ka adret, po mos po i vjen fundi. Edhe na dimë me pengue, jo prej vendit po dimë edhe qetu me

jau nalë me folë. Asnjë drejtor të drejtorive, se janë këshilltarë të kryetarit, na edhe qytetarët lypim llogari prej kryetarit të Komunës. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Artan! Mu më vjen keq që ta dhashë fjalën edhe doli drejtori, po për arsye të moshës unë kam pak kulturë që mos ta bëj. Dhe unë ju kërkoj ndjesë, po unë sa e pashë që Dritoni lypi prej z.Qamil Kolloni që t'i ketë disa, për atë arsye edhe doli drejtori, nuk doli që nuk e kërkoi asambleisti.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë! Lidhur me pyetjen tuaj, kubëzimi i rrugëve në fshatin Zym, emri i projektit që e ka miratue kjo Asamble në vitin 2022, për me u realizue në vitin 2023, ka qenë ky. Këtu kanë hy edhe trasimi, mbushja edhe në fund kubëzimi. Ky është emri i projektit që e ka miratue Asambleja. Nuk është arrit që të përfundojë ky projekt në tërësi, vetëm u arrit që të bëhet trasimi, mbushja etj., por nuk u arrit që të bëhet edhe kubëzimi. Pagesa është bërë në bazë të emrit, dhe pagesa është bërë në tremujorin e katërt. Shuma e mjeteve tjera të cilat kanë teprue, është përgatit tenderi me u bë kubëzimi, ndërkohë, në bazë të vendimeve gjyqësore, përmbaruesi na i ka marrë diku afër gjysmë million euro, afër 100 mijë euro nga mallrat dhe shërbimet, 250 mijë euro nga pagat dhe shtesat, edhe pjesën tjetër e ka marrë nga investimet kapitale. Edhe mjetet për fshatin Zym që kanë qenë, kanë shkue për pagesën e kontratës kolektive. Ne do të vazhdojmë edhe këtë vit me e pague kontratën kolektive dhe besoj që, s' di a do të mund ta përfundojmë sivjet, por të gjitha vendimet gjyqësore që do të na vijnë, ne do ta bëjmë pagesën. Lidhur me Dritonin, që bëni shumë zhurmë lidhur me investimet që janë bërë në shëndetësi. Ne kemi ndarë mbi 60 mijë euro për renovimin e të gjitha QMF-ve dhe AMF-ve në territorin e regjionit të Opojës. Është bërë renovimi edhe i QMF-së në Bresanë, AMF-ve në Bellobrad, Blaç, Kosavë dhe QMF-së në Llopushnik. Në Bresanë ka pas nevojë për aq mjete dhe është bërë renovimi. Nëse doni një komision prej Asamblesë, mundesh me shkue me e pa që atje është bë një renovim jashtëzakonisht i mirë i asaj qendre dhe nuk ka pas nevojë me shti ma shumë pare sesa aq sa ka pas nevojë. Ka pas nevojë ma shumë me dhënë mjete te AMF-ja e Blaçit, e Kosavës dhe në QMF – Llopushnik dhe Bellobrad. Kështu që ato planifikimet i bën qeveria, ndërsa juve ne ju japim përgjigje dhe llogari. Nuk është e vërtetë që drejtorët këtu nuk kanë të drejtë me dalë me folë. Unë, si kryetar i Komunës, kam të drejtë ta autorizoj kë të dua unë me dalë me folë prej drejtorëve. Mundeni ju edhe drejtpërdrejt – është me rregullore – me i thirrë drejtorët me dalë me folë, po unë nëse nuk e shoh të arsyeshme me dalë, e qes drejtorin e Administratës, drejtorin e Buxhetit dhe Financave. Kjo foltore është e juaja, por Qamili me kërkesën dhe pyetjet tuaja ka dalë me dhënë sqarime. Para se me e qit kryesuesja Rportin në votim, kanë mbet edhe disa gjëra pa i sqarue. E kisha lut drejtorin e Administratës që, nëse kryesuesja ia jep fjalën, le t'i japë sqarimet edhe mundeni atëherë me vazhdue ma tutje. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Edhe një herë faleminderit! Kryetar, ishe i qartë me një pjesë. Me një pjesë të fundit nuk na dhaje sqarime. Në projektet kapitale për vitin 2023, për fshatin Zym janë nda 25 mijë euro, edhe atë nuk po e kontestojmë. Në periudhën e parë, tremujorin e parë kanë qenë investimet në trasimin e rrugës. Ndoshta po të kujtohet, kam replikue pak në kryerjen e punëve, pas intervenimit është krye ajo, nuk ka vërejtje, nuk mund të them i keq. Në tremujorin e tretë, jo të dytin, rreth 7 mijë euro janë investue në urën e Qollopekut. Ndoshta ke dalë e ke pa, nuk ka kurrfarë kushte për shumë ma mirë sesa që ka qenë. Në tremujorin e katërt tash, shkruan se lista e projekteve kapitale të realizuara është në vlerën 9,280 euro. Këtë nuk e kam të qartë. Është e realizuete, projekt i realizuar. Për 8 mijë dhe për 7 mijë që e rrok vlerën 15 mijë e diçka euro, është krejt okej. Por, paratë e mbetura, për 2,280, në një pjesë po thuesh i ka marrë përmbaruesi, tash po thuesh janë investue. Unë nuk po e di ku janë investue. Nëse i ka marrë përmbaruesi, nuk mund të llogariten këto të realizuara, pasi që i mbesim borxh fshatarëve të fshatit Zym edhe 9,200 euro. Por nëse janë realizue, a bën me e ditë vendin ku janë realizue. Nuk janë realizue. Nëse i ka marrë përmbaruesi është krejt okej, por në vitin 2024 ta dimë që i kemi borxh banorëve të fshatit, pavarësisht sa ndahen shuma, edhe 9,280 euro ua kemi borxh. Këtu thotë janë realizue, vetëm këtu nuk përputhem. Faleminderit!

Munir Jonuzi: Bazuar në Vendimin MAPLS ku nuk kam të drejtë të kryesoj, ftoj anëtarin më të vjetër të marrë detyrën.

Mehmet Spahiu: Faleminderit! Fjalën e ka z.Samidin Xheladini, sipas radhës.

Samidin Xheladini: Të nderuar delegatë, ju përshëndes të gjithëve! Dola me e marrë fjalën për një pjesë që nuk e kam thënë, pjesën tjetër te pika e ndryshme do ta marrë fjalën. Kryesuesja nuk është këtu, nuk ma ka dhënë fjalën, tri herë e kam çue dorën. Reagime ka pas edhe prej të tjerëve, vërejtje me ka dhënë veç mu. Prapë edhe personi në fjalë, Urani nuk është prezent. Dhjetë herë ka reague prej vendit, unë një herë kam reague, edhe ai ka bo një diskutim personal ndaj meje. Sjellja nuk ka qenë aspak korrekte, unë nuk e di pse. Edhe Nedžmidini ka reague dhjetë herë prej vendit, e kam pa unë vetë. Por, për fat të keq, unë kam kërkue dhe në vazhdimësi kërkuj, qeveria e kalura këtë e ka hek me qëllim. Por pse qeveria e tashme nuk e bjer, unë nuk e di. Le ta bjer – e kam harrue tash si quhet – ajo është që të gjithë delegatët i pasqyron, edhe kryesuesen edhe krejt: Teleprezencën. Teleprezencën kërkuj me ngulm me e pru këtu. E kemi pague me pare të qytetarëve, kemi vu për qëllimin që çdo lëvizje e çdo personi të shihet në 6 ose në 8 kënde. Kam kërkue disa herë, edhe në mandatin e kaluar e kanë hek me qëllim, se kjo është e fokusuar vetëm me një drejtim. Teleprezenca dua që në mbledhjen e radhës të jetë këtu e vendosur, ose nëse është prish, le të japë llogari ai që e ka prish. Kush e ka prish – nëse është e vërtetë – edhe asnjë arsyetim nuk na kanë dhënë neve se çka ka ndodhë. Dritoni më ka tërhek mu veç për një arsye. Ambulanta në Bresanë 3 mijë euro. Në kohën e qeverisë së Shaban Shabanit është bërë një renovim në Ambulantën e Bresanës, shumë nuk e di, s'më kanë interesue

shumë hollësi. Në Ambulantën e Bresanës renovimi i këndeve higjienike nuk është bërë në mandatin e Shaban Shabanit. Nuk është bërë dhe kanë qenë katastrof. Unë personalisht, me njerëz të vullnetit të mirë kemi bërë disa intervenime, për me e pas funksionale për shkak se mu më vyn pacientëve – se ata s’janë pacientët e mi – po ma së shumti unë e kam punën në laborator edhe kanë pas qasje. Çka ka ndodhë, nuk e kanë krye atë pjesën atje te infuzionet, kanë qenë katastrof edhe atëherë. Më e keqja që ka qenë, drejtori i QKMF-së – nuk e di a është e vërtetë – punëkryesit nuk kanë qenë as të Dragashit e as të Prizrenit, Malishevë ose Rahovec. Kur ka ardhë te unë, ka qenë gjendja kaotike, se ka qenë krejt myk, e zezë. E ke pa edhe vetë, mandatin e kaluar po them. Dhe u ka sugjerue atyre që mos me hy në laborator. Kerkujt nuk i kam thënë deri më sot. Pse s’po e kryeni këtu punën? Na ka thënë drejtori këtu s’keni të drejtë me hy. Çka iu ka thënë nuk e di. Thanë na ka thënë këtu mos me bo. Edhe unë personalisht kam bisedue në katër sy me Shaban Shabanin, ai ka thënë që është e parapame. Domethënë, kqyr çfarë niveli ka, Ambulanta në Bresanë është bërë intervenimi në mandatin e kaluar, edhe u ngrit pluhur pa nevojë. Në momentin që u marrë qeverisja – unë s’jam pjesë e asaj, e meritave të atyre, janë pjesë këta vetë – e kanë parapa dhe i kanë etiketue problemet ku janë, e kanë pa edhe në Bresanë që është gjendja kaotike. Edhe kryetari me stafin na ka mbështet edhe kanë çue inxhinier atje. Është bërë një renovim shumë më i mirë se që është bërë në të kaluarën. Është fyese – ti je vetë prezent atje, e ke pa – është dashtë me e përmend edhe ta kalumen që është bërë një investim, një renovim, edhe nuk është bë kurgjo. E tash është bërë shumë, me shumë pare. Po më vjen mirë, nuk e kam ditë që ëshë shuma 3 mijë euro, faleminderit për njoftimin! Me një shumë 3 mijë euro, investim shumë i madh është bërë. Kërkoj prej zyratëve me e pa sa ka qenë shuma në investime atëherë, masi veç u çel kjo çështje, në mandatin e kaluar sa ka qenë shuma e renovimit të Ambulantës në Bresanë. Bresana ka afër 3 milionë euro, pot i sa e ke xhepin. Unë s’due me u përzie në punë të tyre, se ajo është çështje e tyre, po është problemi që qato pak – se unë s’e kam ditë që 3 mijë euro – qato pak pare është bërë shumë punë. Krejt Ambulanta është bërë si është më mirë. Beso! Bile po më vjen keq që inxhinieri – se nuk është faji i zyrtarëve – inxhinierët janë duke bërë punë gabim. Ai duhet me e pa specifikacionin, me ardhë me na pyet neve. Çka di zyrtari i komunës çka i ka ofrue atij me qat projekt. S’ka ardhë mu për shembull me më konsultue. Të lutem!

Agron Gashi: Ju përshëndes, të pranishëm, përshendetje kryetar, përshendetje për juve kryesuese dhe të gjithë kolegë të tjerë të Asamblesë! Meqenëse pat replikime shumë dhe diskutime të llojeve të ndryshme lidhur me vendimet e marrura nga kjo Asamble Komunale, unë pajtohem me z.Uran Halimi që tha të hapen më shumë dyer, të hapen më shumë porta, të merret e drejta legjitime dhe ligjore për të marrur një vendim. Plotësisht pajtohem me z.Uran, që mos të kthehen disa vendime të marrura mbrapsht, është mirë që të shfletohen dhe hapen dyert, të kërkohet sqarime, sepse vërtet nuk mund të ketë thuajse as seancë për pa u kthyer diçka mbrapsht. Ka nevojë për të marrë sqarime më shumë. Por,

në anën tjetër, pat edhe akuza ndaj drejtorëve paraparak të cilët folën më herët. Ekzekutivi dhe kryetari i Komunës thonë se ka të drejtën dhe unë besoj që ka të drejtën, sepse janë disa raporte vjeçare dhe të periudhave tremujore në të cilët vërtet drejtorët janë në rrjedha dhe duhet patjetër të kyçen për të dhënë disa sqarime. Por, nuk pajtohem me anën tjetër të opozitës, të cilët shpeshherë po e hajjnë veten dhe po e dëmtojnë veten vetëm me akuza, por Vetim Ramadani dhe Qamil Kolloni thanë se është e drejtë legjitime që çdo parregullsi që shihni në anën ligjore, dhe që nuk është kryer e ka keqpërdorim, janë dyert e prokurorive dhe gjyqësive. Mos harroni se në qeverisjet paraprake keni pasur drejtorë të cilët ka pushuar nga vendi i punës dhe me 30 lëndë, njëra pas tjetrës, lëre që la vendin e punës por është dashur të përgjigjet edhe penalisht. E dini fort mirë se kush janë ata drejtorë. Pastaj keni pasur edhe nga ekzekutivi i lartë të cilët i ka përcjellur gjyqësia dhe prokuroria, të shkallës së parë apo të dytë, me shumë lëndë të cilat janë zvarritur nëpër prokurori. Është e kotë neve të flasim këtu, të drejtojmë gishtin, jo që këtu ka përputhje e jo këtu është mirë e këtu keq, por e tëra e drejta legjitime është se të ngritet akuzë dhe të çohet në gjyqësi dhe prokurori aty ku shihet se është parregullsia. Atëherë, me keqardhje, kjo qeverisje trevjeçare që deri më tash po shoh, drejtoritë nuk janë duke u zvarritur nëpër prokurori. Kryetari nuk është duke u zvarritur nëpër prokurori. E tëra ju mbetet nëse shihni diçka të tillë, të padisni. Por, edhe jo e arsyeshme që iu drejtua kryetarit jeni i paaftë në këtë drejtim. Këtu e dëgjova më herët një parafolës, jeni i paaftë në disa vendime të marra. Nuk i përket fjalorit as të neve asambleistëve, të përzgjedhurit e popullit, por nëse ka paaftësi, se është një përzgjedhje që e ka zgjedhur komuniteti komplet, Gorë e Opojë, të parin e vendit si ekzekutivi më i lartë. Ajo fjalë është paksa fyese dhe ka shumë fjalë e terme tjera të përdoren më butë.

Arijeta Skeraj: z.Agron, a ka mundësi te pika e rendit të ditës, sepse po lypin krejt anëtarët me shkue në pauzë?

Agron Gashi: Mbarova, kërkoj ndjesë! E tëra si përfundim i kësaj, jo të drejtohet gishti jeni i paaftë, por e drejta legjitime të punohet me dokumente dhe për atë paaftësi të përgjigjen penalisht. Faleminderit shumë!

Artan Loshaj: Kërkoj shumë falje, kryesuese! E nxiti debatin kolega, kur tha se drejtorët janë shumë të mirë. Ishalla janë shumë të mirë! Na akuzoi që kemi pas drejtorë me aktakuzë, është e vërtetë. E bëre avokatin, shumë mirë, se je në koalicion. Po ke harrue diçka: tetë vite ke qenë me ne në koalicion, qata drejtorët e këqij kanë qenë të juajt, ke qenë nënkryetar i Komunës. Të lutem veç pak, unë nuk të ndërpreva, të lutem, veç më ngo! E di që duhet me e bo avokatin, tash s'ke kurgjo, as nënkryetar, je një asambleist, dy veta t'i kanë marrë në punë, punë e mirë, ishalla edhe dhjetë t'i marrin. Nënkryetarin e Komunës e ke pas dy mandate, në qoftë se kemi bo shkelje, parregullsi, bashkë me ty, bashkë me ty i nderuar. Mos koleg, se të kam për qefi kështu, mos na akuzo partinë në pushtet se vetë ke qenë me ne. Tash ti qaty ku ke hongër s'bën ... të lutem!

Nedžmidin Sejdilar: Kolloni është një driblues shumë i mirë. Ju i keni mbetur borxh zotit Selaj në pyetjen se pse nuk e keni investuar në kubza në Zjurm. Jemi në dijeni që përmbartuesi privat ka kërkuar që të paguhet 500 mijë euro në emër të shyajtjes, por edhe ju keni qenë në dijeni kur keni bërë buxhetin, pse nuk e keni futur në zërin e buxhetit si dhe ku ta paguani. A duhet ekzekutuesi t'i tërheqë paratë aty ku ka pasur më pak investime kapitale. Pse nuk ke tërhequr 15-20.000 euro në Bresane, nuk do të ndihej.

Jetmir Ajdini: Përshëndetje edhe një herë! Në lidhje me këtë Raport të buxhetit për këtë tremujor, do të ndalem në disa pika. Njëra prej pikave është shuma e mjeteve që keni ndarë për fshatin Zgatar për rregullimin e pompave të ujit. Ka qenë një shumë prej 8 mijë euro, të cilën qeverisja komunale nuk ka arrit me shpenzue edhe ato pompa nuk janë rregullue dhe ai projekt nuk është realizue. Është një nevojë shumë e madhe e qytetarëve të fshatit Zgatar sigurimi i ujit të pijes, kur dihet që është një ndër fshatrat që e ka problemin më të madh me ujë të pijes, për shkak se furnizimi bëhet me pompa. Mjetet janë ndarë në fillim të vitit, qeverisja komunale nuk ka gjet kohë me e shpallë tenderin, ka prit deri në fundvit, konkretisht në muajin nëntor, nëse s'jam gabim. Keni shpallë tenderin për rregullimin e pompave, tender të cilin kompania që ka konkurrue e ka tejkalue shumë buxhetore, nuk është realizue, ka dështue ai tender. Është një urgjencë që nevojitet me e rregullue. Edhe një pyetje ju bëra në lidhje me transportin, nuk m'u përgjigjet asnjëri, as drejtorët e as kryetari. Te shuma e mjeteve që e kemi ndarë për rregullimin e rrugës Brrut – Zgatar, është një shumë prej 133 mijë euro, projekt i cili është realizue. Në atë projekt kanë qenë të përfshime edhe rregullimi i rrugëve tjera, e dimë shumë mirë qysh është gjendja e rrugës nëpër fshatin Brrut, gropa të cilat duhet të riparohen e nuk janë riparue, edhe gropa nëpër fshatra tjera të cilat kanë qenë të përfshime në atë projekt, edhe ato nuk janë rregullue. Kisha kërkuar një përgjigje. Te rruga Brrut – Zgatar, i kemi ndarë 133 mijë euro për shtrimin e asaj rruge. Projekt i realizuar, e dimë, me defekte të cilat i ka. E kemi diskutue një herë, ke thënë që kompania zotohet se do ta rregullojë përsëri atë gabim që është bërë ose atë dëm që është bërë momentalisht. Në atë projekt kanë qenë të përfshime edhe rregullimi i gropave në disa fshatra tjera, Brrut, Kosavë, e disa fshatra. Nuk janë realizue, gjendja në rrugën e fshatit Brrut dihet qysh është, plotësisht me gropa, ka nevojë me u intervenue. Gjithashtu edhe në Kosavë. Nuk e di pse s'janë realizue. Ju faleminderit!

Vetim Ramadani: Atëherë, për mos me u vonue shumë, meqenëse u kërkuar pauzë nga anëtarët e Asamblesë, në mënyrë që të mos mbesim borxh pastaj. Sa i përket furnizimit për zyrë në vlerën prej 77,958 dhe furnizime pastrimi 13,489 euro. Këto furnizime janë bërë, ashtu siç e dini, kanë ndryshue politikat edhe të Thesarit, natyrisht me qeverinë e re. Qeveria e re e ka vizionin e saj. Ka ndryshue edhe ripozicionimi apo pozicionimi i mëhershëm si ka qenë i menaxhimit në kuadër të Komunës, sidomos të furnizimeve. Praktiki është kërkuar nga Drejtoria e Financave që të bëjë një klasifikim të depozë,

në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës, pra të ketë një centralizim, meqenëse Komuna e Dragashit qysh katër vite tashmë merr vërejtje të theksime sa i përket menaxhimit të pasurive financiare nën 1 mijë euro. Dhe e kemi pasur obligative që ta krijojmë një depo qendrore dhe kjo pastaj t'i ketë dy nëndepo, të cilat i kemi krijuar në muajin janar, pasi kanë qenë në trajnim zyrtarët përkatës të QKMF-së dhe të DKA-së. Pra, i gjithë ky fokus nuk është bërë për centralizimin e furnizimit, por është bërë për kontrollimin më të mirë të tij dhe në mënyrë që të kemi argumentim në sistemin e-Pasuria. Meqenëse sisetmi e-Pasuria më herët nuk ka qenë funksional. I kemi të gjitha dosjet fizike, gjenden në Komunë qysh para shumë vitesh, mirëpo në sistemin e-Pasuria nuk janë udatuar ato. Domethënë, kur është marrë furnizimi, është bërë përmes komisionit, ndërsa dalja është regjistruar fizikisht, mirëpo në sistem nuk është ngarkuar zyrtari që po i merr. Në këtë rast, për shembull, një drejtor shkolle apo një mjek, apo një zyrtar i administratës komunale. Sa i përket vlerës së furnizimit, furnizimi është jashtëzakonisht i bollshëm. Shkolla e mesme profesionale që gjendet në Shajne – unë ju ftoj të gjithë nga ju, kushdo që ka mundësi dhe kohë, që të vijë me mu dhe ta shikojë se çfarë furnizimi enorm gjendet në atë shkollë, duke filluar nga furnizimi me letër, që është vlerë që mund të them kemi deri në fund të vitit pa pikë telashe. E, për të vazhduar pastaj për furnizime me material shkollor, materiale për zyrë dhe të ngjashme, e sidomos inventor shkollor dhe administrativ. Nuk është e vërtetë që jemi duke i munduar shumë njerëzit që vijnë këtu. Administrata komunale është duke e futur gradualisht në zbatim sistemin e dërgesës së materialit që kërkojnë nëpër institucionet e tjera gjegjëse. Praktikisht, nëse një drejtor shkolle ka nevojë për një sasi të caktuar të materialit higjienik apo administrativ, përmes deposë së Komunës ne do ta dërgojmë dhe jemi tashmë duke e praktikuar këtë punë, një punëtor i Administratës komunale e merr materialin dhe e dërgon në shkollën gjegjëse. Përgjithësisht rastet kur ka drejtorë shkolle që vijnë nga vullneti i vet, vjen në Dragash dhe e kryen furnizimin vetë, në mënyrë që ta kursejë edhe Komunën, edhe e merr aty për aty materialin. Sa i përket çështjes që u ngrit se në disa fshatra, përkatësisht në fshatin Zgatar nëse nuk gaboj, një vlerë prej 8 mijë euro kanë qenë të planifikuara për pompat e ujit, ndërsa nuk janë shpenzuar fare. Meqenëse tenderi ka dështuar – është fakt sepse pasqyrohet i tillë edhe në raport – mirëpo një gjë e tillë ka ndodhë sepse përmbaruesi, gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, i merr të gjitha paratë të cilat aktualisht gjenden në sistem të pazotuar. Në momentin kur ne nuk kemi pas kontratë të nënshkruar, ne s'kemi pas mundësi si ta bëjmë zotimin. Mundim me e gjet dosjen edhe me ju tregue më saktësisht. Sa i përket furnizimit me pompa, këtë fundvit apo vitin e ardhshëm Zgatar si të gjithë fshatrat tjerë do të furnizohet me ujë. Edhe atë, është ndër fshatrat e rrallë që e ka luksin që ta ketë burimin direkt nga bazeni qendror në Radeshë. Jo, nuk është hipotetike, punimet janë duke përfunduar. Nuk është praktikë e mirë, unë kurrë s'të kam ndërprerë, edhe LVV-ja vetë ka votuar kundër Ujësjetës. Po me qat buxhet na po planifikojmë me e realizue. Po sido që të jetë, ne kemi me e realizue, edhe pompat do të realizohen, edhe uji do të vjen,

nuk është problem. Po deshta veç me e sqarue, me qenë korrekt në raport me ju, që këto para kanë dështuar për këtë arsye. Ka mund me qenë edhe vonesë e procedurave, mirëpo na në fund e kemi shpallë tenderin, ka dalë raporti i hapjes, paratë janë marrë edhe atëherë ka dështue procedura. Është vlerë e vogël, besoj që mundim me e përballue pa pikë telashe edhe këtë vit. Sepse mund ta ekzekutojmë edhe prej mallrave dhe shërbimeve, meqenëse janë pajisje, mund t'i blejmë. Ndërsa, sa i përket dëmtimeve që janë bërë të asfaltit në rrugën Brrut-Zgatar, edhe segmenti i dytë ka qenë, dalja e fshatit Zgatar e hyrja e fshatit Blaç, e deri te qendra e fshatit Blaç, krisja që ka ndodhur në atë terren, realisht ka qenë edhe rekomandim i mëhershëm i inxhinierëve që të mos zhvillohen menjëherë procedurat e asfaltimit, pra të lihet pak kohë, meqenëse është bërë një marrëveshje – që shfrytëzoj rastin publikisht t'i falënderoj në emër të kryetarit dhe Komunës së Dragashit, personat të cilët kanë lëshuar pronën e tyre private në mënyrë që ajo korsi e rrugës të zgjerohet, aty ka qenë një mur mbrojtës jashtëzakonisht i lartë, Ka qenë rekomandimi që të pushohet pak mbushja, në mënyrë që të mos ketë telashe. Mirëpo, për hir të presionit, meqenëse ishte koha kur Mërgata viziton familjet e tyre, ne jemi detyruar që të shkojmë pak më herët, mirëpo me një kusht tjetër, që kompania në fjalë ta marrë garancionin që t'i riparojë. Unë besoj që shumë shpejt – këtë vit, meqenëse jemi ende në sezonin e dimrit dhe është mirë ta lëmë edhe pak kohë të pushojë – do të riparohet ai segment, sepse ka detyrime rreth kontratës. Përndryshe, shkon në përgjegjësi të operatorit ekonomik. Faleminderit!

Qamil Kolloni: E kam për detyrë me ta sqarue, po ta sqaroj se në Qarkoren buxhetore numër 1, në qoftë se nuk ke harrue, në këtë Kuvend që e kemi miratue buxhetin, Qarkoren buxhetore që na dërgon Qeveria dhe Thesari, për parashikimin e buxhetit, ne kemi paraparë 300 mijë euro, shumë më tepër në pozicionin Paga dhe Mëditje. Pikërisht si Drejtorat, duke e pas parasysh se kemi të bëjmë me kontratat kolektive në arsim dhe në shëndetësi që nuk po na përfundojnë, i kemi paraparë këto mjete 300 mijë euro shtesë. Merrne ju buxhetin e parë kur e kemi miratue me Qarkoren e parë buxhetore, mirëpo në konsultim me Qarkoren e dytë buxhetore, para se të miratojë Kuvendi, na janë heq 300 mijë euro nga Pagat dhe Mëditjet dhe jemi detyrue t'i bartim në investime kapitale. Si Drejtorat dhe si qeverisje lokale i kemi pas të gjitha këto parasysh, po pse po harroni, ose unë e kam për qëllim në aspektin profesional me të dhënë sqarim, se kanë qenë të parapara dhe kanë qenë të miratuara pikërisht nga ky Kuvend. Të dy qarkoret buxhetore që i dërgon Qeveria e Kosovës dhe Thesari. Në qoftë se nuk është qashtu, atëherë unë jam dribleri numër 1. Në qoftë se është qashtu, unë nuk e di qysh po dësh me të driblue.

Nexhat Selaj: Më falni, edhe një herë me keqardhje që po e vonojmë pak pushimin e drekës. Kërkova nga kryetari, s'po them nuk ke në gjendje po nuk më dha përgjigje. Prita nga drejtori i Financave që të japë diçka, nuk arsyetoi, prita nga drejtori i Administratës. Në investimet kapitale të realizuara në periudhën tetor – dhjetor, kubëzimi i rrugëve në fshatin Zym – 9,280 euro. Kryetar, mundesh edhe me shënue çka po të kërkoj. Prej 25 mijë eurove para të ndara, 8 mijë kanë shkue për trasimin e rrugës, 7

mijë janë harxhues te ura, bëjnë 15 mijë e diçka euro. Ka mbet vlera pak më pak se 10 mijë, 9,280. Në shpenzime të realizuara shkruan se këto para janë realizue. 9,280 euro, kodi 46873. E lypa një përgjigje, nëse ka mundësi vetë, për këtë, asgjë tjetër. Për ato dyjat të kryera, nuk kemi diçka çka me thënë, vetëm për këtë realizim. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Unë ndoshta nuk kam qenë i plotë kur ta dhashë përgjigjen, por unë me sa e di janë ndarë më shumë se 25 mijë euro, se janë ndarë edhe për urën, edhe për trasimin e rrugës. Mirëpo, pagesa e këtij shpenzimi është bërë në periudhën e katërt të tremujorit. Ka mbet pa u krye pjesa e kubëzimit që ka qenë në projekt dhe ka mbet pa përfundue ura. Te ura e di që duhet edhe 7-9 mijë euro shtesë edhe me përfundue ura. Kanë qenë të ndara 20 ose 25 mijë euro për urën, kompania ka hy afër 10 mijë euro ma lirë edhe kanë mbet ato mjete. Është shpallë tenderi për rregullimin e urës, ti e dish, tri herë ra borë dhe punimet nuk u zhvilluan e ato mjetet shkuan në suficit. Kështu që na urën, tash në muajin mars kemi mjete në vlerë prej 230 mijë euro të cilat janë kthye, të hyrat vetanake të cilat nuk janë shpenzue vitin e kaluar, një pjesë e këtyre mjeteve do të ndahen për urën e Qollopekut. Gjithashtu, është tejkaluar grumbullimi i parashikuar dhe këtë vlerë prej 230 mijë euro do ta biem në Asamble dhe ajo do të votojë se ku do të shkojnë ato mjete. Kështu që, unë jam shumë i bindur se fshatit tuaj nuk do t'i mbesim borxh për ato mjete të cilat ose kanë shkue në suficit, ose kanë shkue te përmbaruesi. Dhe nuk i është marrë vetëm fshatit tuaj, thuajse të gjitha fshatrave i është marrë në fund, sepse një pjesë prej 400 mijë euro i ka marrë përmbaruesi edhe një pjesë, normal, kanë shkue në suficit. Po në përgjithësi ne kemi mund ta realizojmë buxhetin mbi 95%. Nuk kemi mujt me e arrit qëndpërqind, po megjithatë ne jemi të kënaqur që kemi mujt me arrit edhe këtë vit ta shpenzojmë buxhetin, edhe buxhetin e investimeve kapitale mbi 85%, kështu që ne edhe këtë vit mund të garojmë në Grantin e Performancës për vitin 2023. Për punët që janë krye, paratë janë lëshue. Emri i projektit ka qenë ashtu. Nëse dyshon diçka, kërkoni zyrtarisht qasje në dokumente zyrtare, merri dokumentet, nëse ka dyshime çojë lëndën në prokurori. Nuk janë 25 mijë euro për fshatin tuaj, ma shumë se 25 mijë, po tash s'po më kujtohet. Unë e di që 25 mijë euro janë ndarë veç për urën, plus janë ndarë mjete tjera për trasimin dhe kubëzimin e një rruge që çon deri te një fermë. Unë të thashë, nuk është bërë asnjë pagesë pa u krye punimet.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! Pasi që nga shumica e anëtarëve të Kuvendit po kërkojnë pauzë për drekë, atëherë e qesim në votim Raportin Vjetor Financiar për vitin 2023. Kush është pro kësaj pikës? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, 10 kundër dhe zero abstenim, miratohet kjo pikë. Të nderuar anëtarë, shefat e grupeve parlamentare për pesë minuta i pres në zyrë. Shkojmë për një orë pauzë, pas një ore kthehemi në Kuvend. Faleminderit!

Atëherë po fillojmë me pikën e shtatë: Raporti i KKSB-së për periudhën korrik-dhjetor. Të nderuar delegatë, për këtë pikë vetëm e keni pranuar materialin. Ky raport është vetëm sa me e informue

Kuvendin për punën e KKS-së. S'besoj që ka nevojë për diskutim, pasi që këtë pikë edhe nuk do ta votojmë. A do dikush me e marrë fjalën, apo veç po e qesim në votim?

Bexhet Xheladini: Të nderuar asamblesitë, ju e keni marrë materialin për Raportin gjashtëmuor të KKS-së. Unë si kryetar i Komunës dhe kryetar i KKS-së, jam i obliguar që të informoj Asamblenë, për arsye se KKS-në e ka themeluar Asambleja. Ky është vetëm një raport informativ, nuk ka nevojë me ligj me u votue. Unë nuk kam nevojë me jua humb kohën, nëse ka dikush me pyet diçka, unë jam këtu, mund të dal të ju jap sqarime. Por vetëm, në fund të raportit, në tabelë i keni të dhënat për një vit, kurse në formën e shkruar i keni raportin e dytë gjashtëmuor. Raportin e parë gjashtëmuor e kemi dhënë më herët në Asamble, vitin e kaluar. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Pasi që nuk kemi, vazhdojmë te pika e tetë: Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2023 dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024. Sa i përket Raportin Vjetor të Kuvendit për vitin 2023, siç e keni edhe në raport, gjatë vitit 2023 kemi mbajtur gjithsej 13 mbledhje, ku prej tyre kanë qenë 10 të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme, si dhe një mbledhje solemne, ku janë trajtuar gjithsej 54 pika të rendit të ditës. Gjatë vitit 2023 janë miratuar 39 vendime. Nëse dikush ka me shtue rreth kësaj, mundeni me e marrë fjalën. Nëse nuk keni, Draft Planin e keni, nëse dikush ka diçka për të shtuar te Plani i Punës i Kuvendit? Atëherë e qesim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Atëherë, para se me kalue te pika eventuale, e kemi edhe pikën për anulimin e Vendimit për ndryshimin e emrit të rrugës "Hajdet" në "Haxhi Rrahmani".

Driton Ademi: Para dy-tri seancave kam kërkuar që vendimet të cilat kthehen prapë nga Ministria është mirë na me i pa këtu, për me i rivotue ose me i anulue këto vendime. Kjo gjë nuk është t'u ndodhë, që tri-katër herë, nuk e di e sata herë është. Ju sot u dashtë në fillim të seancës me e pru, nëse e keni në email, besoj që jau ka pru, u dashtë me e pru në fillim të seancës, që na me pas njëfarë arsjetimi. Kemi mund me e lexue, që dy-tri orë jemi konë në Asamble, kemi mund me lexue dhe me marrë njëfarë vendimi. Unë kisha kërkuar prej teje edhe prej ekzekutivit, vendimet që kthehen prapë nga Ministria është mirë, qoftë edhe ditën e fundit, ose para seancës, është mirë me na dërgue, së paku bare në email. Edhe këtë e kam kërkuar para disa muajve, para disa seancave, po një gjë të tillë po e anashkaloni, nuk e di pse. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Driton! Në fillim, kur diskutuam për rendin e ditës, kryetari e dha një sqarim. Kështu që, a ka dikush me e marrë fjalën për diskutim? Atëherë, e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës, që të anulohet Vendimi për ndryshimin e emrit të rrugës "Hajdet" në "Haxhi Rrahmani"? A ka kundër? Abstenim? Me 15 vota pro, 4 kundër dhe zero abstenim, anulohet ky Vendim. Atëherë, e kemi pikën eventuale.

Nexhat Selaj: Përshëndetje edhe një herë! Po më vjen mirë, kryetar, që nuk po e lëshoni mbledhjen, se zakonisht kur po kalojmë te pika eventuale, s'po them se me qëllim, po ndoshta me punë, me ngarkesë, s'po të kemi këtu me bisedue. Nëse ke durimin do të më dëgjosh. Sot është në disponim për me na dhënë edhe përgjigje. Pata qef ta shoh këtu drejtorin e DKA-së. Po, seriozisht të kuptoj. Këtu sigurisht është drejtori i Administratës, besoj që...po edhe drejtorin e Arsimit nuk e ke këtu, se bëhet fjalë për arsimin e për atë arsye po them.

Arijeta Skeraj: Para se me fillue Nexha fjalën, unë i kisha kërkue publikisht kryetarit që, kur ta kemi seancën, mos të pranojë vizita deri kur të kryhet, sepse keq për anëtarët që po dojnë me ju bë pyetje. Deshta edhe te Dritoni pak, me i thënë që unë 16 vjet jam në Asamble, asnjëherë ndonjë vendim që është kthye prej Ministrisë nuk më ka ardhë mu në email personalisht, por as nuk e kam kërkue.

Nexhat Selaj: Pasi që urova kryetati do të jetë këtu, unë masi veç jam në foltore, kryetari është këtu, ne anëtarët jemi këtu, kryesuesen e kemi, nëse mundet që nesër të vazhdohet kjo pikë, pasi që bëhet fjalë për pikën eventuale dhe këtu ne mund t'i paraqesim pakënaqësitë e të gjithë banorëve e të gjithë fshatrave, sepse në pikat që po janë të renditura po jemi të kufizuar nga pika në pikë. Kështu që, pika eventuale, ose është një propozim me e qit të parën pikën eventuale, tani ku mbërrijmë është diçka tjetër. Kështu nuk di kush, drejtorin e DKA-së nuk e kam këtu, që bëhet fjalë drejtpërdrejt për arsimin.

Samidin Xheladini: Unë s'e di pse unë kur reagoj prej vendit, kur reagoni ju ka 100 herë, unë kurgjo s'ju them. Edhe plus më etiketoni edhe më fyeni pa masë. Ndërsa ju veç sot e keni kallxue veten – disa, jo të gjithë, disa, dy a tre veta – e keni kallxue veten se çka kanë personale. Unë me kërkond s'kam personale. Këtu jemi Kuvend edhe i trajtojmë çështjet e popullsisë, çështjet që na kemi përgjegjësi. Prandaj, due me kërkue publikisht falje, së pari kryesuesja dhe ata të cilët kanë reague. Se më kanë fye edhe e kanë pa opinionin, se opinionin nuk e di të vërtetën. Gjithnjë po etiketohem prej vendit. Këtu është vend që duhet të punojmë në bazë të ligjit dhe rregullores. Atë e kërkova unë, në bazë të ligjit dhe rregullores me u veprue, nuk thashë kurgjo tjetër. Unë e kam një pyetje direkte për drejtorin e Administratës. Drejtor, para një kohe, para disa dite, PDK-ja ka dalë me një komunikatë për media, edhe në rrjete sociale, ku je i etiketar ti personalisht, si drejtor i Administratës, për veturë Mitsubishi të cilën Ambasada Amerikane në vitin 2015 ia ka dhurue Drejtorisë së Shëndetësisë. Në opinion, këtu është një akuzë shumë e rëndë, jo veç për ju, por edhe për të gjithë pushtetin, edhe për qeverisjen në përgjithësi, ka fjalë shumë që mund edhe ta lexoni ju vetë, se teksti është pak i gjatë. Ju e keni pa, me siguri edhe reagim keni bo më duket. Dua të na jepni një sqarim, se me të vërtetë këto reagimet duhet opinionin ta dijë realitetin. Me fakte, mos u ço me e mbrojt askënd. Fole të vërtetën fille e për pe. Nuk ka këtu diçka që duhet me elaborue, vetëm të vërtetën me e folë. Nëse ka mundësi. E dyta, Uran, personalisht po ta përmendi emrin, s'dashta me e thënë. Unë në Asamble kam qenë 3 mandate në qeverisjen e PDK-së. Unë gjithnjë e kam votue buxhetin. Edhe më ka përjashtu – qe po të kallxoj haptas

– parita më ka përjashtue mu me një moment kur e kanë pa që buxheti është shumë i keq. Edhe unë personalisht, veç unë e kam votue buxhetin. Edhe më ka përjashtue kryetari atëherë, Selim Kryeziu, prej partisë. Po më vjen keq që po jau kallxoj këtë. Veç e kam pas për vete - dikur kanë kërkue falje, gabim kemi qenë - edhe e kam votue buxhetin. Pse e kam votue buxhetin? Se, për shembull, aty ka investime veç për popullatën. Ne si Asamble kurrfarë interes s’kemi, buxheti është gjithëpërfshirës. E kam votue edhe mburrem që asnjëherë, i vetmi ndoshta jam prej delegatëve, që buxhetin edhe investimet i kam votue, pa marrë parasysh qysh më ka sugjerue partia ose jo. Ty personalisht, Nexhat, kam me ta dhënë një shpjegim, veç na të dy kur të jemi, për një çështje, një sqarim se ti s’ke qenë atëherë në Asamble. Është mirë me të njoftue, se ndoshta s’e dish të vërtetën. E personalisht kam me ta dhënë ty, për hir të respektit. Edhe kështu, s’jam unë këtu me ju kallxue juve çka me bo. Ne jemi familje dhe unë e ndiej veten si në familje. Reagimin kur e bëj, e bëj sikur në familje teme njëjtë, qeshtu. Raportet mes meje dhe kryetarit këtu janë krejt tjera. Raportet familjare i kemi të shkëlqyeshme, shembull jemi. Por raportet politike këtu jemi shembull për të keq, se në shumë sende edhe unë s’pajtohem me të. Dhe shkojnë njerëzit, me tendenca e akuzojnë atë. Ju betohem që unë me të nuk merrem me punët e qeverisë së tij hiç. Merrem vetëm me punët e partisë time dhe me punët e Kuvendit. Në qeveri, le të folin këta këtu, ndonjëherë ndonjë send që kam shkue diçka me kërkue ose me iu ndërhy. Nuk është në rregull kështu, se opinioni nuk është mirë me u dezinformue, me bo këso propaganda ose personale. Nëse kam pas unë me nënkryetarin ose me atë atje ndonjë fërkim të momentin – ose me kryetarin e komuniteteve, kam pas fërkime, edhe e kanë bo çështje politike, kanë shkue i kanë thënë atje. Ka pas edhe reagime në Ambasadën Amerikane, më kanë ftue, se unë po bëj presion ndaj komunitetit joshumicë. A dish çfarë akuze është kjo? E dini mirë, për atë po e bëni. Prej shqiptarëve jeni duke marrë instruksione. Për çka, pushteti prapë i shqiptarëve ka me qenë se janë ma shumë në vota, se popullata po votojnë qashtu. Se duhet me e votue ma të mirin, po po votojnë shqiptar, goran s’po e voton. E para, e dyta: tash çka kanë këta komuniteti, njerëzit e opozitës po i shtinë këta të komunitetit me e akuzue vëllain tem se unë po bëj sulm ndaj komunitetit. Këtë nuk jau fali. Kurrë për jetë!

Nedžmidin Sejdilar: Masi kryetari nuk është prezent këtu dhe unë me të vërtet kam shumë pyetje esenciale për pushtetin, ju lutem, të vazhdojmë me seancën nesër, kur do të jetë kryetari prezent, sepse pika eventuale është për të mirëne qytetarit. I kam pyetjet esenciale, prandaj këtu ju lutem të vazhdojmë nesër, se sot me vazhdu eventualen pa shumicën e drejtorëve prezent këtu, pa kryetarin prezent, s’ka efikasitet. Prandaj, ju lutem kryesuese, të vazhdojmë nesër kur do të jetë kryetari prezent. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Me të drejtë apo pa të drejtë, po duhet me fillue, kushtet si i kemi ashtu. Atëherë, pasi nuk e kam drejtorin e DKA-së, barra do t’i veshet, që sado pak, sa të mundet sqarime me na dhënë, drejtori i Administratës. Sipas kontratës kolektive të nënshkruar në vitin 2017, shumë mirë e dini se

nga administrata e pushtetit lokal janë ndarë mjetet nga Ministria e Arsimit që komunave të u lëshohet buxheti për shujtën e profesorëve, rruga, licenca edhe pagat përcjellëse për pensionistë. Ardhja juaj në pushtet, keni deklaruar në atë kohë se do të arrini t'i mbulonit të gjitha kërkesat e mësimdhënësve, pikërisht që bëhet fjalë për shujtën. E shujtat e para, deri në vitin 2022, 2023, fundi i vitit 2023 në dhjetor, janë edhe dhjetë mësimdhënës të cilët nuk i kanë marrë shujtat nga pjesa e parë. Duke e ditë ne se tash, 2017-2023, na vazhdon pjesa e dytë. Rruga e cila është e miratuar në kontratën kolektive të vitit 2017, do të thotë transporti prej vitit 2017 deri në vitin 2023 duhet të paguhet për mësimdhënësit të cilët udhëtojnë. Edhe licencat e punës nga 2017-2023, dhe sipas shumë informacioneve edhe inflacioni këtu përfshihet, të cilët kanë marrur nga viti 2017-2023. Përpos ratës së parë, pjesës së parë të pagesave, ne deri më tani nuk shohim lëvizje, të cilët duhet të paguhen kur me ligj i takojnë mësimdhënësit. Kemi mbi 450-460 në mos gabofsha, shumë njerëz nuk jam i sigurt ta di, të mësimdhënësve të Komunës së Dragashit, të cilët i presin këto para, e ju me hesap se as nuk i keni në projekt 2024, në projektin buxhetor 2025. Me një fjalim dëgjova drejtorin e Financave, z. Qamil Kolloni, kur tha se 81 mijë euro kemi qenë të detyruar t'i paguajmë përmbaruesit, të cilët i kanë marrë paratë që janë paguar për mësuesit. Ju drejtor edhe drejtori i Financave, me kohë këto llogarit duhet t' bëni se këto para ta dini se sot ose nesër do t'u barten edhe do t'ua paguani mësuesve. Përpos asaj që ju do t'i paguani, po e paguani edhe këstin e përmbaruesit. A nuk do të ishte më mirë që në planifikimin buxhetor ju t'i ndani paratë me kohë, që mos ta dëmtojme paratë publike, paratë e Komunës që të paguajmë ne edhe përmbaruesin. Një pyetje direkte do ta kem për drejtorin e Administratës. Kur tha pak më parë se kemi bërë hapjen e dy depove për furnizimin me material nëpër shkollave. Drejtor, në bazë të Ligjit 33/2013, ku ceket shumë mirë – nëse e keni materialin para vetes – në faqe 7 thuhet se çdo shkollë e pranon buxhetin dhe mallrat e shërbimet si një shifër, shumë fikse, dhe vendos vetë përmes planit të saj buxhetor se si t'i alokojë paratë në total. E ke me ligj që paratë të cilat ndahen të dedikohen në DKA, e DKA-ja të bëjë shpërndarjen e parave nëpër shkolla, dhe shpenzimet t'i bëjë në bazë të projekteve të veta. Po me të njëjtin Udhëzim, Neni 2.3 thotë se vetëm 5% nga shuma totale e parave të ndara për shkolla mbesin në DKA, të cilat mund t'i harxhojnë varësisht prej mosplanifikimit të mirë të formularëve nëpër shkolla. 95% e parave duhet të derdhen nëpër shkolla, vetëm 5% të dedikohen tek DKA-ja. Ju përkundrazi, 100% keni marrë autonominë e shkollave dhe menaxhimin e bëni vetë. Një pyetje konkrete, drejtor: A mund ta dimë ne se kush i nënshkruan të gjitha këto pagesa të financave që bëhen për shkolla dhe kush i mbikëqyr këto? Kush i nënshkruan dhe kush i mbikëqyr? Më një fjalim të mëhershëm, nuk po mund ta di cila seancë ishte por sigurisht e vitit 2023, ke akuzuar drejtorët e shkollave për keqmenaxhim të parasë publike. Përderisa në atë kohë ka pas edhe Komision vlerësues nga DKA-ja dhe nga Komuna, tash ju paratë i keni krejt vetë. Kush juve ju menaxhon? Kush juve ju kontrollon? Do të ishte shumë më mirë që ato para të ndahen prapë nëpër shkolla dhe ju vetë të caktoni

komisionet, komisionerët e juaj nga DKA-ja dhe nga Komuna për mbikëqyrjen e tyre. Në fund të fundit, juve ju vijnë edhe fletëpagesat, edhe e shihni ku kanë shkue ato para. Për pagat përcjellëse jubilarë, tri pagat, nuk di a janë duke u pague a jo, tash sigurisht më japish informacion. Për shujtën, rrugën, licencën, inflacionin, nëse është një ligj në Republikën e Kosovës dhe në ligj thuhet se nëse një person ka të drejtën e diçkaje X, kanë të drejtë të gjithë banorët e Republikës së Kosovës ta gëzojnë atë të drejtë. Vushtrria si qendër, shujtën, rrugën, licencën, inflacionin, pagat bazë, i ka përfunduar të gjitha. Atë zyrtarisht ta them. Prizreni, rrugën e paguan nonstop. Vetëm Komuna jonë është njëra prej atyre komunave të cilat neglizhojnë me pagat e mësimit. Unë nuk po dua të besoj se ju kundërshtarë të arsimit, pasi që nga kjo shkollë, nga këto shkollat kemi dalë të gjithë ne. E pikërisht ju, drejtor i Administratës, që keni një pozitë pak më të lartë, për mësuesin duhesh vetë të angazhohesh pak më tepër, edhe të bësh çmos që këto paga të cilat i meritojnë mësuesit, t'u kthehen në kohën e duhur. Nuk janë pak mbi 3 mijë euro të cilat duhet të paguhesh tash, sipas informacioneve zyrtare që ka pague Komuna e Vushtrrisë për një mësues. 440-450 mësues, nuk jam i sigurt sa janë, këto vetë ju duhet t'i dedikoni, t'i saktësoni edhe të dini për këto shpenzime se si do t'ia arrini t'i kryeni. Mosmenaxhimi i parasë nga DKA-ja: Në ato formularët e investimeve shohim se nëpër shumë shkolla është investue, askush nuk di se ku po investohen edhe çka po investohet. Nëse ka qasje drejtori në Këshillin Drejtues të shkollës, që çdokund është, me ligj i takon që shfrytëzimin e parasë, paraja të përcillet nga Këshilli Drejtues i shkollës, drejtori dhe organet komunale. Në qasje aty fare nuk kemi hiç. Besoj se gjatë replikave do të më jepet rasti – kryesuese, ishalla nuk kam nevojë për me replikue – por besoj se do të ma japësh fjalën edhe një herë. Faleminderit! Veç edhe pak, nëse më lejohet! Pasi nuk e paskam drejtorin, por këtë pyetje do t'ia mbështesë drejtorit të Administratës. Janë bërë zgjedhjet e drejtorëve, siç e dimë, ne dhe ato janë zyrtarizue. E kam vu re kryetarin, kur e ka me të drejtë diçka edhe mbulohet me ligjin, e sjell ligjin para vetes edhe kërkon nga mediat, thotë ta fokusojmë mirë se si po shkruan. Nëse edhe mu më lejohet kështu, ta fokusoj para mediave përzgjedhjen e drejtorëve, Udhëzimi 151 i vitit 2020 thotë: Deklarata në betim që vërteton se në tri vitet e fundit, kandidati apo kandidatja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëzues në strukturat e partive politike. Nëse kemi kolegun tonë, që nuk e kemi sot këtu, ndoshta u dashtë me ardhë me na përshëndet që po shkon, po e kemi emëruesin tjetër, që e përgëzoi kolegun për punën e re, i cili do të na bashkohet sigurisht të gjithëve të punojmë drejt. Nuk e di në cilin udhëzim administrativ ju e keni lexue që ka të drejtë të ushtrojë detyrën e drejtorit, personi i cili deri në seancën e fundit e kemi pasur ne me mandat të plotë katërvjeçar si asambleist. Bëhet fjalë për drejtorin të posaçëm të shkollës fillore në Bresanë. Nëse më lejohet, në ligjin e shkruar nga Ministria e Arsimit 151/2020, jepen të dhënat e sakta. Ka dallim? Samidin, unë nuk kërkoj sqarim që të më jepni ju. Kjo është për drejtor, Samidin. Ai është emëruar drejtor, unë e shoh që është emëruar drejtor. Kërkoj nga kryesuesja që, nëse ka mundësi, të është pak më vigjilente drejt kolegëve. Unë nuk

i kërkova kolegës që të më japë përgjigje, ai është njëjtë sikur unë. E para, iu drejtova drejtorit të Administratës. Plus asaj, kjo mendoj se është një shkelje ligjore, dhe shkelja e parë në fillim ka qenë me skadimin e anëtarëve të cilët kanë qenë në Komisionin vlerësues të këtij konkursi. Ne konkursin e zgjedhjeve të cilët kanë qenë të emëruar pesë (5), me sa po më kujtohet, Komisioni ka qenë i emëruar për një vit mandat kalendarik shkollor, të cilin e kemi emëruar më 31.09.2022 dhe ka përfunduar më 31.08.2023. Tash, përzgjedhja e drejtorëve, që kolega thotë jo, e drejtori i Administratës thotë po, nuk e di a je në qasje ti në parti a nuk je, del merr informacion te ne nëse dëshirosh me e ditë çka po bëhet te ju, se drejtori thotë se është zgjedhë. Unë nuk e di a është ligjor akoma ai Komision, kur mandat e ka pas njëvjeçar, tash ka filluar viti i dytë. Unë pata qef që ta kem këtu drejtorin e DKA-së, po për fat të keq nuk e kam. Kryetari, që e treta herë është që i sillen punët të tilla, të arsyeshme apo të paarsyeshme nuk po e gjykoj. Po besoj se drejtori i Administratës do të më japë përgjigje. Faleminderit!

Artan Loshaj: Drejtor, ta kemi rrit sot, po e zëvendëson kryetarin, ishalla në zgjedhjet tjera mos po kandidojsh për kryetar se sot e fitove debatin me rivalin tënd për zgjedhjet tjera. Të përgëzoj edhe kie me më bind me të votue edhe me i lut kolegët për kryetar për 2025-tën votat me t'i dhënë. Kismet, po vazhdojmë më tutje. Unë i kam nja dy pika eventuale, kryetarin s'e kemi këtu, drejtorin e Shëndetësisë s'po e shoh, po e lë për në fund mos po vjen, me ia bë pyetjen. Po fillojmë me ty, drejtor i Administratës, se merresh më shumë me këto udhëtimet, e pagesat e këto. Një kërkesë e qytetarëve të Komunës së Dragashit, të cilët punojnë në institucionet publike edhe private, të cilët jetojnë në Prizren dhe udhëtojnë çdo ditë mbi 70km, e kanë bo një petition dhe i është dorëzue kryetarit të Komunës për me e bo një zgjidhje për transportin. Ky premtim i kryetarit ka qenë që 5-6 muaj, ata sot prapë më kanë shkruar, masi keni seancë. Deri ku keni arritur me bisedue për këtë me bo zgjidhje, se janë shumë probleme aty, edhe financiare, edhe probleme po kanë me punën, se kanë vonesa të kombive ose me kerra privatë. Edhe e dyta është rreth participimit në shëndetësi. Drejtor ti, kur kemi qenë na në pushtet nuk ke qenë këtu. Ky Kuvend – kryesuesja e di shumë mirë, se ka qenë këtu, edhe shumë kolegë – është marrë një Vendim, më datën 19.04.2021, Vendim për Lirimin e Pacientëve nga Participimi dhe Taksat Shëndetësore. Nën 1 thotë: Të lirohen nga pagesa e participimeve, të taksave, pacientët e Komunës së Dragashit gjatë kohës së zgjatjes së Pandemisë. Mos më keqkuptoni edhe mos bëni tash në publik me thënë që Artani është kundër largimit të participimit. Unë kam qenë njëri prej atyre delegatëve që e kam iniciue këtë çështje këtu, edhe me mbështjeten e kolegëve e kemi marrë këtë Vendim. Unë jam prapë që të lirohen qytetarët nga pagesa, po unë po kam qef ju ekzekutivi me e respektue Kuvendin. Se këtu në Vendim thotë me u respektue ky Vendim i Kuvendit. Unë po kërkoj që në seancën tjetër, në qoftë se jeni të pëlqimit edhe ju si ekzekutiv, të vazhdohet largimi i participimit, ta bini në rend dite të votojmë. Se përndryshe, që 6-7 muaj ditë zyrtarisht Pandemia është mbyllë edhe ju vazhdoni me të zezën me i lirue pacientët nga participimi. Nashta nuk më kuptuat, edhe një herë: Unë po kam qef që të

respektohet Kuvendi, në seancën tjetër të merret një vendim që të vazhdohet të lirohet participimi, ose të fillohet me e bo participimin. Po jo qysh po doni me e vazhdue ju edhe Drejtorja e Shëndetësisë. E keni gabim edhe po bëni shkelje. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, znj.Kryesuese! Unë e kërkova fjalën edhe më herët, mas propozimit të z.Sejdilar, deshta edhe unë me iu bashkue të njëjtit propozim, meqenëse e kemi mangu edhe një pjesë të anëtarëve të Kuvendit edhe shumicën e drejtorëve të ekzekutivit. U dashtë me e respektue propozimin e Sejdilarit edhe me e qit në votim, mirëpo qetash s'po di a me e marrë fjalën apo thjesht po mendojsh me e vazhdue seancën deri në fund.

Arijeta Skeraj: Vazhdo!

Uran Halimi: Meqenëse po e vazhdojmë, atëherë po e shfrytëzoj atë kohën time që me e mbajt një fjalim. Deshta me ia dhënë një përgjigje z.Selaj, në lidhje me Vendimin për emërimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve. Unë e kam atë Vendimin, jam unë ai që e kam nënshkruar atë Vendim. Me plot përgjegjësi e them që Komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve nuk ka pas mandat për zgjedhjen e këtyre drejtorëve që sapo janë zgjedhë, drejtorëve të shkollave. E kam Vendimin edhe këtu, nëse dëshironi muj me ua lexue. Po, për shkak të qytetarëve. E kemi Vendimin për formimin e Komisionit përzgjedhës, thotë që formohet Komisioni përzgjedhës për intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në pozitat e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitar që janë në varësi të Komunës, për vitin 2022-2023. Anëtaët i dini ju, se na vetë i kemi votue, meqenëse edhe atëherë z.Selaj e pat lexue disa herë, bashkë me mu, Udhëzimin Administrativ i cili jep instruksione se si formohet Komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave. Tjetra çka deshta me thënë, njëfarë shqetësimi i qytetarëve në lidhje me rregullimin e një shtëpie malore, që po i thojshin këtu vendit të quajtur "Cilipup" në Dragash, këtu përmi Dragash diku. Ka qenë njëfarë projekti i cili Komunës është paraparë t'i kushtojë diku 35 mijë euro. Është fjala për vitin 2022. Aty kanë fillue punimet, është bo mihja e dheut, është qit pllaka bazë e betonit të asaj shtëpie malore dhe janë ndërprerë punimet. Afati kohor për përfundimin e atij projekti ka qenë diku fundi i muajit korrik të vitit 2022. Prej atëherë e deri më tash punimet janë të lëna në gjysmë. Është pllaka vetëm përdhes e shtrume. Nuk e di çka ka ndohë më këtë, nëse ka mundësi me na dhënë një përgjigje neve si delegatë edhe qytetarëve, të cilët goxha kanë adresue pyetje. Çka ka ndodhë me këtë projekt, a pritet të rifillojë sërish edhe kur do të përfundojë? Diçka tjetër s'kam, faleminderit shumë!

Shpetim Hajredini: Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Pyetjen të cilën e kam parashtrur seancën e kaluar për kryetarin, ma ka dhënë një përgjigje, por pastaj për replikim timin nuk qëndroi në seancë, për arsye të tijat personale, që e pat një takim. Sot prapë nuk është. Unë do ta parashtroj prapë pyetjen edhe në seancën e ardhshme po bësoj që do ta marr përgjigjen, ose edhe nëse është e mundur Vetimi le të ma jap përgjigjen, por besoj se është më mirë e kryetarit, sepse nuk është edhe aq kompetent drejtori

i Administratës për pyetjen time, për këtë kërkesë të qytetarëve. Ju jeni të gjithë dëshmitarë dhe besoj që e mbani në mend atë pyetjen të cilën e kam parashtrur në eventuale në seancën e kaluar. S'po due tash edhe një herë të rikthehem dhe ta bëj pyetjen, po do e citoj vetëm një pjesë të përgjigjes së kryetarit të cilën ma ka dhënë mu. Ka thënë që ne i kena marrë disa fshatra përsipër të shpenzimeve të ndriçimit publik këtë vit, domethënë në vitin 2023. Presim që edhe vitin 2024 t'i marrim edhe disa tjera, e kështu me radhë. Por, kryetari po harron që unë qe dy vite kërkoj një gjë të tillë, që të merret përsipër shpenzimi i atyre fshatrave të cilët instalimin apo ndriçimin publik e kanë qysh dy vite, tri e ma herët, dhe pagesën e këtyre shpenzimeve e kryejnë vetë nga financat e tyre. Kryetar, për mu kjo nuk është në rregull. T'i marrësh fshatrat të cilët sot kanë instaluar ndriçimin publik, t'ia merr për bazë dhe t'ia kryen edhe shpenzimin, dhe mos t'i merr përsipër fshatrat të cilët e kanë instalimin dhe kërkojnë një gjë të tillë, që t'i merret shpenzimi i ndriçimit publik të mahershëm, kjo për mu paraqet një problem serioz, të cilit edhe munda t'i jap përfundim vetë. Ashtu po ma rrok mu, që po e bëni anashkalimin, o pse unë po jau bëj pyetjen edhe po e bëj kërkesën, o ka diçka tjetër në lidhje me fshatrat. Po nuk e besoj, se ai ka marrë vota edhe na ato fshatra dhe taksapagues janë të gjithë, edhe ata fshatrat të cilët sot ai nuk po e merr përsipër pagesën. I nderuar kryetar, në qoftë se ti deri në qershor, apo kur e kemi votimin e buxhetit, shtator, nuk e propozoni dhe nuk e shoh unë që është bërë propozimi dhe është planifikuar buxheti për ta marrë përsipër shpenzimin e ndriçimit publik të këtyre fshatrave të cilët për momentin e kryejnë personalisht vetë, unë do të dal me propozim edhe mo nuk bëj pyetje. Atëherë, e gjithë barra i bjer kolegëve asambleistë, dojnë ta mbështesin propozimin apo jo. Nuk vazhdoj më me pyetje, se këtu nuk po dojnë dhe nuk po pranojnë, ose ta them të drejtën po e marrin ligësi pse unë jam i butë edhe pse parashtroj pyetje dhe nuk e ofendoj kërkon. Këtu prej tani e tutje ndryshon më strategjia jeme. Unë nuk shkoj mo në mënyrë të edukime, qysh ta lyp personi edhe unë kthehem në atë anë dhe në atë fytyrë. Jam mundue deri tani, qe dy vite, të jam një person i kulturuar, i sjellshëm, të replikoj kur duhet dhe të kërkoj atë që duhet me e kërkuje. Por ajo që ndodhi në pikën e parë të rendit të ditës kur diskutova, dhe mënyra se si u sollën disa, e njëri personalisht që nuk due mo ta përmendi, për mu është si bumerang, sepse fytyra jeme nuk e lejon një gjë të tillë. Edhe nuk e pranoj një gjë të tillë të ndodhë në të ardhmen, se unë askujt deri më tani nuk i kam replikue nga vendi, edhe as nuk i replikoj as në të ardhmen. Kushdo që ka dëshirë me më replikue, e merr fjalën, del e replikon pa kurrfarë problemi, me argumente. Por nuk ka të drejtë askush të ma cenojë të drejtën time të asambleistit. Unë votat i kam marrë prej qytetarëve, nuk i kam marrë prej asambleistëve, as prej ekzekutivit, as prej kërkuj këtu. Unë i përfaqësoj qato 270 vota që i kam, qata i përfaqësoj këtu, edhe të gjithë ata tjerët të cilët nuk kanë votue, unë kam me punue për ta, për të mirën e tyre. Por nuk jam këtu për me i dëgjue një apo dy persona që mundohen me më tregue mu se çka duhet me thënë, çka duhet me folë e si duhet me folë. Askuj nuk i kam tregue, as katër vitet e kalume kur kemi qenë në pozitë. Duhet me marrë me i lëshue videot, katër vite me marrë

shembull nga kryetari i kaluar dhe nga asambleistët që kemi qenë në pozitë në atë kohë. Çfarë sjellje kemi pas ndaj asambleistëve që sot janë në pozitë, në atë kohë kanë qenë opozitë. Ma të privilegjum kanë qenë këta se na para kryetarit. E sot me më pru në këtë gjendje, me më shtresue kaq shumë, vetëm ky e bën. Nuk po di me e përshkrue, po më vjen keq!

Arijeta Skeraj: Për pak kohëpo vjen komandanti i KFOR-it Italian, pesë minuta, veç me e kqyrë Kuvendi qysh po shkon.

Nedžmidin Sejdlar: Prisja që ju ta hidhni në votim propozimin sepse këtu nuk është i pranishëm askush nga ekzekutivi. Kam bërë propozim që pika të trajtohet dhe seanca të shtyhet deri nesër, kur pushteti ekzekutiv do të ketë kohë për organin më të madh të komunes. Kjo që ju po bëni këtu tani tregon një shembull të autoritarizmit, tregon një shembull të diktaturës, të ikjes nga përgjegjësia. Të gjithë ju nga ekzekutivi e keni ditur se kur do të mbahet seanca dhe logjikisht nuk duhet të planifikoni asnjë takim sepse duhet të jeni këtu për t'i dhënë llogari njerëzve. Si mund të pyes tani drejtorin e administratës për problemet e kujdesit shëndetësor? Kjo nuk është aspak serioze. Çfarë të them tani të dashur qytetarë, nëse shkoni në qendrën shëndetësore, mos e ndizni dritën. Sepse po ta ndezë dritën ka rrezik që gjysma e Shajnes të mbetet pa rrymë, kështu më ka ndodhur mua. Nëse ju ka mbetur ndonjë ngrohës kuarci, dhurojini Shtëpisë Shëndetësore në Dragash se nuk kanë ngrohje, apo ujë të ngrohtë sepse atje lart nuk ka. Ikja nga përgjegjësia është një diktaturë totale.

Jetmir Ajdini: Përshëndetje edhe një herë! Kisha një pyetje për ekzekutivin komunal, edhe pse shumica nga ekzekutivi nuk janë këtu, as kryetari, e shumica e drejtorëve veç e kanë lëshue seancën. Nuk e di unë a po e bëjnë këtë me qëllim, me i ik përgjegjësisë që e kanë ndaj qytetarëve edhe ndaj neve si asambleistë, me na u përgjigj në pyetjet të cilat i bëjmë. Kisha një pyetje: në njërën nga seancat e vitit të kaluar kemi marrë vendim, kjo Asamble Komunale, me shumicë votash, që të falet tatimi në pronë deri në vlerën 100 euro për qytetarët e Komunës së Dragashit. Me shumicë votash, kjo Asamble e ka votue qat propozim temin që a kam bo për falje të tatimit në pronë deri në vlerë 100 euro. Kam informacione nga qytetarët se askujt prej qytetarëve të Dragashit nuk i është zbrit vlera e tatimit.

(Vizita e Komandantit të KFOR-it Italian....)

Jetmir Ajdini: Atëherë edhe një herë po e ripërsëris pyetjen që e bëra, për shkak të ndërprerjes që e patëm, për shkak të vizitës së Komandantit të KFOR-it. Pyetja ime ishte për ekzekutivin komunal, në lidhje me një vendim që e kemi marrë nga kjo Asamble. Me shumicë votash është votuar një propozim i jemi që është bërë për faljen e tatimit në pronë deri në vlerë 100 euro. Kam informacione nga qytetarët se askujt nga askujt nga qytetarët nuk i është zbrit nga fatura e tatimit në pronë kjo vlerë. Dikush nga ekzekutivi komunal të dalë të na japë sqarim pse nuk ka ndodhë kjo edhe pse nuk është ekzekutue ky

Vendim i Asamblesë Komunale, i marrë me shumicë votash. Uran, kryesues i Kuvendit ke qenë, besoj e mban në mend që me shumicë votash ka kaluar ai propozim i jemi. Pres një përgjigje nga ekzekutivi komunal. Faleminderit!

Uran Halimi: Të nderum të pranishë, kolegë delegatë! E dini shumë mirë ju që kemi debatuar në lidhje me propozimin e GP të LVV-së, për faljen e tatimit në pronë për të gjithë qytetarët në vlerë 100 euro. Është Vendim që ka gjet mirëkuptim nga ana e delegatëve, mirëpo, siç po e shoh, nuk ka zbatim në praktikë. Është mirë me na dhënë edhe këtë përgjigje, nëse jo sot, kurdoqoftë. Ka qenë një Vendim mbasë i diskutueshëm, për shkak të ligjshmërisë ose joligjshmërisë të këtij vendimi. Mirëpo, ne kemi thënë që po e votojmë, po e mbështesim, edhe me e kqyrë në fund çka po nxjerr Gjykata Kushtetuese, se siç e dini, këtë ligj më herët subjektet tjera politike e kanë dërguar në Gjykatë Kushtetuese. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ku i ka dhënë të drejtë zbatimit të këtij vendimi, nuk ka zbatim në praktikë. Është mirë që ekzekutivi me na treguar në lidhje me këtë Vendim, se ku ka përfunduar. Është një Vendim i nënshkruar dhe i votuar nga shumica e delegatëve. Diçka tjetër që më bëri përshtypje sot: përdorimi i drekonit në restorant aty te 'Meka', anash neve kenë t'u dreguar edhe një pjesë e kryetarit dhe drejtorëve. Më bëri përshtypje ai kamarieri kur erdh edhe i tha drejtorit të Administratës 'këtë pagesën e kësaj dregës a me e qit aty' – s'e di ku – 'apo po e paguni me Cash'. Ky i tha lë se po e pagun ky delegati më i ri. Ama ku po e qet unë s'po e di ai kamarieri. Na i pagujmë, thashë ku i qesin ata kamarierat këto pagesa. Është mirë, drejtor, me na kallxuar ku i qet ato pagesa edhe ai kamarieri, se realisht unë u çudita. Rastësisht ma kapi veshi këtë. Faleminderit shumë, kryesuese!

Agron Gashi: Atëherë, më lejoni të ju përshtes edhe një herë! Unë desha vetëm pak të ndërlidhem lidhur me preokupimet e qytetarëve të fshatit nga vij unë, nga fshati Brezne. Drejtoritë përkatëse dhe ju drejtorë që jeni aktualë, kam dëshirën që ta adresoni këtë problem të qytetarëve, ngase ndriçimi që ka ndodhur në fshatin Brezne është një ndriçim që për të paktën ka për një vit e gjysmë. Ky ndriçim ka shkaktuar problematika të mëdha, sepse ato llampa që janë lartë të montuara nëpër shtyllat elektrike, mbi gjysma e tyre, mbi 50% kanë dalë jashtë funksionit. Çfarë po ndodh, një vit e gjysmë nuk ka ndriçim, që janë montuar ato, por e tëra është që ato nuk janë funksionale. Kryesia e fshatit ka qenë deri në Komunë, preokupimet gjithmonë i kemi adresuar, por megjithatë, nëse nuk merren masa adekuate edhe një kohë të shkurtër, Kryesia e fshatit nuk do të bëjë përpunje, çfarë të ndodhë më tej, por do të përgatit lëndën siç përgatitet, ta hedhim në gjyqësi, në prokurori. Ajo kompani që ka punuar me llampa fallce le të përgjigjet për to, se përndryshe lutjet e kota, me ardhë der këtu nuk nuk është e arsyeshme. Kryesia do ta adresojë deri në gjykatë. Tjetër çka desha të them, lidhur me z.Selaj, më herët u adresua lidhur me preokupimet e disa mësimdhënësve dhe disa pagave jubilarë. Atëherë, duhet të përcillen udhëzimet administrative përmes faqeve që ekzistojnë. Ardhja e Qeverisë Kurti, e dini se kontrata kolektive e vitit 2017-2021 është një kontratë të cilën e nxjerr jashtë funksionit qeverisja e Kurtit, dhe

aty pushojnë edhe shumë të drejta që kishim ne personeli arsimor. Aty ato paga jubilarë kanë dalë jashtë funksionit, pastaj edhe ca udhëtime. Është ligjore, nëse kemi të bëjmë me shkelje që nuk paguhen udhëtimet e tyre, nuk ka lëmoshë me dalë me kërkue, hidhet nëpër gjyq, kërkohen mjetet edhe ato dikur ekzekutohen dhe merren. Pastaj, i adresove edhe disa paga që nuk i kanë marrur nga shujta, ato janë probleme teknike nga avokatët të cilët kanë i kanë marrur dhe i kanë zënë. Kështu që, ne duhet të dimë pra se çka janë normativat mbi arsimin dhe nuk ka shumë arsye t'i adresohemi drejtorive. E tëra që duhet të cekim, të merrni masa drejtoritë përkatëse ku i adresova problemet më herët, sepse qytetarët kërkojnë përgjegjësi lidhur me ato ndriçimet që i përmenda në fshat. Faleminderit shumë!

Nexhat Selaj: Besova se në fjalimin e parshëm e përfundova, po ja që ky avokati nga LDK-ja po më nxjerr për gjuhe me dalë me folë. Avokat, unë nuk të parashtrova ty pyetjet. Të lutem, mundesh me folë vetëm për pyetjet të cilët ju i dedikoni ekzekutivit. Unë pyetjen ia parashtrova ekzekutivit edhe më vjen turp që të mbash nofkën e mësuesit edhe kështu ta akuzosh mësuesin. Është ligj i cili vjen nga viti 2017. A e ka nënshkrue LDK a PDK, mësuesit nuk i intereson. Mësuesit nuk ka parti, mësuesi ka dinjitet, mësuesi ka sinqeritet, mësuesi ka edukatë. Të lutem, mos fol në emër të mësuesit në mënyra të tilla. Më vjen keq që të them! I ke organet gjegjëse, eja këtu, e ke tavolinën para ekzekutivit, mos m'u drejto mu! Unë pyetjen e kam bërë në mënyrë njerëzore edhe çka i përket ligjit. Nuk ke kompetenca ti të më drejtohesh mu e të më japësh sqarime.

Samidin Xheladini: Unë me sa e kuptova, edhe qashtu është, se reagimin e kam bo unë, edhe delegatti – s'po ia përmendi emrin, se menjëherë, me zor pret behane, me u çue me bo polemika – ka qenë fjala për rendin e ditës dhe ka qenë fjala për kthimin e vendimeve. Ju keni qenë në pushtet, e ke pas njeriun më të afërt në pushtet, e ke pas drejtor. Ke pas mundësi me bo qasje në dokumente zyrtare. Merre shihe sa vendime unë kam reague, kur ke thënë pse po ndodh kështu me këtë qeveri, unë kam thënë edhe herave të kaluara ka nodhë me dhjetëra e qindra herë. S'e di çka ka pengesë me e folë të vërtetën. Kurgjo personale, respekt, se personalisht konge prek. Po më vjen keq, preku sa të duash, mundeni me u prek sa të doni, realiteti është ky. Qeverisja e kalume ka pas me dhjetëra e me qindra kthime të vendimeve, po kush është ma fajtori? Kuvendi, se na i kemi votue. Mos ta bëjmë na tash me akuzue. Drejtori kërkesën e bjer këtu, qytetari e bjer këtu, na e votojmë ose s'e votojmë. Ka pas në qeverisjen e kalume vendim që na e kemi pas në fillim të mandatit, e kemi marrë kompirin e nxehtë, që kërkesat e hidrocentraleve, edhe LDK, edhe PDK, edhe pozita, edhe opozita i kanë votue me unanimitet. Kur ka dalë prej komunitetit joshumicë kërkesa me u ndërpre hidrocentralet, ne se opozitë të parit i jemi bashkëngjijt kërkesës së komunitetit joshumicë. Dhe e kemi votue, unë kam qenë edhe më i zëshmi ndoshta, dhe e kemi ndërpre hidrocentralet. Pastaj, kërkesat të cilat janë bë ligjore edhe s'i ka pru vendimet ish-ekzekutivi i kaluet, dhe ka bërë shkelje shumë të rënda, tash kjo qeveri duhet me i pague. Le t'i paguje edhe ka me i pague, me kënaqësi ka me i pague, jo me zor, me kënaqësinë më të madhe.

Edhe, e shoh te kjo qeveri një...është t'u shkëlqye në pagesa ndaj punëtorëve dhe ndaj qytetarëve, ndaj arsimit edhe shëndetësisë. Qeveritë e kalume – i ka fitue gjyqi, e ka pru vendimin, veç i kanë bart paret. Kjo qeveri asnjë ankesë s'e ka dhe e ka marrë përsipër, gjysmë milioni euro që unë u informova këtu, se personalisht kurgjo s'kam të bëj, as personalisht nuk shkoj me marrë informata. Gjysmë milioni euro pagesat e shujtave et., E treta, prapë të njëjtën çështje. Personat në fjalë, veç ia kam vu mendjen, reagojnë prej vendit sa herë të dojnë. Unë me reague bëhet problem. Pse? Pse jam vëllai i kryetarit, a? Unë këtu s'jam vëlla me kryetarin. Binduni, qe pasha Zotin po ju bëj be! Këtu jam opozita më e madhe e tij. Po jo para jush, pa të drejtë. Unë e di çka i them, bën vaki sa herë takohna, këtu takohna edhe bëjmë debate veç për Komunë. A për në shpi, shembull jemi për marrëdhënie, edhe atë falë meritave të mia. Edhe unë kërkova një kërkimfalje nga kryesuesja, pse m'u përmend emri, se veç mu m'u përmend emri edhe mu më akuzoi. Të tjerët i la dhe dolën i shkelën rregulloret, i shkelën krejta, edhe nuk u përmend. Edhe as nuk e shtini në konsideratë atë kërkesën time. Unë prapë po them, kërkoi falje publikisht, që më keni fye edhe tjerët, se ju keni bo poterë më shumë këtu se unë. Një herë kam reague ose dy, ju ka 30-40 herë. Për atë e kam kërkue teleprezencën në mbledhjen e ardhshme, me ngulm kam me kërkue, se unë bëj padi në krejt instancat edhe bëj problem. Ajo teleprezencë na është ofrue neve si Asamble, të gjithë prezentë aty shihen. Ata që kanë qenë në mandat, çka u bo më të? Unë s'kam dashtë me e hek, çka u bo? Pse u prish, duhet me u ndreq. Na kemi pa edhe raste kur edhe këtu në Asamble janë hek edhe mjetet e informimit. Unë jam konë dëshmitar, mjetet e informimit janë hek me qëllim edhe kanë marrë vendime katastrofale. Ose vendime të cilat kryetari i Komunës si mbret që e ka qujt vetin, ka nënshkrue vendime, e ka bë atë e ka bë këtë edhe na s'kemi bo zo. Për çka? Na prapë domethënë kemi qenë konstruktiv. Mos u mundoni me shit, se e dimë, po me dashtë me jau qit në mejdan, jo për kryetarin, as për pushtetin, as për LDK-në, po për realitetin. Se unë jam dëshmitar. Dëshmitare është edhe kjo, po kjo nuk flet, as nuk ka folë në të kalumen hiç. Tash kjo është kompetente me folë edhe me jau kallxue juve realitetin. Unë s'jam, se unë jam delegat. Po nuk jau thotë.

Agron Gashi: z.Selaj, avokat nuk jam. z.Selaj, unë do të luaj rolin e avokatit. Qeverisjet paraprake – je në rrjedha pikërisht ti si personel arsimor – dhe nga 2017-ta ka qenë ligji në fuqi që shujtat e mësimdhënësve duhet të paguhen. Mirëpo, qeverisja paraprake i ka zvarritur prej viti në vit, asnjëherë nuk shkoi në implementim dhe ekzekutim të këtyre mjeteve. Por, të gjitha këto i barti dhe ia la peshë mbi supe partisë pasardhëse, z.Xheladini. Nëse shkojsh, 450 mësimdhënës personel arsimor, të ngarkuar me shuma të konsiderueshme gati që çdonjëri cash para ka marrur gati mbi 600-700 euro. Këto kapin një vlerë afër 400 mijë euro, një gjysmë milioni. Të gjithë këto janë bartut te kjo qeverisje. Por, u dashtë edhe më herët të hapen sytë edhe të adresohen problemet e tilla dhe të jepen vërejtje të tilla. Ky kryetar aktual që ka ardhë, ka thënë kështu: çdo gjë që do të shkojë në përmbarues do të shkojë në ekzekutim. Nuk do të shkojë në ankesa dhe zvarritje, po do të shkojë në ekzekutim. Është zotue para

elektoratit qytetar, e sidomos te mësimdhënësit, kishte ankesa të shumta lidhur me këto shuma, po shkuan në përmbarues, çdonjëra do të shkojë në ekzekutim. Disa anë që janë arsimore dhe ligjore, nuk ka arsye shumë t'i adresosh, jo më tha kolega, më tha ai. Gjithë këta koleg duhet të lexojnë udhëzimet administrative që rrjedhin nga Ministria. Mandej, me kontratat kolektive, kur ka fillue dhe kur ka mbarue një kontratë tjetër dhe çka posedon në të. Edhe këto kontrata kolektive duhet të lexohen nga personeli arsimor dhe të kërkohet. Nëse një gjë që i takon Agronit, të arsimit, unë vetë jam i denjë t'i kërkoj ato. Qoftë në mënyrë ligjore, qoftë në mënyra tjera, gjej mekanizma se si të kërkoj të drejtën legjitime. Por jo edhe për shkaqe teknike, që kanë gjet avokat dhe kanë bërë gabime të shumta, e tash hajde kryetar çka të bëjmë me këtë. Kryetari ka shkue në implementim dhe në ekzekutim çdo gjë që ka trokitur në duart e tij. Kështu ishte puna. Faleminderit shumë!

Nexhat Selaj: Edhe një herë faleminderit! Unë i natyrës, si mësues, jam tip i qetë, po s'paska ma keq se me e gjet një gjuhë jo të përbashkët me kolegën. Të dëgjova zotëri, isha shumë i matur, të isha lut juve dhe të tjerëve, nëse keni durim. Mu po më vjen keq me t'u drejtue, me të thënë a ke lexue naj ligj a jo? Se vetëm je ka flet kështu. Në bazë të ligjit unë flas, i nderuar, nuk po flas me hamendje. Ligji në fuqi është nga viti 2017 deri në fund të vitit 2022. Unë nuk e di kah i nxjerrish ti këto të dhënë, që thuesh i ka pague – s'i ka pague. Nëse ne kthehemi mbrapa, çfarë kanë bërë qeveritë tjera, ne nuk do ta arrijmë të ardhmen e zbardhur. Ne duhet bashkarisht që të punojmë për të ardhmen. Se a ka qenë mirë e kaluara apo jo, ka folë vota. Ne votën e kemi për një qeverisje te re, edhe është zotue kryetari se do t'i paguajë të gjitha. Deri më tani, unë parashtrova pyetjen kryetarit që nuk ishte këtu. Shujta, transporti, licencat, inflacioni, janë barrë e kësaj qeverisjes komunale e cila duhet t'i paguajë mësimdhënësit nga viti 2017 deri në fund të vitit 2022, me ligj. Në vitin 2023 është shfuqizue ligji, koleg, lexoje. Nuk e kam shtyp unë, kjo ka ardhë nga Ministria. Lexoje, shiqoje çka të thotë. Nuk po flas me fjalë të rrugëve, kam dëgjue – s'kam dëgjue. Atë e kam të mirë, se nuk mundesh me më thënë jo. Ta lexoj, të them pikë, urdhëro jepma ti mu dëshminë se nuk është ashtu. Unë nuk di si shkohet kundër mësimdhënësit. Nëse thuesh absolut, është turp me dalë këtu me akuzue, me thënë e ka shfuqizue, kur deri në vitin 2022 është në fuqi. Të lutem!

Agron Gashi: z.Selaj, me shumë kënaqësi të dëgjova, se i përmend vitet dhe kur flet me datë është kënaqësi. Kur flet me të dhëna nga qendra është kënaqësi. Por 2017 e përmend, e 2021. Çfarë qeverisje ishte, kush udhëhiqte këtë Komunë? Dhe, të kesh parasysh se keni ngarkuar dhe stërngarkuar mosimplementimin dhe ekzekutimin. Shumë gjëra që u takonin ligjore personelit arsimor dhe shumë faktorëve të tjerë, shërbyesve civilë, i keni grumbulluar e i keni stërgrumbulluar dhe tani adresoni faj te dikush tjetër. Po këto para që i kërkon tash, këto kontrata që edhe i kemi tash në arsim që përmenden lidhur me kualifikimin. Aty kapin shuma të konsiderueshme, o i nderuar. Janë në pyetje krejta këto, po të hysh në zbatim milion euro kapin. Kjo Komunë ku mund t'i gjejë këto para? Dhe, nga kjo duhet të

mendosh se i keni bënë shumë dëme kësaj Komune, me shuma të konsiderueshme të cilat i keni lënë barrë mbi supe. Sa herë të flasësh me këto shifra, mendo për shifrat e kalueshme të cilat i keni zvarrit edhe i keni prurë këtu në katastrofë Komunën, në buxhet financiar. Faleminderit!

Vetim Ramadani: Faleminderit, kryesuese! Atëherë, meqenëse është seancë e stërzgatur, do të mundohem që të jem pak më i shkurtër dhe më i drejtpërdrejtë. Sidoqoftë, për gjithçka – meqenëse kryetari edhe është kthye, mundet me e kompletue atë çka unë munda me e lënë mangu. Po filloj me radhë, meqenëse kam mbajtur shënime gjatë parafolësve, po filloj me profin Nexhë. Sa i përket kontratës kolektive, ju e dini më mirë se unë, meqenëse vini prej kësaj sfere, pra mësimdhënësve, kontrata kolektive ka qenë nga viti 2017-2022, koha kur Kryeministri Kurti pat vendosur që ta ndërpresë kontratën kolektive dhe si rrjedhojë edhe obligimet e saj që dalin nga ajo kontratë. Shujtat, pagat, licencat, pagat përcjellëse po flasim, të gjitha këto – natyrisht, arsimit në Komunën tonë është një armatë e tërë. DKA-ja është drejtorja më e ngarkuar sa i përket stafit të mësimdhënësve, të inkuadruar në marrëdhënie pune. Dhe natyrisht që kjo kontratë ka edhe detyrime më të mëdha. Unë ju dëgjova me vëmendje që e bëtë një krahasim me Komunën e Vushtrrisë, që tashmë është një hap edhe më përpara. Po ashtu, Komuna e Prizrenit paska bërë përparim që tashmë i ka krye çështjen e shujtave dhe të licencave, ka kaluar në transport. Mirëpo, duhet mos harruar një gjë, që Komuna e Dragashit është komuna ndër më të voglat në nivel vendi, e kur them ndër më të voglat e kam fjalën për çështjet financiare. Pra, buxheti i Komunës sonë është një buxhet modest, edhe atë buxhet ku ta çojmë më së pari. Ne, gjatë marrjes së mandatit, përkatësisht në janar të vitit 2022, jemi përballuar apo jemi vërsuar me kërkesa të mëdha dhe vendime të mëdha gjyqësore të përmbauesit privat. Këto vendime nuk janë të një viti ose të një periudhe. Është një punë e kahmotshme që e kanë bërë mësimdhënësit në raport me zbatimin e kësaj kontrate. Që nga ajo kohë kryetari i Komunës, së bashku me drejtorin e Financave dhe me akterë tjerë të Administratës komunale, kanë qenë në vizitë edhe në Ministrinë e Financave dhe në Thesar. Kërkesa ka qenë mjaft e qartë: Ju lutem, na mundësoni një kod të veçantë buxhetor, ku ne do t'i planifikojmë shpenzimet e kësaj kontrate dhe aty t'i alokojmë mjetet tona. Sepse edhe neve po na paraqet probleme si Komunë. Ta zëmë një shembull, i alokosh mjetet për një investim kapital dikund, vjen përmbauesi e t'i merr paratë e atij investimi kapital. Dhe pastaj çka po ndodh, edhe ne si qeverisje lokale po humbim, sepse një premtim po mbetet pa realizuar. Po shtyhet për vitin tjetër, po shkakton telashe tjera. Dhe, si pasojë e kësaj, ne kemi prit përgjigje nga MF. MF-ja ka refuzuar me na ofruar një gjë të tillë. Atëherë, të gjendur përballë kësaj situatë, ne kemi shikuar që të bëjmë zgjidhje alternative. Këto zgjidhje kanë qenë që të presim. Kemi shkue kemi bisedue edhe me përmbauesit. Sepse, pikërisht dhimta jonë më e madhe ka qenë pse ne të paguajmë taksa shtesë përmbauesit, kur kemi mundësi t'i paguajmë direkt. Komuna jonë përfiton më shumë, se nuk e kemi luksin të humbim edhe tarifën e përmbauesit t'i paguajmë. Kur nuk na kanë ofruar një gjë të tillë, atëherë kemi qenë të detyruar që me

vazhdue. Por, atë që e ka bërë Komuna – dhe këtë e them me plot përgjegjësi, meqenëse jam edhe zyrtar autorizues nga kryetari i Komunës për çështje financiare të pagave dhe mëditjeve – çdo kërkesë, çdo vendim që ka ardhë nga përmbaruesi, që ka qenë i formës së prerë, ka kaluar, mund të them me përgjegjësi të plotë, jo më shumë se dy javë që e kemi kaluar në zbatim, e kemi zhvilluar, e kemi realizuar transaksionin bankar ndaj personave që ka ardhë. Për këtë – meqenëse sot nuk kemi qenë të përgatitur për këtë punë – unë mund t’jua sjell, ose ju personalisht mund të vini, t’jua tregoj edhe listën e arsimtarëve që kanë përfituar gjatë kësaj periudhe nga kjo kontratë kolektive. Ne ua kemi paguar të gjithëve në centa, edhe pse jemi ballafaqur me probleme shumë të mëdha sa i përket menaxhimit të mëtutjeshëm të buxhetit. Pra, deri tash, ashtu siç patë edhe në raportin e vitit 2023, Komuna e Dragashit ka bërë realizimin e të gjitha vendimeve të prera të përmbaruesve që kanë ardhë në Komunën tonë. Sa i përket asaj se a kemi vullnet na që ta kryejmë edhe transportin, natyrisht që po. Nuk due ta kaloj në personale, po unë në familjen time kam mësimdhënës, edhe bashkëshortja ime është mësimdhënëse, edhe ajo e ka fatin e të gjithë mësimdhënësve dhe mësimdhënëseve të Komunës sonë që një pjesë të kontratës kolektive nuk e ka të realizuar. Por, gjithmonë jemi me shpresë, në prtej që MF-ja mos po na lejon – kurrë nuk është vonë – një kod ku ne t’i planifikojmë dhe t’i likuidojmë të gjitha. Tani, sa i përket depove për material për shkollë. UA 33/2013 që ka të bëjë me menaxhimin e aseteve financiare të shkollave, ju ndër të tjera theksuat edhe që ne po o marrim paratë e shkollave. Realisht do të ishte e kundërta dhe është e kundërta. Shkollat i marrin paratë nga ne, sepse organizata buxhetore është Komuna e Dragashit. Ne jemi institucioni qendror. E gjithë Komuna dhe institucionet tjera ndarëse, duke filluar nga QKMF, Gjinnaz, të gjitha institucionet e arsimit, të gjitha institucionet e shëndetësisë, Administrata komunale, të gjitha veprojnë në kuadër të organizatës buxhetore Komuna e Dragashit. Buxheti më pas ndahet dhe planifikohet. Secila shkollë e ka buxhetin e saj, e keni të dokumentuar e të pasqyruar edhe në Raportin e vitit 2023. Tash, shtrohet pyetja se si po u bëka furnizimi. Hipotetikisht e marrim Gjinnazin, meqenëse ju jeni mësimdhënës atje. Gjinnazi ka nevojë që të bëjë furnizim me letër, kush do ta bëjë kërkesën dhe kush është menaxher, sepse furnizimi me letër është kontratë kornizë, qeveria e ka në dorë. Dhe, qeveria e ka caktuar, ata e dinë projektin e vet të qeverisjes, e kanë caktuar që menaxheri i kontratës së furnizimit me letër duhet të jetë drejtori i Administratës. Në qoftë se unë nuk paskam të bëjë me furnizimin e shkollave, për çfarë arsye Qeveria mu më ka vendos aty? Unë, prof, jam menaxher i kontratës, të gjitha kontratat që vijnë si kontrata kornizë nga AQPP. Është e pamundur që të zhvillohet një porosi, nga cilido institucion, qoftë shëndetësor qoftë arsimor, qoftë komunal, pa nënshkrimin e menaxherit të kontratës. Sepse, unë në fund jam ai që jap llogari. Nuk është luks ta qes nënshkrimin në një kërkesë për porosi ose furnizim me material për një shkollë. Në fund unë duhet të jap llogari. Sa i përket menaxhimit, unë nuk e di që një shkollë ka probleme të furnizimit në këtë kohë. Ma herët ka ndodhë, kemi qenë prezentë, kemi bo edhe

kombinime të ndryshme. Kemi shkue kemi marrë prej një shkollës në shkollën tjetër. Ka qenë situata kur është shpenzuar një material më tepër, nuk ka pas në stok, mirëpo të gjitha ato i kemi kalue. Për një fazë dy-tremujore të gjitha i kemi përballue. Dhe, duke marrë mësim nga ajo, vitin që lamë pas kemi bërë furnizimin edhe i gjithë furnizimi gjendet në Shkollën profesionale. Për këtë, më herët – nuk e di a ishit ju prezent – ju thashë që jam i gatshëm bashkë me ju të shkojmë t’i shikojmë. Ka shumë material, sepse kemi mësuar nga e kaluara që mund të rrezikojmë. Ta zëmë, vjen puna e organizimit të festave të maturës, testeve të semimaturës, harxhohen materiale, ka manifestime, edhe po mbesim keq. Është turp që ne të kemi para në stok, ndërsa nuk ka shkolla mjete didaktike – mësimore. Dhe të gjitha ato janë rregulluar. Unë e di që edhe Gjimnazi është jashtëzakonisht mirë i furnizuar me letër dhe materiale për zyrë. Për tash po flasim, ka mund me ndodhë në të kaluarën. Tani tjetra, sa u përket pagave jubilarë. Pagat jubilarë – siç e theksova edhe më herët, meqenëse e kam besimin nga kryetari i Komunës që të jem zyrtar autorizues për kategorinë e pagave dhe mëditjeve – e di mjaft mirë dhe e them me përgjegjësi të plotë, pagat jubilarë i kemi paguar në tremujorin e parë të vitit kur kemi ardhur në qeverisje, përkatësisht janar-shkurt-mars të vitit 2022. Që nga ajo kohë, pagat jubilarë nuk kemi arritur t’i paguajmë, sepse Qeveria na ka refuzue, më saktësisht Thesari. Për këtë kemi dëshmi. Ne i kemi dërguar në Ministri kërkesat, formularët që janë për pagën jubilarë, me ndryshimet mujore. Ata formularë janë kthyer prapë, nuk janë ekzekutuar, me arsyetimin se kontrata kolektive është larguar dhe qëndrimi i Qeverisë është që për momentin të mos zhvillohen këto pagesa. Sa i përket përzgjedhjes së drejtorëve, përkatësisht Udhëzimi 151/2020, e morët një shembull se njëri nga të përzgjedhurit – tashmë është realitet, është proces i përfunduar, personi ka dhënë dorëheqje nga mandati i asambleistit, është drejtor në një institucion shkollor. Personi që nuk dua t’ia përmend emrin, meqenëse nuk është këtu, shumë i nderuar, një profesor jashtëzakonisht i mirë dhe një menaxher që është duke u treguar i jashtëzakonshëm, jo nga ana ime por nga banorët. Pjesë e atij Udhëzimi gjatë përzgjedhjes së drejtorëve është deklarata nën betim. Prof, deklarata nën betim, ju e dini fare mirë, që deklarata nën betim të gjithë përgjegjësinë morale, juridike, të gjitha i bartish personalisht. Drejtori në fjalë që është përzgjedhë e ka të nënshkruar deklaratën nën betim. Ajo deklaratë është në DKA, e ka analizuar Komisioni. Aty ndërlihet edhe afati i Komisionit. Në qoftë se afati i atij Komisioni, po e supozojmë qenkeni me të drejtë ju, për çfarë arsye Ministria na e dërgoi të deleguarin e vet? Pjesë e Komisionit është edhe një anëtar nga Ministria. Nëse ai Komision nuk është valid, për çfarë arsye Ministria pranoi që të na sjellë anëtarin e vet? A është kjo që Ministria e Arsimit ka ra ndesh me vetveten? Këtë nuk e di. Kushdo që ka dyshim për këtë punë, janë rrugët ligjore, besoj që është afati i ankesave, ka Inspektoriat e të gjitha, mundet lehtë me u zbardhë kjo çështje. Jo, se për me e thirrë anëtarin e Komisionit të Ministrisë me marrë pjesë në Komision, duhet fillimisht që t’i dërgohet qaj emaili i Vendimit të Komisionit, se nuk ka të drejtë ndryshe. Atë Komision e ka pa Ministria e Arsimit, çka të them unë. Tash, në afate të

ankesave ose të Inspektoriatit ai mundet me u hetue edhe lehtë ata e rrëzojnë. Shumë në rregull, unë po e kuptoj supozimin e juaj, po Ministria e Arsimit e ka këtë të drejtë me e bo këtë gjë. Le të vjen një kontroll, nëse e vëren që ka probleme, pa problem le ta anulojë procedurën. Sa i përket komenteve të asambleistit Artan Loshaj, udhëtimi apo transporti i punëtorëve, peticioni i transportit në rrugën Prizren – Dragash. Ai peticion është realizue, kryetari i Komunës e ka autorizue nënkryetarin e Komunës për me e dërgue pranë Ministrisë së Transportit, gjegjësisht Departamentit të Linjave. Përgjigjja ende nuk ka ardhur definitive, mirëpo kryetari i Komunës është njoftue me ecurinë e këtij procesi. Ne si Komunë, atë çka kemi mund me e bo e kemi bo. I kemi mbledhë peticionet, e kemi përpilue një kërkesë, e ka nënshkrue kryetari, e kemi protokollue, e kemi çue dhe përmes emailit edhe kopje fizike. Kemi pas një kërkesë shumë të thjeshtë edhe bazike: Një pjesë e madhe e Administratës komunale gjendet me vendbanim të përkohshëm në Prizren, atyre personave duhet t’iu sigurohet një linjë e veçantë, sepse është e pamundur që ata të sillen në punë në kohë edhe e kanë vështirësi transportin. Por duhet të kuptojmë diçka. Ndryshe është dëshira jonë edhe vullneti, ndryshe është mundësia që ta ofron Ministria. Nga ana jonë të gjitha procedurat i kemi ndjek, tash jemi në pritje, kurdo që të bëhet ne këtu jemi, e bëjmë bashkërisht. Sa i përket participimit në QKMF, në 2021-tën është Vendimi për lirimin nga participimi. Participimi i vetëm që figuron në Raportin Financiar është participimi jo që bëhet nga QKMF, mirëpo aty figuron si kategori. Participimi real është i bërë nga QPS-ja. Mund të thotë dikush pse, është më saktësisht kategoria, kush ka familjarë ose dikënd që i njeh çështjet e gjuetisë, aty merren dokumente për persona që pajisen me armë, për armambajtje me leje. Quhet dokument që vërteton mosmarrjen e zotësisë së veprimit. Sepse pasja e një arme në posedim është çështje luksi. Nuk mund që të jesh edhe në social edhe të marrësh ose të blesh armë. Dhe, të gjithë këto participime, gjithmonë është një vlerë jashtëzakonisht e vogël, simbolike, 300, 400 ose 500 euro, varësisht nga kërkesat që bëhen. Përndryshe, participimi në QKMF ne e dimë që ka vite që nuk ekziston, dhe për këtë arsye kemi marrë vërejtje edhe nga Thesari shpeshherë. Kemi marrë vërejtje për faktin se participimi duhet të vendoset dhe me paratë e participimit të ndihmohet pagesa e kujdestarive. Sepse është bërë barrë jashtëzakonisht e madhe për çështjen e buxhetit për paga dhe mëditje, çështja e kujdestarive. E dimë shumë mirë, Ligji për kujdestaritë si qëndron stafi shëndetësor. Sa i përket asambleistit Uran Halimi, nëse nuk gabojmë kërkeve për shtëpinë malore në “Cilipup”, a po? Ky ka qenë një projekt komunal që e kemi gjet kur kemi ardhë. Kemi vazhdue i kemi alokue ato mjete, është fakt, kanë fillue punimet. Është bërë një trasim i një rruge, sepse terreni aty ka qenë jashtëzakonisht i vështirë, është bërë një trasim i rrugës, kam qenë personalisht edhe atje vetë. Ka arritur operatori ekonomik deri sa ta shtrojë edhe pllakën e bazës. Më pastaj, si pasojë edhe të problemeve me pronën, meqenëse ai projekt vjen si pasojë e propozimit nga qyteza e Dragashit. Realisht, në kadastrë ajo parcelë është pjesë e listës poseduese në Zonën Kadastrale të Libevishtit. Ky është gabimi i parë që është bërë në propozim. Gabimi i dytë është

se ajo parcelë është pjesë e Pylltarisë. Ne e dimë që në Pylltari nuk mundesh me ndërhy pa një leje. Përndryshe, një pjesë të fajit të kësaj e ka edhe operatori ekonomik që, muj me thënë me gojën plot, ka qenë i papërgjegjshëm. Mezi ka prit me iu krijue rrethanat, edhe e ka shkaktue këtë problem. Por, ne jemi të vullnetit që këtë punë ta vazhdojmë tutje, në qoftë se përsëritet si kërkesë e qytezës së Dragashit dhe të Libevishtit, nëse nuk kanë probleme këto dy zona me njëra-tjetrën, ne do ta përkrahim edhe do ta çojmë tutje në buxhetimet e ardhshme. Pyetjen e Jetmirit e jep drejtori i Financave. Sa i përket atij detajit që e thatë ju për “Meka”, ligji e thotë ashtu. Ligji e thotë që kryetari i Komunës e gëzon të drejtën e reprezentacionit, madje është edhe diçka tjetër, ligji e thotë që edhe drejtorët kanë të drejtë të kenë reprezentacion me autorizimin e kryetarit. Por neve kurrë kryetari nuk na ka lejue këtë të drejtë, kryetari i di këto arsye. Nuk është për çështje keqpërdorimi, por ka dashur që ekskluzivitetin ta ketë kryetari, në mënyrë që të jemi sa më transparentë ndaj qytetarëve. Dhe kërkesa është shumë normale. Me një tryezë, a e din kur nuk do të ishte normale kjo fjalë? Nëse kryetari i Komunës nuk është prezent në tryezën tonë. Unë jam drejtor i Administratës dhe unë merrem me pagesa. Prej kur ka fillue kryetari i Komunës me u marrë me pagesa, me fatura? Kryetari i Komunës nuk është faturino. Edhe tjetra, sa i përket asambleistit Shpetim Hajredini. E ngriti çështjen e pagesave të ndriçimit publik. Është e vërtetë, unë jetoj në këtë Komunë edhe e di fare mirë që fshatrat Kuk, Zaplluxhe, edhe fshati Blaç, por fshatrat Kuk e Zaplluxhe para nesh e kanë fillue këtë projektin që duhet t’i falënderohemi edhe disaporës, që është iniciatore edhe mirëmbajtëse e këtij sistemi deri tani. Gjithçka ndërlidhet me buxhetin, si pasojë që jemi Komunë e vogël dhe kemi buxhet të vogël. Fillimisht kryetari ka vendos që të shkojmë si pilot-projekt, të shikojmë një herë sa ka impakt në buxhetin tonë kostoja e pagesave të ndriçimit publik. Në mënyrë që të mos shkaktojmë ndasi mes fshatrave, duke e ditë që është një çështje që i prek të gjithë fshatrat, atëherë kryetari ka vendos që projektet aktuale që po i zhvillojmë me ndriçim publik, ato le të hyjnë në sistem të njuhësorit komunal. Ta shikojmë si po ndryshon gjendja e tyre, çfarë kosto kanë, nëse kemi mundësi buxhetore, e fillojmë me e implementue për të gjithë. Ne jemi gjithmonë ithtarë të parimit të barazisë. Nuk mund një fshat apo dy të privilegjojen, ndërsa tërësia tjetër të anashkalojet. Unë besoj që shumë shpejt kryetari i Komunës do të marrë masa në këtë drejtim, do t’i shikojmë balancet se si ka ndikuar pagesa për fshatrat Brodosanë edhe Brezne, sepse ato kanë qenë dy investimet e fundit që janë zhvillue, edhe nëse nuk ka një impakt të lartë që mund ta dëmtojë buxhetin tonë komunal, atëherë unë si drejtor i Administratës, në bashkëpunim me drejtorin e Urbanizmit duhet t’i drejtojmë kërkesat pranë KEDS-it që të vendosen njuhësorë elektrikë në kuadër të Komunës, për secilin fshat, në hyrje të fshatit apo në fund, varësisht si është sistemi i instaluar. Atëherë do të fillojë faturimi nga organizata buxhetore Komuna e Dragashit dhe jo nga fshati. Për fund, mos me i mbet borxh edhe z.Xheladini, sa i përket reagimit të PDK-Dega Dragash për automjetin dhuratë nga Ambasada Amerikane. Unë atë automjet, me marrjen e mandatit, gjënë e parë të cilën e kam bërë ka qenë me

shkue te zyrtari i pasurisë me e kërkue Listën e aseteve. Meqenëse Drejtoria që e menaxhoj unë përkon edhe me menaxhimin e aseteve siç janë automjetet, po edhe të objekteve, kam kërkue që ta kem Listën e aseteve që e kemi ne në pronësi. Aty ka figurue një veturë, vetëm emri Mitsubishi edhe ngjyra e gjelbër. Atë veturë kemi pas vështirësi edhe me e gjet, sepse nuk ka qenë në qarkullim fare. Për këtë janë dëshmitarë zyrtarë të Administratës komunale. I kam pyet, nuk e kanë ditë ku është. Ajo veturë është gjet në njërën nga ato barakat që gjenden përballë QKMF-së në Dragash, e mbuluar me shtretër të përdorur tash e disa vite të QKMF-së. Përkatësisht ka qenë e mbuluar në stilin e kamuflazhit tipik, që mos me e pa askush edhe me e lënë aty në gjendje të pushuar, derisa të vjen puna me e qit në tender si aset të papërdorur. Duke i ditë nevojat e saj, pasi që e kam marrë, kam bërë hulumtimet e nevojshme sa i përket dokumentacionit. Ajo veturë ka qenë e dhuruar në vitin 2015. Vlera e saj në kohën kur është dhuruar kap shifrën 30 mijë dollarë. E kemi profaturën nga Ambasada Amerikane. Të gjitha këto i kam siguruar nga Ambasada Amerikane. Atë që e kemi parë ka qenë një fakt interesant, që për hir të korrektësisë jam i detyruar me e bë publike këtu. Dudi i kësaj veture ka qenë – kush e njeh këtu gjuhën angleze, Urani e njeh, se e ka të përfundum fakultetin – dhuruesi është Ambasada Amerikane në Kosovë, pranuesi i dhuratës është Ambasada Amerikane. Ambasada Amerikane nuk e ka bërë këtë plan, e ka bërë faktori njeri në Komunën tonë. Se është dashtë me u marrë kjo veturë herët, iu vu pika. Iu vu pika nga dikush që ka dashtë me e shit ma lirë e me e ble ma kollaj. Qe marrëveshjen e kam, dudin në Doganë e kam përmirësue, qe ta kallxoj. Se në marrëveshje që është bërë në mes të Komunës edhe Ambasadës Amerikane e kanë bërë këtë lojë. Unë i kam bërë kërkesë Ambasadës Amerikane, për hir të korrektësisë veç një rresht po jua lexoj, shikone çka më ka thënë: Na vjen keq ta dëgjojmë nga ana juaj se vetura që është dhuruar nga Ambasada Amerikane në Kosovë, ka tashmë 8 vite që nuk është regjistruar deri tani. Ky fakt na ka habitur neve, meqenëse kjo nënkupton se kjo veturë ka qëndruar e pashfrytëzuar gjatë gjithë kësaj kohe të gjatë. Komuna e Dragashit e ka surprizue edhe Ambasadën Amerikane pse nuk e ka regjistruar veturën. Unë e di që jam bërë cak sulmi, unë e di që veç kur po e shkruajnë shkronjën D në tastierë po iu del drejtori i Administratës. Po unë e kam obligim me e regjistruar një aset të Komunës, se jemi të nevojshëm për gjipa. Jemi të nevojshëm për shërbimin e shëndetësisë, nëse është e mundshme edhe vetëm në regjionin e Gorës. Kërkesa nga ana e Komunës është e bërë më 14.09.2022, fiks 9 muaj pasi kemi ardhë në pushtet. Se atëherë e kam vërejt unë që ka problem me dudin, edhe një vit e tre muaj më është dashtë deri sa kam arrit me e përmirësue Dudin. Dudi është dokumenti i cili i tregon të gjitha të dhënat e detajizuara për një automjet, duke filluar nga origjina e tij, kush e ka përfitue dhe të gjithë specifikacionin e tij. Pa të nuk mund të regjistrohet automjeti. Kam provue në Departamentin e Automjeteve pranë MPB-së në Komunë, nuk kanë pranue, atëherë unë i kam ndjek procedurat ligjore. Tash dalim edhe te shfrytëzimi, nuk është problem, më vjen mirë që e hape këtë temë. Ne e kemi bërë regjistrimin e saj, në gjendje të paregjistrime kemi ec, po

kemi ec për bjeshkë, nuk kemi ec në qytet me shkuë. Nëse është një kundërvajtje unë me e çue me e transportue një familje të një të sëmuri prej Leshtani, një nënë shtatzënë që ka ardhë nga QKUK. Jo, arsyetimet koti i keni ju, se ne si Komunë e kemi pas obligim me i tregue qytetarëve çka ka ndodhë. Këto vetura që janë regjistruë – na kur kemi ardhë në pushtet asnjë veturë nuk u konë e regjistrume, merrne kqyrne raportin. Në fund të vitit nuk kanë qenë, ne e kemi kalue, ne kemi ardhë në pushtet në janar. Unë po e kuptoj këtë frustrim, veç një send mos harroni, edhe për gjendjen e automjeteve keni komentue. Gjendja e automjeteve në Komunë nuk është në gjendje të keqe qysh e keni proklamue në status. Veç diçka, edhe këtë mirë që e hape, se se po shihet që pjesë e kontributit qenke ti në atë status. Sa për faktin që drejtori i Administratës keni thënë që ka qef atraksionet malore. E keni thënë qeshtu, qe e kam në status. Unë mundem me ju thënë veç një send: Po vallahe, fort qef i kam. Shumë i kam qef, veç me pare të mirat, jo me të shtetit, veç me kerra të mitë, jo me të shtetit, veç me gjypa të mitë, jo me të shtetit. Koha kur janë qit statusat, fotot në bjeshkë edhe u shkruë ‘në Malet e Sharrit plus vetura 4Z’ ka marue tash e dy vite e diçka. Për të gjitha tjerat nuk po flas, nuk po flas për gjendjen e veturës. E keni komentue veturën e Pylltarisë. Unë nuk jam t’u e kuptue këtë fakt, pse po hyni llugave pa nevojë? Pylltarinë e ka marrë Agjencioni në menaxhim. Na nuk kemi nevojë me iu dhënë veturë, i jep Qeveria. Neve nuk na takon me i pajis me vetura Pylltarinë, se Qeveria ka vendos me ligj me i marrë në menaxhim Pylltarinë, qysh ka vendos tash edhe për Emergjencat. Jo, na e kemi gabim veç 9 muaj, edhe na e kemi regjistruë, kemi kallxue që s’dona me marrë, s’dona me e ble në tender, nuk e blejmë na në tender. Asaj veture iu zgjat ymri, se është t’u regjistruë në Komunë. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Do ta kisha përgëzue drejtorin e Administratës, secilit deri në fund të fjalimit ishte, për mendimin tim, perfekt. Por kur erdh koha edhe momenti që të japë disa llogari me Udhëzimin, u tërhoq. Tha ligji i jep, ishte për kryetarin një fjalim, tha ligji e jep ashtu, ashtu duhet të zbatohet ligji. Ligji çka të thotë, thona amin. Unë prapë do të ndërlihem këtu, drejtor i Administratës. Tek menaxhimi i parave nga shkollat, thaje ne ju japim pare, e jo ju neve. Unë e kuptoj se ato para janë publike dhe do të thotë se ju i shpërndani, është fakt që i shpërndani, dhe ato para shpërndahen nëpër dikastere të cilët i kemi fushat, po flas për arsimin, DKA-në. Nuk po thotë Udhëzimi 33/2013 që ato para i menaxhoni ju. Nëse ke durimin, ashtu si pata durim të dëgjova me përpikëri edhe ishe i shkëlqyeshëm. Thotë kështu, 33/2013, Neni3, sigurisht e ke para vetit: Çdo shkollë e pranon buxhetin për mallra dhe shërbime si një shumë fikse dhe vendos përmes planit të saj buxhetor se si ta alokojë buxhetin e vet. Me këtë ‘buxhetin e vet’, çka kupton? Do të thotë, duhet t’i jepni paratë dhe vetë ta menaxhojë buxhetin e vet total, në mes të kodeve të ndryshme buxhetore për mallra dhe shërbime. Në po me të njëjtin ligj thuhet se DKA-ja, nga të gjitha paratë të cilat i ndahen, vetëm 5% nga shuma totale i menaxhon vetë. 95% para të mbetura u ndahen shkollave, që ato vetë t’i menaxhojnë. 5%-shi në DKA mbet për raste emergjente. Sa përqind iu takojnë shkollave, cilës shkollë i keni dhënë 1% ta menaxhojë vetë? Edhe unë të

parashtrova pyetjen, keni thënë se është në pyetje korrupsioni. Me ju jam, a ka pas a s'ka pas, nuk e di. Po e pranoj, ka pas po thuesh, okej. Përderisa keni mujt me e ditë se ka pas dhe keni menaxhë, kush juve ju menaxhon tash, që ju vetë udhëheqni me paratë? A ka organ që juve ju udhëheq? Unë nuk e di kush ju kontrollon? Është shumë e logjikshme paranë e shkollave, që i takon shkollave, të menaxhojë drejtorja e shkollës me Këshillin Drejtues, dhe ju të jeni në mbikëqyrje të asaj parasë, si po harxhohet. E dyta – gjithmonë me ligjin, nuk po flas jashtë ligjit – vetë thaje, u drejtove këtu se edhe nga Ministria e Arsimit e kanë pranue zgjedhjen e drejtorëve. Nuk kanë pa, thaje, shkelje të ligjit, okej. Komisioni i zgjedhjeve caktohet nga një konkurs. Për zgjedhjen e anëtarëve të konkursit, anëtarët e Komisionit zgjidhen nga DKA-ja dhe caktohen nga Kuvendi Komunal për një vit shkollor. Ky vit shkollor ka qenë 2022/2023, që vetë e ceket. Nëse ka gabue Ministria e Arsimit, ju a nuk po e shihni që është gabim kjo? Vetë me e anulue këtë konkurs. Nëse ministri ka gabue, nëse e kemi vërejt se ka gabue Ministria, pse nuk kemi reague ne që këtë Komision, pavarësisht se prapë ju do ta emëroni, pse mos ta emëroni edhe një herë prej fillimit një tjetër, të është i ligjshëm. Veç te Komisioni po ndalem. Te tjetra, a nuk po e shihni se është gabim përzgjedhja, kur vetë po e lexoni edhe po thoni bart përgjegjësi drejtori i cili nënshkruan. Udhëzimi 151/2020 177: Deklaratë nën betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturën politike. Tash, nëse ka gabue Ministria, ju a nuk po e shihni që deri dje kolegën e kemi pas këtu? Edhe tash, pse po e detyroni vetë kolegën më nga nëpër gjykata? Nëse betimi – unë e kuptoj se është një fjalë shumë e rëndë – që ti duhesh të betohesh, ose ai kolega duhet të betohet para një shteti. Ky është dokument shtetëror. E, si e lini kolegën me vetëdëshirë, ndoshta me dëshirën e juaj, me gabue, me e çue nëpër gjykata? Unë nuk e çoj, e çon Udhëzimi. Vetë po i numëroni të gjitha këto edhe nuk po muj me qenë i besueshëm, apo t'i besoj këtij Udhëzimi, apo t'iu besoj udhëzimeve të cilat i nxjerrni edhe i thoni ju. Kur ju konvenon, thoni ligji e thotë kështu. Mu po më duket se ligji po thotë në këtë moment në mënyrë të tillë. Faleminderit!

Uran Halimi: I parashtrova unë ato pyetjet, që s'ke kryetari këtu, m'i dha do përgjigje Vetimi. Tha që vendi ku kanë fillue punimet e asaj shtëpisë malore është zonë kadastrale e fshatit Lubevishtë. Edhe e Pylltarisë, qeshtu diçka e mora vesh. Mirëpo, meqenëse paska qenë kështu, dikush e ka planifikue dhe ka hap tender për me u ndërtue qatë kjo shtëpia malore. A keni ju parashikues, a ka rregulla në fakt që duhet me i ndjek përpara se me u hap një tender? Keni Drejtorin edhe të Kadastrit edhe keni edhe të Bujqësisë, qysh e di, u dashtë me e parashikue gjërat, me hap tender, 35 mijë euro në pyetje. Në fakt, diçka i keni gënjye qytetarët që keni fillue diçka me bo, sigurisht edhe ja 20-30-50 vota i keni bo në to, edhe në fund i keni braktis atë tenderin që disa adhurues të natyrës po besoj që – e kam dhe tenderin, saktë nëse dëshiroj ta kallxoj – kështu që i keni zhgënjye qytetarët, se ata me zor kanë prit. Bile-bile, kam pa ma herët, në kohën kur kanë fillue punimet aty, shumë janë gëzue disa qytetarë t'u bo foto, filloi

ndërtimi i shtëpisë malore, edhe u braktis gjithaçka, pa asnjë sqarim. Te tjetra, thaje që asaj veturës Mitsubishi – unë po të kallxoj që në vitin 2022, nashta u votue në 2021-tën, po të kallxoj që – më bën pyetjen publikisht, dal të kallxoj, hajde këtu në foltore. Unë s’po them, qytetarët çka më kanë thënë, Samidin. Unë përfaqësoj këtu qytetarë, o Samidin, jo Uranin. Jam t’u reague, qato jam t’u e bo. S’e di pse po të dhëm ty, s’kie peshë ti, o Samidin, s’te pyetën kërkush ty, seriozisht. S’ke nevojë me na i kallxue raportet vëllazërore, duhet me i pas mirë, ti pse po dalish këtu po e theksosh tri herë, i kam raportet mirë me vëllain, kjo është e natyrshme. Kam shumë, po s’po më lë me folë, a mundesh me ia tërhek atij vërejtjen?

Arijeta Skeraj: Të lutem, nëse ke për rendin e ditës, mundesh me vazhdue, nëse jo, mundesh lirisht me shkue në vend.

Uran Halimi: Po ai po më ndërpret, s’po më lë me e krye fjalimin.

Arijeta Skeraj: Unë ty po të them, se ti e ke marrë fjalën.

Uran Halimi: Pse. Atij s’un po i thuesh, a?

Arijeta Skeraj: Atij i thashë ma herët, e ty të lutem, në qoftë se nuk merresh me këtë pikë që ke dalë, atëherë unë detyrohem me ta ndalë fjalimin.

Uran Halimi: Unë po bëj replikë për përgjigjet edhe pyetjet që i kam bo pak më herët. Tash, me më ndërpre hiç s’po kam qef se edhe unë s’po e ndërpres kënd, po po ndodhin këto. Sidoqoftë, thaje ju vu pika asaj veturës, Mitsubishit. E kam pa edhe kur dolëm atëherë me motorra, na u lagëm në shi e ju ecët me atë Mitsubishin. Shumë mirë u konë. Ajo çka po më shqetëson, nëse asaj iu vu pika nga dikush, ti e more ia vunë pikën vetë edhe e shfrytëzove pa regjistruë. S’mundish me veturë Mitsubishi të papajisur me pajisje mjekësore me transportue, thaje gra shtatzënë në mos gabofsha. Nuk transportohen pacientë me atë veturën. Jo s’po abuzoj, po thaje pacientë kemi... për afërsisht qeshtu. Sidoqoftë, nuk është veturë ajo për me u transportue pacientët. Për transportim të pacientëve janë veturat e ndihmës së shpejtë. Tjetra, thaje ndër të tjerash, nuk jemi ata që blejmë në tender. Në tender që i keni qit do makina, e dish ti kush ka aplikue në ata tenderat. Janë zyrtarë komunalë, duke i shpërblyer dostat e tyre. Shokët e zyrtarëve komunalë kanë marrë vetura në ankande, vetura komunale, ti e dish shumë mirë. Nëse nuk jeni ata që bleni në tendere, jeni ata që bleni njerëz me këta tenderë. E dini shumë mirë. Dhe, siç e thashë, pikërisht aplikues në këto tenderë për këto vetura të Komunës janë sekserët e juaj politikë.

Driton Ademi: Po i ndërlidhem pak drejtorit të Administratës, që tha për veturat. Drejtor, më 18 qershor, qysh të tha kolega Uran, je konë në Koretnik me Mitsubish. Pa regjistruë. Ti qysh mundesh me dalë, që je një superdrejtor, me një pozitë të drejtorit, ke të drejtën me dalë, veç ti ke të drejtën ose ekzekutivi ka të drejtën me dalë, na qytetarët e thjeshtë shkëlma, hamë dënime sa të doni, ju jeni të drejtë domethënë, pa marrë parasysh aktivitetet, keni të drejtë me dalë. Plus po thuesh atraksion, që je konë bashkë me motorrat, që nuk keni pas ndoshta edhe ndihmë të parë, nuk e di, munden me ma konfirmue

Urani. E para, e dyta: Më 4 tetor 2023, një koleg, punëtor i juaji që e keni marrë në punë, duket në fotografi, nuk po e di shumë sigurt ku munden me qenë, po me sa e pashë unë është diku kah Brodi. Me qat foto që është e publikume në faqen e partisë. 4 tetor 2023 është në bjeshkë, nuk munden me dalë, kur unë si qytetarë s'dalë, a ju jeni qaq super... për me dalë nëpër qytet edhe mos me e pyet kërkond, a? Domethënë ju nuk diskutoni për shtet. 16 dhjetor ke bo fotografi qetu, midis dimrit, përpara, e ke pas kallet. A ke të drejtë ti me dalë me kerr pa regjistruer? More ti t'u ec ke dalë edhe ke dalë para Komunës. Qysh more pa shofer, para kerrit ke dalë. A vetë të duel prej garazhdës kerri ty, a qysh, a ti e nxorre prej garazhdës? A të erdh ai, a ti e nxorre? Edhe një pyetje drejtor. Ja 4-5 herë kam dalë me folë për këtë drejtorin Naser Myrtezani, që u bo sot drejtor. Vjet, në 2023-tën, u ka formue qeky Komisioni, edhe shumë mirë ta kam cek, edhe personat të cilët kanë hy në Komision, plus anëtarët e Komisionit që ju i keni quajt specialist, se s'po due me i përmend, një herë i kam përmend me emra, se tash po ma mban edhe kryet poronë, se është shumë e drejtë me ardhë prej Prizrenit edhe me i fut nëpër komisione. Ju këtë Komision e keni bo në prill ose në maj, nuk po e ma në mend sigurt, po vjet u konë. Kqyre qysh po të thotë ty me Udhëzim Administrativ: një vit shkollor. Pse nuk po e pranosh, të thuesh është në UA një vit shkollor. Domethënë këti Komisioni i ka dalë mandati më 31.08.2023. Dhe nuk ke pas të drejtë absolut me... plus anëtari i DKA-së që e keni punësue para dy vjete, pa i pas tri vjet përvojë pune nuk munden me qenë anëtar i asnjë komisioni. Të shkrua në Udhëzim Administrativ. Anëtari të cilin ju e keni marrë, që është i punësuar i DKA-së, nuk munden me qenë me asnjë komision. Këtë nuk je t'u e ditë, ta ka shpjegue edhe kolega, profi Nexhë. Normal që kam me i ra, sa të jam këtu unë kam me i ra, për gabimet e juaja, më vjen keq.

Samidin Xheladini: Po më vjen keq, Uran! Ma ke përmend emrin edhe qe disa herë po sillesh rreth meje. Çështjes familjare, shembull jemi na në të gjithë botën Për çështje politike, mund të marrish shembull se si funksionon demokracia në një familje. Edhe jo ti, po e gjithë Kosova edhe Evropa, bota le të marrë shembull. Unë kam qenë kandidat edhe vëllai jem ka qenë kandidat, ky për kryetar e unë për Asamble. Unë kam qenë më i votuar, ky ka qenë më i votuar. Ti ke qenë me një mandat të kaluar kandidat për Asamble, një autobus vota s'i ke marrë. Mos u lavdo me bartës të listës, del me vota të tuat. E para, e dyta: bartës të listës janë këtu njerëzit që janë me vota, qysh i themi na, vitra. S'e përfaqësojnë popullin, ata përfaqësojnë partinë. Qamil edhe ti je qasi, të tretë qetu në rend, po ju bjer rendi qaty. Për çështjen e arsimit, mu po më vjen keq, edhe për çështjen e kerrit, unë e kam pa në lajm. Po ju kallxoj një gjë, po më vjen keq, te PDK kur e kam pa reagimin më ka ardhë shumë banal. Pse banal? Kanë të drejtë me reague, po kanë harrue disa asambleistë të mëhershëm që, kur na ka ardhë neve një raport zyrtar, kerrat e Komunës tonë kanë harxhue naftë – unë e kam arsyetue kryetarin e atëhershëm, s'po ia përmendi emrin – në 100 km, 100 litër naftë. Unë e ma përgjegjësinë, t'i s'ke qenë. Kur ka ardhë puna, unë e kam elaborue që, a është gabim teknik, apo K-hin keni harrue me ia shtue, se

M mos është metër. Se me metër ka dalë. E dyta, unë ia kam bo pyetjen drejtorit, edhe drejtori më dha mu përgjigje, s'keni nevojë ju me bo, pse s'e bëtë pyetjen ju. Ju keni bo reagime në rrjete sociale. Rrjeti social është rrenë, e vërtetë, çkado. Ky është zyrtar, këtu ka qenë dashtë ju me e bo pyetjen edhe me dalë. Edhe LVV-ja e ka bo një reagim edhe unë e kam pa në Vienë. Unë e kam shpërnda, kur e kam shpërnda, reagimin e kryetarit s'po e qet, vëllai i këtij ka reague, atje ma ka çue, ej çka ke bo, e kam shpërnda veç të VV-së. Rrenën e VV-së e kam shpërnda. Ai s'po e qitke reagimin e kryetarit. Pse? Se unë kam pas qef reagimin, kur s'dish pyet, se dikush di ma shumë. E unë prej qetyne po e shoh që po di ma shumë. Më pyetni mu, se di ma shumë. Për ekzekutiv di ky ma shumë. Edhe një send po ju them. Uran, po më vjen keq që je qart, unë të kam votue edhe në mandatin e kaluar. Asnjëri nuk jeni meritore për kryesues. Unë e kam bo lojën teme edhe në parti edhe krejt. Po më vjen keq, se ju jeni t'u shpif gjëra. Janë dëshmitarë ata të cilët kanë qenë prezentë. Unë e kam bo lojën teme deri në momentin e fundit. Në momentin e fundit, kryetari ka thënë në qoftë se e votoni Samidinin për kryesues, ka thënë unë jap dorëheqje si kryetar. Të gjithë me unanimitet e kanë votue këtë. Unë veç votën teme e kam pas. Pse? Ju jeni shumë larg politikës, jeni shumë larg demokracisë, për atë për ty është absurd. Ti s'e kuptosh, se në demokraci merret vendim në vendin adekuat, bihet këtu vendimi. E kam zbatue, a më pëlqen a s'më pëlqen, është çështje krejt tjetër. A dini me udhëheq ti edhe kjo, kryesuesin, unë e di që s'dini. Po votat i keni marrë, udhëhiqni. Se, me qenë kryesues unë atje, krejt puna në Asamble kishte pas me shkue ndryshe. Për atë kam pas me u bo kryesues. Edhe për me iu bë krah këtij vëllait, se qeky ia mban shpinën, se kush të jese sikur vëllai-vëllait s'ia mban. Po po e keqpërdorni pozitën, që për fat të keq unë me këtë jam vëlla. Mos i lidhni gjërat, se kurrë nuk më pyet e as nuk e pyes për çështje që i takojnë atij edhe mu. Ju lutem, edhe hera e fundit le të jetë, në këtë foltore mos më lidhni mu me ekzekutivin, se unë kurgjo të përbashkët s'kam me ta. Ju lutem, këtu në Asamble mu me ekzekutiv mos më lidhni. Le të bëjnë be, le të betohen këta që kam shkue, ose te kryetari ose diçka, me kërkue për diçka në ekzekutiv. Edhe jam më meritori, po s'shkoj se e kanë punën e vet. E ka stafin e vet, i ka njerëzit e vet. Këtu jam unë edhe këtu unë e jap fjalën. Edhe pse po reagoj, ju 100 herë po reagoni edhe s'po bëhet kiameti. Mu më pëlqen, ajo është demokraci, edhe pse reagojsh prej vendit. Në krej botën reagojnë prej vendit, kur reagoj unë bëhet kiameti. Çka është ky muhabet, domethënë ka tendenca këtu. Qëllime të caktuar për me e gjujt këtë. Hiç ma vonë se dje, unë e kam bo një reagim në prezencë të një zyrtarit, i kam thënë po përfitoni ju, veç ju, serbët, malazezët, ai tjetri-ai tjetri. Ky është realiteti, edhe menjëherë po e marrin politike. Edhe i thashë atij zyrtarit, ai u çue duel jashtë, tha ti s'e dinë ata që ti po thuesh vetë, krejt po më adresojnë, po vijnë po ankohen te unë, edhe minoritetet po vijnë po ankohen te unë, se unë po të them ty. Ju betohem, kurrë asnjëherë nuk më thotë, bile s'un po më ndalen, se s'ndalem.

Arijeta Skeraj: Nedžmidin, a ka mundësi me shkue në vend?

Nedžmidini Sejdilar: E qetash si të shpjegoni pse prej të gjithë Kuvendit veç mu më thatë a ka mundësi me shkue në vend?

Arijeta Skeraj: A ka mundësi me shkue në vend, derisa ta jap fjalën.

Nedžmidin Sejdilar: Veç si të mundeni me më shpjegu. Samidini del kur do, Urani qashtu, unë 43 minuta jam t'u prit fjalën me ma dhënë, kryesuese. Veç po më diskriminoni.

Arijeta Skeraj: Te lutem, a ka mundësi me shkue në vend? Gjersa nuk të përmendet emri me ardhë në foltore, të kisha lut me shkue në vend! Përndryshe, pa shkue në vend unë nuk ta jap fjalën.

Nedžmidin Sejdilar: Po, paska mundësi. Ani, a me shkue në vend edhe më japish fjalën, a po?

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Samidin Xheladini! Fjalën e ka Nedžmidin Sejdilar.

Nedžmidin Sejdilar: Kam treguar në mënyrë demonstrative se si e drejtoni seancën. Nëse i jep një fjalë dikujt, do të më japësh edhe mua leje. Meqenëse Kryetari është kthyer, sugjeroj të fillojmë nga e para. Z. Xheladini, që të jeni ju bartës i listës, së pari duhet t'ju besojë partia. Dhe ti dhe Csipiripi gjithashtu. Mbajtësi i listës duhet të jetë një person i besueshëm. Ai nuk mund të jetë një tradhtar si ju. Le të pyesim ish-partin tuaj, ata u penduan që ju lejuan në zyrën e tyre. Bartësi i listës është një person i besueshëm që punon për interesin e qytetarëve dhe jo për interesin personal. Cipiripi, mos më tërhiq nga gjuha të të them se sa të kushton transferta. Kupona, kontrata pune. Ky është një person që nuk do të tradhtojë. A e din Kryetari, se kur fikni dritën në QKMF, drita në të gjithë ndërtesën fiket. Kur do të rregullojë? Ju i detyroni drejtorët tuaj të dalin nga mbledhja e asamblesë sepse nuk janë në gjendje të japin asnjë përgjigje. A e dini se me çfarë ngrohët stafi, me ngrohës kuarci në 1963, nuk kanë ujë të ngrohtë. Jam i zhgënjyer me mënyrën se si e drejtoni këtë komunë.

Qamil Kolloni: I nderuar delegat, sa i përket faljes së tatimit në pronë, ti e dish se si kanë rrjedhë procedurat. Propozimi në fillim ka ardhë nga ministri i Ekonomisë dhe Financave i Qeverisë së Kosovës. Pas propozimit të ministrit që të falet, ju e dini se në vitin 2022 qeveria lokale e Komunës së Dragashit 20% të tatimit në pronë e ka falë që në fillim të vitit 2022. Është votue në këtë Kuvend. Pas propozimit të ministrit, ju si delegatë keni propozue që të diskutojmë ne në Kuvend dhe të marrim një qëndrim për t'i kthyer përgjigje Ministrisë, konkretisht Departamentit të Tatimit në Pronë, një përgjigje për faljen 100 euro për Komunën. Meqenëse ky Vendim shkoi në Gjykatën e Apelit, që u propozue nga kryeministri, na si Kuvend nuk morëm vendim, por dërguam rekomandime më datën 08.02.2023, të cilat rekomandime janë të nënshkruara nga ish-kryesuesi Uran Halimi. Në këto rekomandime thamë si në vijim: KK – Dragash i rekomandon Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që Vendimin e rivlerësimit të pronave të pezulluar, ku përfitues do të jenë qytetarët e RKS-së, në këtë rast të Komunës së Dragashit, të paguajnë vlerën e faturës së tatimit për vitin 2023 njëjtë siç e kanë paguar në vitin 2022. Kjo ishte që kërkuam që të paguhet njëjtë si në vitin 2022, për arsye se na kemi pas bo një zbritje prej 20% dhe në këtë Kuvend e patëm miratue. Por, në raste se ishte në dilemë ligji, dhamë edhe versionin

e dytë, me të cilin u dakorduan të gjitha grupet parlamentare në prezencën e kryetarit. Në qoftë se ju kujtohet, thamë kështu: KK- Dragash i rekomandon MFPT-së që brenda mundësisë ligjore, ndryshimeve eventuale të Ligjit mbi Tatimin në Pronë të Paluajtshme, Ligjin 06L 005, të iu lejohet komunave që të bëjnë faljen deri në 100 euro për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Dragashit për vitin 2023. Çfarë ndodh? Pas këtyre rekomandimeve, më datën 31.03.2023 – këto rekomandime ne i kemi çue më 08.02.2023 – më 31.03.2023 Qeveria e Kosovës fillon me projektligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit 06L 005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Ky ligj edhe një herë kundërshtohet dhe shkon gjykatë deri në momentin kur e merr formën e prerë. Në momentin kur e merr formën e prerë, ky ligj plotëson ligjin tjetër dhe iu lë hapësirë komunave, ato komuna ku kanë pas bazë të ngritjes së lartë, që t'i falin ga 100 euro dhe e lë në vullnetin e të gjitha komunave. Meqenëse neve i kemi falë 20% dhe njëkohësisht, vetë ky ligj e bën rritjen e vlerës të cilën e falë Qeveria – që do ta shpjegoj me formulë – në Nenin 3, nga shuma prej 15 mijë euro të cilat i fal për objektet Qeveria, rrit shumën në 30 mijë euro. Neni 3, Pika 1.8, po ta lexoj veç këtë pjesë: Për vendbanimet parësore, në këtë rast i kemi për shtëpitë, deri në 30 mijë euro. Mirëpo, me këtë ligj plotëson dhe shtin në fuqi tatimin tjetër, që janë tokat. Në tatimin për objektet e kemi sipas zonave dhe kemi pas tri zona. Ndërsa, tokat në bazë të ligjit i shti në bazë të bonitetit, ara, livadhe dhe kullosa. Për këtë arsye parashih që vlera e tokës të zbritet dhe të falet nga Qeveria 50 mijë euro. Pronat tona të cilat realisht tatimohen këtu, janë një numër tepër i vogël i pronave që kalojnë vlerën 50 mijë euro. Ne e kemi pajis ekipin e Tatimit në Pronë me tableta të ri, ku për 9300 tatimpagues do të bëjmë vlerësimin dhe ndryshimin e bonitetit. Dhe, të gjitha këtyre të cilat janë të regjistruara si ara dhe realisht janë livadhe ose kullosa, do t'u ulet dhe ndryshohet boniteti, me kush që t'i ndihmohet secilit qytetar në tatimin në pronë. Kemi fillue fazën e vlerësimit të këtyre faturave dhe pronave. Çka ndodh? Në anën tjetër, si drejtor i parashikimit të buxhetit, na dërgon udhëzimet kryesore nga Ministria. Udhëzimet kryesore janë: A) Limitet e granteve që do t'i caktojë Qeveria qendrore për Komunësn. Ky është një udhëzim ku thotë se limitin as nuk mundesh me e ngrit për aq sa e ke parapa, as nuk mundesh me e ulë. Me Qarkore neve na përcakton limitet. Ky është udhëzim kryesor i MFPT-së. Çka është e dytë? B) Buxheti duhet të jetë i balancuar. Kjo do të thotë se Komuna nuk mund – është urdhër – të bëjë planin për shpenzimet të cilat i kalojnë grantet e lejuara dhe nuk mund përgatitet buxheti deficitar në mungesë të parave. Në qoftë se verpojmë në bazë të kësaj logjike, ne si qeverisje lokale kemi projekte dyvjeçare dhe trivjeçare, ku i kemi të parapara edhe mjetet të cilat do të inkasohen nga të hyrat vetanake si pjesë e projektit. Po që se neve shkojmë edhe me faljen 100 euro të këtyre mjeteve tjera, përpos këtyre zbritjeve që janë bo, ne kalojmë në buxhet deficitar. Në bazë të udhëzimit kryesor të MFPT-së nuk mund të bëjmë parashikim të buxhetit. Sipas formulës, kur kemi falë, në vitin 2022 kemi pas këtë llogari. Vendimi i cili është marrë, rekomandimet realisht, të cilat janë të çume, janë para këtij ligjit. Ato rekomandimet janë në muajin e dytë, e ky ligji është në

muajin e tretë. Është duke u zbatuar ligji tash, Ligji i Tatimit në Pronë që është para këtij rekomandimi dhe ky është tash i ligjshëm. Me zbritje 30 mijë euro dhe 50 mijë euro për toka. Deri sa e kemi çue këtë rekomandim, ka vlejti vetëm për objektet. Po qe, ky është rekomandimi i Kuvendit. Tash, këto zbritje çka afektojnë? Në vitin 2022, 150 metër katrorë herë 220 euro kanë bo 33 mijë euro. Minus 15 mijë euro, barabartë me 18 mijë euro. Para marrjes së Vendimit tonë janë pague 0.60 euro për 150 metër katrorë. Pas Vendimit tonë që është marrë në vitin 2022 për vitin 2023, janë pague 27 euro, domethënë me zbritje, për 150 metër katrorë. Kurse për vitin 2024: 150 metër katrorë herë 220 euro bëjnë 33 mijë euro, minus 30 mijë euro që falen nga Qeveria, mbesin në bazë tatimore 3 mijë euro. 3 mijë euro herë 0.15 që e kemi përcaktue normën e interesit, bëjnë 4.50 euro një shtëpi 150 metër katrorë. Plus tola që do t'i shtohet, janë faturat që kanë me qenë më të ulëta. Pse nuk po thoni që në vitin 2023 kemi pas rritje për 16% të të hyrave të tatimit në pronë, kur krejt komunat tjera janë ankue, kanë pas probleme, Komuna jonë në 2023 ma mirë, në 2024-tën edhe ma mirë kemi me kalue. Kjo falje ka me vazhdu edhe në 2025-tën, 2026-tën, ke apo s'ke Qamili drejtor. Është bërë një punë shumë e mirë, se na bazën nominale e kemi ulë, dhe çfarëdo rritje bënë Qeveria dhe çfarëdo zbritje, ne jemi përfitues. Kjo është poenta kryesore. Me 4.50 euro, 70% e klientëve janë pa bazë për objekte, domethënë tatimohen zero (0). Të gjitha ato që janë nën 150 metër katrorë tatimohen me zero (0). Veç toka tash që ka hy si tatim në pronë, këtë vit kemi të hyra nga prona, përndryshe do të ishte dashtë që për 6 vite Zyrën e Tatimit në Pronë me e mbyllë krejt.

Jetmir Ajdini: Drejtor, veç një pyetje shumë të thjeshtë e kam. A vlejti për ju vendimet e Asamblesë Komunale, si qeverisje komunale, vendimet të cilat i merr Asambleja Komunale? Na në Vendimin që e kemi marrë, jemi dakordue me shefat e grupeve parlamentare, me kryetarin prezent, me kryesuesin prezent, jemi dakordue që nëse ligji e kalon Qeverinë, e kalon Kuvendin e Kosovës edhe e kalon kushtetutshmërinë, ky Vendim të cilin e kemi marrë na duhet të zbatohet, vendim i cili nuk është zbatue deri sot. Është fjala për faljen e tatimit në pronë për vitin 2023. Nuk po më përgjigjesh në pyetjen që po e bëj unë. Jo mu personalisht si Jetmir, mirëpo përgjigju qytetarëve, për një Vendim të cilin e ka marrë qekjo Asamble Komunale e cila iu përket qytetarëve. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Unë ju kërkoj falje që është dashtë me shkue për shkak të vizitës që e ka bërë komandanti i KFOR-it. Ai ka pas me ardhë në ora 15:00, iu bë puna e ka ardhë në ora 14:00. Ne të gjithë këtu kemi respekt për KFOR-in edhe për atë. Me qëllim u ktheva, në shenjë respekti që kam për ju, nëse ka pyetje unë me ju përgjigj. Në bazë të përgjigjeve që i bëri drjetori i Administratës, i kuptova pyetjet që i keni bërë ju. 99% të përgjigjeve që i ka dhënë janë përgjigje të cilat kam mund t'i bëj edhe unë. Unë vetëm deshta ta plotësoj te tatimi në pronë. Duhet të dallohet vendimi edhe rekomandimi. Rekomandimi është diçka tjetër, vendimi është diçka tjetër. Edhe po të them diçka, doktor. Kur nuk dish, duhet me pyet. Nuk është marrë vendim, por është bërë rekomandim. E ka nënshkruar Uran Halimi,

rekomandim, nuk është vendim. Nëse nuk e di ai çka ka nënshkruar, unë s'e di. Pastaj, pasi ka hy në fuqi ligji, ka qenë një datë e caktuar me u mbledhë Asambleja edhe me marrë vendim. Qajo datë ka kaluar. Edhe deshta të them diçka. Nëse një shtëpi ka kushtuar 60 mijë euro, me vendimin e ri të Qeverisë janë hekur minus 30 mijë euro, ajo shtëpi llogaritet për 30 mijë euro. Nëse një shtëpi është vlerësuar që është 30 mijë euro, minus 30 mijë euro, tatimohet zero (0). Një shtëpi e cila, për shembull, i ka 150 metër katrorë, dhe është vlerësuar si 35 mijë euro, paguan tatim veç 5 mijë euro. Për 5 mijë euro faktikisht i bjer, në vend se me i paguar 30 euro, tash i paguan 4 euro. Kështu që, qytetarët tanë nuk kanë pësuar nga ky ligj dhe paguan tash më pak sesa që është dashur me paguar. Lidhur me pyetjet tjera që i ka bo, unë deshta të them për autobusin, ne i kemi bo të gjitha, edhe peticionin e kemi çuar në Prishtinë, kemi prit një kohë të gjatë, kam qenë vetë në Prishtinë. Më kanë rekomanduar që ta bëjmë një marrëveshje me kryetarin e Prizrenit. E kemi bo një memorandum me kryetarin e Prizrenit, ai po lejon që autobusi jonë nga një komunë në një komunë tjetër të qarkullojë lirisht. Atë memorandumin e kemi çuar në Prishtinë, prapë kam qenë në Prishtinë me u interesuar, është te zv/ministri, pret nënshkrimin edhe si ta nënshkruajë ne do ta realizojmë këtë të drejtën e autobusit. Sa i përket kontratës kolektive, në bazë të përgjigjes që e ka dhënë drejtori i Administratës, unë e kuptova që opozita po na akuzon neve pse s'po e paguajmë kontratën kolektive, edhe gjoja se disa komuna qenkan shumë përpara, për shembull Prizreni. Prizreni është përpara, se ai ia ka nis me e paguar para pesë viteve kontratën kolektive, edhe nuk u ankue as në shkallë të parë as në shkallë të dytë. Kurse opozita, e cila ma herët ka qenë në pushtet, u ankue edhe në shkallën e parë edhe në shkallën e dytë, edhe tash është prit që këto ankesa ta marrin plotfuqishmërinë. Tash e kanë marrë plotfuqishmërinë, edhe qysh vijnë me rend ne jemi duke i paguar. Sigurisht se këtë vit do të kemi prapë lëndë që do ta marrin plotfuqishmërinë edhe do t'i paguajmë. Mos na qitni fajin neve, keni gabuar që s'keni filluar prej fillimit me i paguar, e keni lënë deri të vijmë ne në pushtet, në vitin 2022 dhe prej vitit 2022 kanë filluar pagesat. Gradualisht janë duke ardhë, vitin e kaluar afër gjysmë milion euro kemi paguar kontratë kolektive, këtë vit sa do të vijmë do t'i paguajmë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! Sot e mbyllim këtë seancë, shihemi në seancat e tjera!

Kryesësja e Kuvendit

Arijeta Skeraj